

PETRO KITO

BIBLIOTEKA
SHTETIT

949.65
K 64

PROPRIETAR
F. J. B. i Pyetschke
EMIN MATRAXHII
Korespondent u paviljoni
detinjeni kajzir

TRAGÉZAT & MILLIMETR
Mentalitate
voglo dabs abit nati shpesht
tumët kushtet

TRAGÉZAT e MULLER
Mentaliteti
Në njalë që ndër këto diqë është më shpeshtë herë, ka dy mentalitet, si i Perçëndimta (occidental) dhe i madh, i po shtrih këtu poshtë dy náodhurat. Ishja ega mesi i shekullit XVIII kur Friderik I te lura qe mbretëroni marchésh ne troni te Gjermania, i-udesh me ngjarje, zhastiqi (chateau) i aft Berlinit. Atë pës i shtetet kohore, kështjellat e zhukurante per se teperi kështjellat, i cila kurrëzit e Friderik I te Math, që i është kurrëz. Ma r'a npi

Emin

Emin

БАРАХИИ

Elbasan e Premte S Korrik 1921

SHKUMINI

Elbasan e Premte 8 Korrik
Politike e Letrare

Politike e Letrare

ERIAVESHME

n e Njësin e Vërtetë

949.65

12 64.

P E T R O K I T O

EMIN MATRAXHIU



SHTËPIA BOTUESE «8 NENTORI»

P A R A T H È N I E

«Epoka e Rilindjes është një epokë revolucionare demokratike me shumë rëndësi në historinë dhe në letërsinë e popullit tonë, — ka thënë shoku Enver Hoxha — është një epokë e ndritur, e udhëhequr nga idetë iluministe, nga njerëzit tanë të shquar të asaj periudhe, që me të drejtë është quajtur Rilindja e Kombit, dalja nga errësira mesjetare feudale, imperialiste në dritë, në kryengritje, në luftë për liri, pavarësi, demokraci, për dritë dhe arësim». ¹⁾

Rruga shekulllore e historisë së popullit tonë, të cilën ai e ka çarë me shpatë në dorë, është plot ngjarje të mëdha frysmezuese, plot shembuj të shkëlqyer luftëtarësh të vendosur të pushkës e të pendës, që i kanë pri atij në këtë rrugë të vështirë, por të lavdishme. Pas çlirimit të vendit, nën kujdesin e Partisë, është bërë një punë e madhe, me artikuj në shtyp dhe botime të veçanta, për njohjen e këtyre ngjarjeve, të jetës dhe të veprës së figurave më të shquara të historisë sonë.

Por historia e vendit tonë të vogël është e madhe.

1) E. Hoxha, Raport e fjalime, 1967-1968, f. 368.

Lufta e popullit tonë gjatë shekujve për liri e pavarësi, për tokë e bukë, për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës e të kulturës së tij kombëtare, është e gjërë. Herojtë e kësaj lufte janë të shumtë. Disa prej tyre janë bërë shembull prej kohësh. Por ka me dhjetëra e qindra të tjerë, jo më pak heroikë në jetën dhe vepren e tyre, dëshmitë e luftës së të cilëve kanë mbetur ende nëpër dosjet arshivale, nëpër koleksionet e pakta të shtypit përparimtar të së kaluarës, që ndodhen në arshivat e bibliotekat tona dhe shfletohen vetëm nga studjues të historisë. Partia dhe shoku Enver, porosisin që këta militantë të shquar të popullit tonë të njihen e të vlerësohen për kontributin që kanë dhënë në zhvillimin progresiv të shoqërisë shqiptare. Vendimi i Komitetit Qëndror të PPSH i 7 korrikut 1959 «Mbi traditat patriotike revolucionare të popullit tonë dhe masat për njohjen dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm», me të cilat, «gjatë luftës nacionalçlirimtare... Partia edukoi dhe mobilizoi masat e gjera të qytetit dhe të fshatit në luftë për çlirimin e vendit dhe vendosjen e pushtetit popullor»¹), shtroi detyra të rëndësishme para historianëve, shkrimtarëve, punonjësve të artit e të kulturës, gazetarëve, etj., për ta nxjerrë në dritë trashëgiminë e lavdishme të së kaluarës.

Këtij qëllimi i shërben edhe libri «Emin Matraxhiu» i punuar nga Petro Kito.

Emin Matraxhiu është një nga patriotët e shquar në historinë e vendit tonë, i cili pothuaj nuk njihet në shkallë kombëtare deri tani. Ai është një patriot i flaktë e konsekuent demokrat përparimtar, mësues i apasionuar i shkollës shqipe, shkrimtar e gazetar

¹⁾ PPSH — Dokumenta kryesore, vëll. III, f. 246.

i talentuar e i guximshëm, bir besnik i popullit, i cili pjesën më të madhe të jetës së tij të shkurtër 32-vjeçare (1890-1922), ia kushtoi luftës për lirinë dhe pavarësinë e atdheut, për konsolidimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e Shqipërisë së pavarur në rrugën e demokracisë.

Ndonëse autor i përshkruan këtu veprimitarинë luftarake dhe krijimtarinë publicistike të një personi të vetëm, për vetë pjesëmarrjen e tij aktive e të gjith-anshme në ngjarjet e vrullshme të viteve 1907-1922, lexuesi njihet edhe me aspekte të luftës së popullit shqiptar kundër pushtuesve të huaj në këtë periudhë e, sidomos, me luftën e bërë në faqet e shtypit demokratik nga intelektualët përparimitarë, kundër klasave reaksionare, çifligare e borgjeze, që përpinqeshin ta mbanin popullin shqiptar nën zgjedhën e tyre ekonomike e politike, në errësirë e padituri.

Autori ka mundur të përshkruaj me sukses, në të gjitha aspektet ekonomike, shoqërore e politike, jetën e veprimitarë e patriotit dhe publicistit të talentuar Emin Matraxhiu. Në punimin e këtij libri ai është mbështetur në mësimet e shokut Enver Hoxha, i cili, duke folur për rilindasit, ka nënvizuar se ata «duhet të vihen drejt në epokën kur kanë jetuar, punuar dhe luftuar, duhet të vihen në dukje idetë e tyre, të cilat ishin prodhimi i zhvillimit të shqipërisë së asaj epoke, duhet të vihen në dukje qëllimet e tyre ku synonin imediatisht dhe në perspektivë»¹⁾.

Emin Matraxhiu, si bashkëluftëtar i Avni Ruste-

1) Enver Hoxha, Raporte e fjalime, 1967-1968, f. 369

mit, Halim Xhelos, etj., është njëri nga mjeshtrit më të mirë të satirës politike në historinë e shtypit shqiptar para çlirimt. Vlera e shkrimeve të tij qëndron, para së gjithash, në përbajtjen e tyre të shëndoshë ideore, në forcën e tyre të madhe goditëse e demaskuese kundër tradhëtarëve e shfrytëzuesve — bejlerëve e çifligarëve. Pikërisht këtu qëndron edhe merita e autorit, që ka ditur, nëpërmjet Emin Matraxhiut, të japë luftën e forcate përparimtare të viteve 1921-1922 për zhvillimin demokratik të Shqipërisë.

Përmes shumë shembujve të përmendur dhe teksteve të shkrimeve më të mira që botohen në fund të librit, del qartë se ky publicist kishte qartësi e pjakuri politike për kohën e vet dhe për ambientin ku lindi dhe u formua. Guximi për të folur hapur kundër armiqve të popullit dhe për të marrë pjesë drejtpërdrejt në aksione, mprehtësia me të cilën ai shikonte dhe i trajtonte ngjarjet, është një shembull që meriton të vihet në dukje. Në shkrimet e tij duket qartë papajtueshmëria me armikun e klasës, me prapambetjen, me inercinë, me spekulantët dhe matrapazët politikë. Shumë shkrime të Emin Matraxhiut në «Tragëzat e mullirit» të gazetës «Shkumbini», e ruajtën vlerën e tyre edhe në dekadat e mëvonshme, kur populli ynë vazhdoi të ndeshet me tradhëtinë e klikave sundonjëse feudalo-borgjeze. Përshkrimi demaskues që i ka bërë ai, p.sh., pseudopatriotit Mehdi Frashëri, për vitet njëzet e tridhjetë na e bën më të qartë veprimtarinë e tij tradhëtare në vitet dyzet e, sidomos, në vitet e Luftës nacionalçlirimtare.

Satira e Emin Matraxhiut shquhet, gjithashtu, për mjeshtërinë artistike, për koncizitetin dhe figurën

e goditur, për gjuhën e kuptueshme nga të gjithë. Në shkrimet e tij nuk shikon humor për humor, por gjithshka është në funksion të idesë, në funksion të goditjes së kundërshtarit.

Në luftën kundër pushtuesve të huaj e veglave të tyre, bejlerëve çifligarë e borgjezëve konservatorë, Eminin nuk e mposhti asnjë pengesë e vështirësi. Atë nuk e përkulën dot armiqtë as me masat e tyre, gjithnjë e më të rrepta, represive. Katër herë u arrestua dhe u burgos ai. Herën e tretë u dënuia me vdekje dhe shpëtoi për qime nga ekzekutimi. Por edhe nga biruca e burgut vazhdonte të shkruante, ndërsa, me t'u liruar, hidhej në luftë për interesat e popullit e të atdheut akoma më i vendosur. Si bir i denjë i vegjëlisë, Emini ishte i zhveshur nga çdo ndjenjë karrierizmi dhe ambicjeje për të zënë poste drejtuese në aparatin qeveritar çifligaro-borgjez të kohës, të cilin e urrente në kulm, dhe qëndroi deri në fund të jetës së tij një luftëtar i thjeshtë, një njeri modest, i pari në luftë, në punë e sakrifica dhe i fundit në pretendime.

Nga studimi i krijimtarisë së tij të pasur publicistike, e cila ka vlerë ideo-artistike edhe për ditët e sotme, ai na paraqitet si një nga gazetarët tanë më përparimtarë të së kaluarës, sidomos në fushën e panfletit dhe të satirës politike. Në shkrimet e tij pasqyrohen idetë iluministe të rilindasve dhe pikëpamjet revolucionare më të avancuara të kohës në vendin tonë.

Ky libër i Petro Kitos, pas atij «Elbasani në luftën për çlirim», që bën pjesë në serinë e botimeve shkencore popullore mbi ngjarjet e shënuara historike dhe jetën e patriotëve dhe të revolucionarëve, është një kontribut, që ndihmon në edukimin e ma-

save punonjëse, veçanërisht të brezit të ri, me traditat përparimtare të së kaluarës të vendit tonë, të cilat populli ynë, i udhëhequr nga mësimet e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha, i ka ruajtur dhe i ka zhvilluar më tej si një armë e fuqishme edukimi e mobilizimi për zgjidhjen e problemeve të kohës.

Mentar Belegu

NXENËS I DALLUAR DHE PATRIOT I FLAKTË

Njohja e jetës dhe e veprës së Emin Matraxhiut paraqet një interes të veçantë, sepse ato lidhen ngushtë me epokën vendimtare të zgjimit të plotë të ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar, me periudhën e kryengritjes së tij të përgjithshme të armatosur, që çoi në shpalljen e pavarësisë së atdheut të vet, me luftën e tij të vështirë, plot të papritura, por heroike, për mbrojtjen e konsolidimin e pavarësisë dhe të tërësisë territoriale të shtetit të ri shqiptar dhe për zhvillimin e tij demokratik. Për realizimin e këtyre qëllimeve të larta lufttoi me një vendosmëri e vetëmohim shembullor, me pushkë e me pendë, edhe Emin Matraxhiu, duke e bërë jetën e tij të shkurtër 32-vjeçare burim frymëzimi për brezat pasardhës.

Drithëshitësit elbasanas, Ismail Matraxhiut, kur lindi Emini, në dimër të vitit 1890, as që i shkonte ndër mend se ky do të bëhej një luftëtar i shqar për interesat e atdheut e të popullit, se do të nderronte vendlindjen dhe prindërit e vet. Ai me të shoqen, Behijen, të ndenjur pranë vatrës, krahas gjëzimit të natyrshëm prindëror që ndjenin duke

soditur fytyrën e njomë të foshnjës, mendonin të shqetësuar se si do t'u siguronin kafshatën tetë fëmijëve të tyre, që duheshin rritur.

Pikërisht në këtë ambient hallesh të familjes së tij dhe të vegjëlisë së shtypur e të shfrytëzuar nga sundimi turk dhe bejlerët vendës, në një periudhë të zgjerimit të vrullshëm të lëvizjes së rilindjes kombëtare për liri e pavarësi, filloj të rritej e të edukohet Emini i vogël me ide patriotike përparimtare.

Kur mbushi moshën 7 vjeç, prindërit e tij, në mungesë të shkollës shqipe, e regjistruan Eminin në shkollën fillore të Hafuz Karadakut. Pasi e kreua atë ai hyri në shkollën «Idadi i Mylqi» (gjimnazi i ulët) të Elbasanit. Por, në të njëjtën kohë, duke qenë nxënës i shkollës turke, Emin Matraxhiu mëson fshehurazi me zell të veçantë, nga mësuesi patriot Hysen Ceka, alfabetin dhe shkrimin e gjuhës së tij të dashur amëtare.

Që në vitin 1897, kur në Elbasan shpërthyen turbullira të mëdha antiturke kundër taksave të reja dhe për liri të mësimit të gjuhës shqipe, në të cilat delte qartë për të parën herë shkrirja lëvizjes fshatit me kërkesat e rilindasve, Emini i vogël çamarrok fu qep pas të jatit duke bërtitur edhe ai nëpërrrugët e qytetit kundër pushtonjësve. Dhe sa më tepër rritej, aq më shumë formohej si luftëtar i vendosur dhe i vetëdijshëm, në kuadrin e veprimtarisë intensive patriotike të viteve të para të shekullit XX, që e bënë Elbasanin qendër të lëvizjes kombëtare shqiptare, gjë që u detyruan ta pohonin edhe vëzhguesit e huaj diplomatikë.

Pa mbushur ende 17 vjetët, Emin Matraxhiun e gjejmë në radhët e para të demonstratës së madhe të vegjëlisë së qytetit dhe të masave të gjera të

armatosura fshatare të vitit 1907, për dëbimin e sundimtarit të korruptuar e të urryer turk, mytesarifit Qemal Pasha dhe për të drejtën e mësimit të gjuhës shqipe. Nga frika se kjo revoltë mund të transformohej në një kryengritje të armatosur popullore, mytesarifi turk u detyrua, që të nesërmen në agim, të largohej nga Elbasani. Suksesi i pjesëshëm i kësaj proteste popullore, forçoi bindjen edhe tek Emini se populli shqiptar mund të fitonte të drejtat e tij kombëtare, lirinë dhe pavarësinë e vendit vetëm me rrugën e luftës së vendosur kundër pushtuesve turqë e veglave të tyre vendëse, bejlerëve e çifligarëve.

Tri javë pas shpalljes së «Hyrjetit» (kushtetutës) më 1908, me iniciativën e patriotëve elbasanash, u hap në këtë qytet shkolla e parë shqipe, iniciativë kjo që u shtri edhe në zonat e Shpatit, Gramshit, Librazhdit, Peqinit, etj. Sipas vendimeve të Kongresit historik të abc-së, që u mblohdh në Manastir, në shkollën Idadije të Elbasanit u krijuau një organizatë e fshehtë e nxënësve patriotë, në krye të së cilës u zgjodh Emin Matraxhiu, nxënës i dalluar i klasave më të larta të kësaj shkolle.

Nën drejtimin e Eminit kjo organizatë, e mbështetur nga klubet patriotike «Bashkimi» e «Vllaznia» të Elbasanit, në bazë të udhëzimeve të Komitetit të fshehtë të Manastirit, zhvilloi një aktivitet intensiv që mësimi i gjuhës shqipe të jepej në të gjitha shkollat turke, duke përfshirë edhe Idadijen.

Të orientuar nga Kongresi i abc-së i Manastirit, ku muarën pjesë edhe përfaqësues të klubit patriotik «Bashkimi» të Elbasanit, patriotët shqiptarë vendosën që të thirrej një Kongres tjetër në Elbasan, i cili zhvilloi punimet e tij nga data 20 deri 28 gusht 1909.

Sic dihet, në këtë kongres historik, veç të tjerave u vendos hapja e shkollës së parë të mesme të vendit, Normales së Elbasanit, e cila do të preqatiste pionierët e parë të arësimit kombëtar. Kjo shkollë i hapi dyert e saj më 1 dhjetor 1909, me drejtor Luigj Gurakuqin dhe profesorë Aleksandër Xhuvanin, Simon Shuteriqin, Petër Dodbibën, Sotir Pecin, etj., të gjithë patriotë të flaktë e njerëz të nderuar e të përmendur për diturinë e tyre.

Me hapjen e kësaj shkolle të mesme shqipe, shumë nxënës të Idadijes, duke përfshirë edhe Emin Matraxhiun, dëshironin të largoheshin nga kjo shkollë turke dhe të kalonin në Normale. Por, me porosi të klubit patriotik «Bashkimi», Emini dhe nxënës të tjerë patriotë vendosën të qëndronin në këtë shkollë, me qëllim që të mbanin gjallë lëvizjen kombëtare në gjirin e saj, të merrnin pjesë në çdo manifestim patriotik dhe t'i jepnin përgjigjen e merituar çdo shfaqjeje antishqiptare.

Nxënësit patriotë të Idadijes pritën nga dita në ditë që të vihej në jetë edhe në këtë shkollë e drejta për mësimin e gjuhës shqipe, e njohur nga kushtetuta (Hyrjeti) turke. Por Emin Matraxhiu nuk kishte besim në zbatimin e kësaj kushtetute. Ai e dinte se të drejtat që ajo u njihet popujve të Perandorisë Otomane do të mbeteshin vetëm në letër. Dhe kështu ndodhi. Prandaj Emini, si kryetar i organizatës së fshehtë patriotike në Idadije, i nxiti nxënësit për veprim. Ja çfarë shkruan patrioti veteran Qamil Çela lidhur me këtë:

«... na nxanësit e shkollës turke Idadije të Elbasanit, bamë grevë dhe kërkue mësohesh në atë shkollë gjuha shqipe, sic premtohesh në shpalljen e Hyrjetit. Greva vazhdoi disa ditë dhe në këtë rast

u bana krahu i djathtë i Min Matraxhiut, që ishte udhëheqësi ynë dhe nga iniciatorët e grevës... Ma në fund gjuha shqipe u fut, me kusht që të përdorej alfabeti arab... Kjo gja nuk na pëlqeu, sepse shqiptarët kishin alfabetin e tyne kombëtar. Për këtë arësy me protestue... Së pari u ankuem në drejtori. Mbasi nuk duel gja atje, i bamë qeverisë nji shkresë të gjatë, me anën e së cilës i kërkojshim që të urdhënonte drejtorinë me lejue alfabetin kombëtar.

Vajtëm në hyqymet, pothuaj tanë nxanësit e shkollës. Mytesarifi, pasi e këndoi shkresën, tha se këtë punë kishte me e pa me vëmendje të madhe dhe se ato ditë do të na thoshte ç'mendonte qeveria pér çështjen e alfabetit. Ai na foli aq bukur dhe me nji mënyrë aq miqësore, sa na u mbushëm me shpresa se qeveria do ta merrte parasysh kërkesën tonë. Të entuziazmuem nga nji shpresë që na lindi nisëm me thirrë: «Rroftë abc-ja kombëtare!»

Mjerisht, pas disa ditësh, na u dha lajmi i keq se qeveria e kishte refuzue kërkesën tonë.

Atëhere, të zemëruem, deshëm me i bamë Valiut të Manastirit nji telegram të gjatë. Puna u ngatërrue keq, mbasi pér ta bamë telegramin drejtoria e postë-telegrafës kërkonte lejen e drejtorisë së Idadijes, dhe kjo nuk dëgjonte me e nënshkrue telegramin.¹⁾

Me përpjekjet e Eminit, me ndihmën e prindërve dhe të patriotëve të klubit «Bashkimi», drejtoria e Idadijes u detyrua ta nënëshkruante telegramin. Por edhe kjo kërkesë u refuzua.

1) «Lufta e popullit shqiptar pér çlirimin kombëtar»
1878-1912, faqe 293.

Pas këtyre ngjarjeve, Emini dhe mjaft nxënës të tjerë, megjithë propagandën demagogjike të xhonturqve se shkolla e mesme shqipe nuk u hapte asnë perspektivë të rinxjeve, u larguan nga Idadija dhe u bënë nxënës të rregullt të Normales, ku të gjitha mësimet zhvilloheshin në gjuhën amëtare me një nivel shumë më të lartë, dhe me frymë kombëtare.

Vërvimi i të rinjve nga të katër anët e vendit për të ndjekur Normalen e Elbasanit shkaktoi një shqetësim të madh te xhonturqit dhe shërbëtorët e tyre vendës. Ata u munduan të nxirrin përsëri pengesa në përhapjen e gjuhës shqipe dhe sidomos në të shkruarit e saj me alfabetin kombëtar. Kështu më 3 shkurt 1910, disa elementë reaksionarë, fanta-tikë, tradhëtarë dhe agjentë të turqve, me hafëz Sulejman Kungullin në krye, grumbulluan në qodinë e medresesë nga dyqind vetë nga fundërrinat e këtij qyteti, dhe u përpoqën t'i detyronin shkollat shqipe që ta shkruanin këtë gjuhë me gërmat arabe të kurianit. Ata tentuan bile ta mbyllnin shkollën normale.

Këto veprime tradhëtare, antishqiptare, indi-njuan dhe zemëruan në kulm rini në dhe popullin patriot të Elbasanit dhe të krahinave të tij, të cilët kundërvepruan menjëherë. Kështu, me iniciativën e rinisë normaliste dhe të dy klubeve patriotike, më 5 shkurt u organizua një demonstratë e gjerë popullore për mbrojtjen e gjuhës shqipe dhe të shkruarit e saj me alfabetin kombëtar. Masa e demonstronjësve të zemëruar arriti rrëth 7000 vetë, në radhët e para të të cilëve ndodhej Emini, një nga iniziatorët më kryesorë dhe më këmbëngulës për shpërthimin e kësaj demonstratë fuqishme.

Ai drejtonte korin masiv të rinisë normaliste, që këndonte këngën patriotike të kohës:

*«Shkronjat tonë janë të arta,
ato duamë»*

Kjo demostratë e madhe proteste, që mori një karakter të theksuar antiturk, i tmerroi xhonturqit dhe veglat e tyre, të cilët u tulatën përkohësisht, por nuk hoqën dorë nga synimi i tyre për të penguar me çdo mjet përhapjen e mësimit të gjuhës shqipe dhe, sidomos shkrimin e sai me alfabetin kombëtar. Nuk vonoi shumë dhe autoritetet turke, nën pretekstin e kërkjesave të disa klerikëve faniatikë shqiptarë, vendosën që gjuha shqipe të mësohej dhe të shkruhej me gërmat e alfabetit arab të kllubit «Mafil». Por ata menjëherë hasën në rezistençën e fortë të rinisë dhe të popullit të Elbasanit.

Pas këtyre trazirave, Emin Matraxhiu, i cili vazhdonte klasën më të lartë të Normales, rendin e tretë të primtares. e mbaroi vitin shkollor me rezultate të shkëlqyera.

Në ceremoninë e mbylljes së vitit të parë shkollor të Normales, Emini dëgjon me vëmendje fjalën e drejtorit të shkollës Luigj Gurakuqi, i cili, ndër të tjera, thotë:

«Shqipnia u lëkund e tanë nga zani i Shkollës normale. Atdhetarët shqiptarë që prej sa kohe kishin nji etje të madhe për mësim e pér dituni, nuk i kursyen ndihmat e veta të begata, e djemtë tanë rrodhën nga të gjitha viset e Shqipnisë e u derdhën këtu në Elbasan. Kështu që mund të thomi me nji pëlqim (gëzim sh.a.) të parrëfyeshëm se kjo shkollë, e cila u hap e u nis me vetëm 50 nxanës, sot ka

të shkrojtun ma tepër se 150, të ndamë në katër rende, nji te shkollës fillore e tri të primtares».¹⁾

I papërshkruar qe gjëzimi i shokëve të Eminit kur këtij të fundit iu dhurua nga klubi patriotik «Bashkimi» një orë e artë, dërguar prej patriotit të shquar Hasan Prishtina për nxënësin më të dalluar në mësime dhe në aktivitete patriotike të Normales. Me këtë dhuratë të merituar, që simbolizonte afrimin e orës së Shqipërisë së lirë e të pavarur, Emin Matraxhiu mbylli fazën e parë të rinisë së tij, si nxënës i shkëlqyer dhe patriot i flaktë.

1) «Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar» 1878-1912 faqe 292.



Emin Matraxhiu
BIBLIOTEKA E SHTETIT
GUFO. ASTER
N. INV. ~~22211~~

22211

LUFTETAR I PUSHKËS DHE I PENDËS

Nxënësit e Normales merrnin nga profesorët e tyre një edukatë të shëndoshë patriotike. Megjithëse Emini qëndroi në këtë shkollë vetëm disa muaj, kjo kohë shërbeu shumë për formimin e tij të mëtejshëm me idë përparimtare.

Një ndër nxënësit e parë të Shkollës normale ishte edhe Avni Rustemi, patriot i shquar, demokrat revolucionar dhe simbol i rinisë patriotike në vitet 20. Emin Matraxhiu njihet dhe miqësohet shqejt me Avniun. Ata bëhen shokë të ngushtë idealesh, gjë që ndikon fuqimisht në veprimtarinë e mëvonshme patriotike të Eminit.

Në këtë kohë, lëvizja kombëtare, që po zhvillohej në të gjitha fushat: ideologjike, politike dhe kulturale-arësimore, u shndërrua në kryengritje të armatosur të viteve 1910-1912, për sigurimin e autonomisë territoriale administrative, si një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një Shqipërie të lirë e të pavarur.

Si kundërveprim, qeveria e xhonturqëve vendosi t'i shuanë këto kryengritje me anë të forcës. Për këtë qëllim ajo, më 1910, nisi në drejtim të

Kosovës forca të mëdha ushtarake të komanduara nga Shefqet Durgut Pasha, i cili me të arritur atje shpërtheu një terror të paparë gjakatar kundër patriotëve dhe popullit, pa përfillur as ligj, as kushtetutë. Pas shtypjes së kryengritjes në këtë krahinë, hordhitë barbare turke u futën në Shkodër.

Emin Matraxhiu, në kontakt të ngushtë me Avni Rustemin, jo vetëm që ndiqte me vëmendje ngjarjet e vendit dhe veprimtarinë e pushtuësve turq, por edhe mendonte e bashkërendonte me Avniun aksione që do të shërbenin për ngritjen e mëtejshme të ndërgjegjes kombëtare të popullit Kështu, ndërsa Avni Rustemi, pa mbaruar viti shkollor, la bankat e shkollës dhe shkoi në Shkodër pëtë vrarë Shefqet Durgut Pashën, që po terrorizonte popullin, vetëm e vetëm pse kërkonte liri e pavarsi,¹⁾ Emini, nga fundi i qershorit 1910, së bashku me disa nga shokët e tij, dogji në tregun e drithit, para popullit, ditën e pazarit, një flamur të madh turk.

Policia turke, me gjithë përpjekjet e tyre përtu shpëtuar ndjekjeve, mundi të kapte dy prej autorëve të këtij gjesti të lartë e të guximshëm patriotik, njëri prej të cilëve ishte iniciatori dhe drejtuesi i këtij aksioni; Emin Matraxhiu. Ky ishte burgimi i tij i parë. Ai mundi të dalë nga burgu vetëm në saje të ndërhyrjeve të miqve të familjes dhe të patriotëve, nën pretekstin e moshës së tij të re si dhe me anë të ryshfetit, që ishte shumë i për-

1) Ky aksion nuk u krye dot, për arësyen se Avni Rustemi, i spiunuar nga agjentët e pushtuesit, u arrestua nga policia turke në të hyrë të Shkodrës.

hapur në regjimin e korruptuar anadollak të push-tuesve turq.

Fryma përparimtare e arësimit që merrnin nxënësitet në Shkollën Normale, edukata e gjithanshme patriotike që u jepnin atyre profesorët e saj, vepri-met antiturke të disa nxënësve revolucionarë e të guximshëm të kësaj shkolle, si Avniu, Emini, etj., dhe ndikimi i këtyre veprimeve në rritjen e ndërgjegjes kombëtare të popullit, shkaktuan një shqetësim të thellë tek pushtonjësit otomanë dhe veglat e tyre. Prandaj ata vendosën të veprojnë me forcë kundër kësaj vale revolucionare në rritje të vazhdueshme. Dhe ja, më 10 gusht 1910, hynë në Elbasan nga rruga e Krabës hordhi të shumta të armatosura turke nën komandën e Shefqet Durgut Pashës, të cilat filluan një operacion të zgjera kundër popullsisë së këtij qyteti. Veprimi i parë i pashait turk, apo hyri në Elbasan, ishte mbyllja e shkollave shqipe, duke përfshirë edhe Normalen, që po bëhej një vatër gjithnjë e më e zjarrtë patriotike dhe shkëndijat e së cilës kishin filluar të përhapshin në të gjithë vendin, nëpërmjet nxënësve të saj.

Gjendja e rëndë e krijuar nga operacioni barbar i Shefqet Durgut Pashës e detyroi Eminin, pas daljes nga burgu, të largohej nga Elbasani dhe të shkonte në Manastir e prej këtej në Stamboll, ku u regjistrua student në degën e veterinarisë. Edhe këtu, në vetë strofkën e pushtonjësve, në kryeqytetin e perandorisë, ai përditë e më shumë e shtonte veprimtarinë e tij patriotike.

Në pushimet verore të vitit 1911, Eminin e gjejmë përsëri në Elbasan. Këtu ai merr inisiativën dhe harton një letër të hapur drejtuar kryetarit të

klubit qendror të shqiptarëve të Stambollit, ku proteston për mbylljen arbitrale të Shkollës normale dhe kërkon ndërhyrjen e këtij klubi që shkolla të hapej përsëri. Në këtë letër me përmbytje të fortë kundër arbitraritetit të xhonturqve, ndër të tjera thuhet:


«... Humbëm nji vit duke bërdhur rrugëve si zogjtë kur u prishet foleja... Besojmë që mjaft ky mundim i padrejtë për ne e duhet t'i cipet fund këtij rendi të vështirë në të cilin ndodhemi, se kësi pengime nuk asht mirë të ngjasin sot në shekullin e njëzetë.

Ju lutemi pra,... që të përpinqeni randësisht e të hapi dyert e saj Shkolla normale e të shofim të rendin në të me gjësim djem nga të katër anët e Shqipnisë».¹⁾

Në fund të letrës janë emrat e dhjetëra ish-nxënësve të kësaj shkolle, pa mbiemrat, për të mos u dhënë shkas pushtonjësve turq për të marrë masa kundër tvre. Në krye të listës së emrave. Emini, duke dhënë si kurdoherë shembullin personal të patriotit të guximshëm, vuri emrin e vet.

Gjatë qëndrimit të tij, në qendrën e Perandorisë Otomane, Emin Matraxhiu ra në kontakt me mjaft patriotë intelektualë, të cilët ndikuan që ai të përvehtësojë më thellë idetë iluministe të rilindasve tanë të shquar. Këtu Emini bëhet shok i ngushtë me patriotin e shquar, bashkëqytetarin e tij, Sali Hida (Hoxha), miqësohet me Hil Mosin, kryeredaktor i gazetës «Shqiptari», dhe bashkëpunon me të përbotimin e kësaj gazete.

1) Gazeta «Drita» e Manastirit, nr. 20 dt. 14 korrik 1911.



Hilë Mosi, me gazeten «Shqiptari» në dorë, në faqet e së cilës Emini filloi veprimtarinë e tij publicistike.

Penda në këtë periudhë kishte një rëndësi të veçantë. Pushtuesit turq e veglat e tyre, ia kishin frikën shtypit përparimtar shqiptar jo më pak se pushkës së luftëtarëve të lirisë. Emini e dinte mirë rolin e madh të shtypit për ngritjen e popullit në luftë për liri e pavarësi. Prandaj ai iu fut me pa-sion debutimit në faqet e gazetave që botonin intellektualët patriotë shqiptarë, sidomos në Manastir e në Sofie, ku mund të shprehte më hapur mendimet e tij për problemet e kohës. Dhe pikërisht gjatë këtij bashkëpunimi filloi të shfaqet edhe talenti letrar publicistik i Emin Matraxhiut, talent që më vonë do të kristalizohej në gjininë tërheqëse të satirës dhe të humorit, që e bëri atë një nga panfletistët më të mprehtë e më të fortë të kohës.

Në pragun e shpërthimit të kryengritjes së përgjithëshme në Shqipëri, e cila çoi në ngritjen e flamurit në Vlorë, në kohën kur kryengritja kishte shpërthyer në malësinë e Mbishkodrës, Emini e kishte të qartë se një rëndësi të dorës së parë merrte demaskimi i demagogjisë kushtetonjëse të xhonturqve dhe i terroristës të tyre kundër popullit shqiptar. Lidhur me këtë ai, më 5 shtator 1911 i dërgon nga Stambolli për botim gazetës «Drita» të Manastirit artikullin me titull «Ç'pret Shqipnia nga qeveria kustitucionale». Në këtë artikull akt-akuzë, ku pasqyrohet dashuria e thellë e Eminit për atdhe-un, shqetësimi i tij për veprimet antikushtetonjëse të xhonturqve, urrejtja dhe zemërimi i madh kundër tyre, ai shkruan:

«... ka vjetë që u themelue Kanun Esasi¹⁾ në Turqi, po fatzeza Shqipni ç'fitoi përveç flakës e

1) Kushtetuta e shtetit.

uturimës së topit?... Asht nji e drejtë e pakundër-shtueshme, në thantë njeriu se gjaku ma i shumtë i shqiptarëve të mjerë në kohë të «liries» edhe ma shumë në kohët e kabinetit të Haki Pashës u derdh. Vetëm nji shpresë na qetëson zemrat e përvulueme tonat, qi deputetët e ndershëm kanë për me i kërkue këto hesape nga qeveria. Le t'ua lamë pra këtë barre deputetëve... e të kthehem i në gjendjen e vështirë të sotme...

E unë guxoj e i them ç'ka ba deri tanis?.. a u vu në praktikë ndonji nga fjalët qi tha qeveria?..

Koha do punë e jo fjalë. Gjer tanë qeveria s'ka bamë ndonji punë qi t'i ngrohi shqiptarët!

A nuk asht nji çdrejtësi e panomtë kjo qi qeverive të kombeve të tjera t'u japid me mijëra lira për të hapë shkolla e 3 milionave shqiptarë t'u japid vetëm 1200?

A ka të drejtë qeveria të shpalli të falimen e përgjithshme edhe t'i mbajë akoma 36 shpirt shqiptarë në burg të Korçës, fëmijët e të cilëve vdesin urijet?..

A ka të drejtë qeveria qi të ngrefi nji komision në Qukës... afér Elbasanit, për të gjetë paret e postës, e i cili ka zanë shumë njerëz të pafajshëm e i mundon si mos ma keq?).

Nji asi farë të këqiash qi kur i ze njeriu me gojë mishtë i dridhet e lot i derdhen vetëvetiu.

1) Më 1911 u organizua në Qukës nga patriotët aksioni kundër postës turke që vinte nga Manastiri. Një pjesë e shumës së madhe të lirave turke që u muarën u vu në dispozicion të klubit «Bashkimi i ri» për mbajtjen e Shkollës normale të Elbasanit.

'Tani a del e drejtë fjala e Vezirit të Madh qì tha në parlament qì s'asht rrahun e s'rrihet asnji rjeri në kohët teme?!

... Ja ku po ju themi dhe nji herë se këto gjana qì po ban sot qeveria i japin rahmet kohës së parë».¹⁾

Ky artikull, megjithëse nuk shtonte çështjen e autonomisë administrative territoriale që kërkohej nga memorandumi i Gérçës i korrikut 1911, shkaktoi shqetësimë në rrëthet qeveritare të Perandorisë Otomane dhe rrrezikoi autorin e tij. Kjo, si dhe rrjedhja e vrullshme e ngjarjeve që shpunë më 1912 në shpërthimin e kryengritjes së përgjithshme shqiptare në Kosovë e në krahinat e tjera, bënë që Emini, duke patur bindjen se liria fitohet me gjak, vendosi të ndërpriste studimet dhe të kthehej në Shqipëri, për të luftuar me armë në dorë për qërimin e atdheut. Ai u bë një nga iniciatorët e krijimit të çetës së studentëve universitarë shqiptarë dhe tok me ta, në verë të vitit 1912, niset nga Stambolli për në Manastir. Në këtë qytet ndodhej qendra kryesore e organizatës patriotike «Shoqëria e zezë për shpëtim», që luftonte për të çuar më këmbë gjithë popullin shqiptar kundër pushtonjësve turqë. Kjo shoqëri i ndau këta të rinj revolucionarë nëpër krahina të ndryshme, me mision që të punonin e të luftonin për zgjerimin e mëtejshëm të kryengritjes dhe vërt shpurjen e saj deri në fund.

Në korrik të vitit 1912 Emin Matraxhiun e gjejmë në Dibër, ku ishte dërguar edhe shoku i tij Sali Hida. Këtu Emini, krahas luftës me armë në

2) Gazeta «Drita» e Manastirit, nr. 43, dt. 10 nëntor 1911.

dorë kundër hordhive turke, nuk le pa e përdorur me zotësi edhe pendën. Më 30 korrik ai i dërgon për botim gazetës «Drita» të Manastirit një artikull larg-pamës me titull «Ç'fund do të marrë kryengritja e përgjithshme?». Në këtë artikull, midis të tjerave, duke polemizuar me disa duaxhinj të pushtonjësve, të cilët e nënvleftësonin dhe minimizonin këtë kryengritje shkruan:

«Mund të na kundërshtohet ndonjë i mnarrë ose i prishun mendsh edhe mund të thotë që s'ka nji kryengritje të përgjithshme shqiptare.

Po lajthitet shumë miku ynë! Sepse po të ldhesh ca edhe të bante nji udhëtim të vockël që nga Vlona e deri në Dibër atëhere do t'i mbushesh mendja se si asht edhe si ngjan puna...

Përgjithësisht në Shqipninë e Poshtme janë ma tepër se 30.000 ngryengritës të bashkuem... po në e lyp puna asht shpresa të shtohen edhe njizet herë ma shumë se g'janë...

Kryengritësit kanë atë fuqi që po të duen deklarojnë edhe vetëqeverimin e Shqipnisë së re».¹⁾

Duke theksuar se kryengritësit janë në gjendje të shpallin vetëqeverimin, Emini shpreh, në këtë artikull, besimin e tij të madh në forcën e pam-poshtur të popullit.²⁾

1) Gazeta «Drita» e Manastirit, nr. 80, dt. 9 gusht 1912.

2) Ky artikull, në analogji, na kujton demaskimin që i ka bërë shtypi ilegal, gjatë Luftës nacionalçirimitare, qëndrimit mospëfillës të disa pseudopatriotëve ndaj kësaj lufte, të cilët duke u bërë korte gjerarkëve fashistë dhe duke lojtur ku-mar në sallat e hotel «Dajtit», llomotitnin se ajo ishte një luftë «kalamajsh». Atyre nuk ua merrte mendja në fillim

Penda e Emin Matraxhiut godiste me forcë jo vetëm kundër shtypjes, shfrytëzimit, demagogjisë dhe terrorist të egër të pushtonjësve turqë e shërbëtorëve të tyre, por njëkohësisht kritikonte me forcë edhe të metat e vetë lëvizjes patriotike, për të cilën ai dëshironte dhe luftonte që të ishte gjithmonë në rritje. Si njeri princiçial, i zhveshur nga frvma e lokalizmit, ai nuk ua kursente kritikat mëblime me shtyp as të metave të lëvizjes patriotike në Elbasan.

I ardhur me mision në këtë qytet, Emini shkroi më 14 gusht 1912 artikullin kritik me titull «Disa radhë nga gjendja e sotme e Elbasanit», ku ai ngrish me forcë kundër një farë plogështie që vihei re në atë kohë në lëvizien patriotike të vendlindies së tij, sidomos në fushën e propagandës, dhe kërkonte që kio lëvizje të dilte sa më parë nga kjo gjendje amullie.

«... Svtë më lotohen kur vëzhgoj gjendjen e sotme të vendlindjes sime dhe kur kuitoi gjendjen e para tri vjetëve — thuhei në këtë artikull.

Ku asht ai Elbasan që mbante 4 a 5 shkolla shqipe në Shpat e gjetkë tri vjet ma parë? Ku vate ai qytet në të cilin lulëzonte shkolla shqip e cunave? Ku asht ai qytet që ndriçonte me punërat patriotike?

se kjo luftë, e udhëhequr nga Partia Komuniste me shokun Enver Hoxha në krye, do të kthehet në një uragan të vërtetë popullor, që jo vetëm do të çlironë vendin, por edhe do të përbyste njëherë e përgjithmonë klasat sundonjëse feudoborgjeze e do ta bënte popullin zot të vendit dhe të së ardhmes së tij socialiste.

Pse vallë pushuen gjithë ato konferenca? Ku janë klubet «Vllaznia» e «Bashkimi»?

Ku asht ai klub që po gremisej nga atdhetarët tanë, të cilët s'lodheshin së vizituemi?

Me të vërtetë godina asht, po njeri vallë a shkel brenda në të si përpara?..

Dihet, po, dhe në mos u dittë le të mësohet, se atdhetaria nuk tregohet me fjalë të thata po me punëra patriotike, me vepra kombëtare... .

Andaj neve lypset të ecim prapë në atë udhë të parë nga e cila kishim lëvdata, fitonim simpati, zemrat na ndjenin gjëzim... .

Për t'u çuditun asht se shumë atdhetarë, të cilëve u kemi qa hallin e ditun, na përgjigjen: «javash javash, s'bahan përnjiherë».

Më poshtë, në këtë artikull, duke marrë para-sysh sedrën e zhvilluar të atdhetarëve elbasanas për vendlindjen e tyre, e cila do të prekej prej kritikave të tij të mësipërme, të përshkuara nga një pesimizëm i tepëruar, i shkaktuar nga dëshira që, në këtë fazë të kryengritjes së përgjithshme, ky, -ytet të gumëzhinte edhe nga aktivitete propagandistike, kulturale dhe artistike, Emini vazhdon:

«S'lipset përsëritur, po mbasi atdhetarët elbasanas janë pak si të ngushtë, andaj u kërkoj ndjesë duke i lutur qi të mos i quajnë për gia të randë fialët e kthiellëta të nji zemre të përvëlueme e të nji biri besnik të Shkumbinit plak.

E shoh të nevojshme t'u lutem edhe një send elbasanasve... të sjellunit e nië orkestre, e cila të përbledhë disa vegla muzikore qi të shtërvisin fëmijiët. dobarem.

Se asht provue qi e madhja propagandë për neve shqiptarët asht shkolla, kanga, konferenca.

Shpresoj se nuk do të mbesi kështu Elbasani, i cili lypset të jetë udhërrëfyesi i shokëve të tij».¹⁾

Por krahas kritikave të tij dashamirëse, që tregonin dashurinë e thellë për Elbasanin, ku lindi e u edukua, dhe krenarinë që kishte për të si qytet me tradita kombëtare në fushën e arësimit e kulturës, Emin Matraxhiu nuk lejonte njeri që të prekte dhe të cënonte pa të drejtë vendlindjen e tij.

Më 10 shtator 1912, ndërsa ndodhej në Manastir, Emini shkruan kryeartikullin me titull «Shkolla normale», në të cilin polemizon me një artikull të botuar në gazeten «Dielli» nga Faik Konica, i cili propozonte që Normalja të transfe-rohej nga Elbasani, pasi gjoja «shumica në këtë qytet janë fanatikë dhe nuk e mbrojtën këtë shkollë kur ishte në rrezik». Ja si i përgjigjet, ndër të tjera, Emin Matraxhiu këtij kalemxhiu kameleon, në artikullin e tij:

«Faik beu thotë se... s'ka më asnji arësyte që Shkolla normale e kombit të mbahet në Elbasan.

Unë përkundrazi thom që Shkolla normale lypset të jetë në Elbasan sikundër asht edhe sot, sepse Elbasani qindron në mes ose ma drejt në kërthizë të Shqipnisë e kësi farë soj shkollarët njisshit a me pak ndryshim vejnë e vijnë në foletë e tyne.

Lypset të mos nxjerrim nga mendja vobegsin që ka pushtuem Atdhen tonë. Klima e Elbasanit asht mesatare, due të thom që as dimni nuk ban aq

1) Gazeta «Drita» e Manastirit, nr. 82, dt. 23 gusht 1912

ftohtë, as vera aq nxehjtë. Në Elbasan harxhimet janë ma të lira e ma të mira se nga çdo vend tjetër i Shqipnisë...

Viti i parë shkollor e provoi fort bukur se Elbasani me të vërtetë ishte i zoti ta mbajë shkollën me nder e ta qeverisnië si lypset...

Shumica e Elbasanit s'asht fanaticë, po përkundrazi asht e sqitet. Ku asht çelun e para shkollë shqipe në krye të javës si u shpall konstitucioni? Ku u ba i pari meting për të mbrojtun shkronjat kombëtare?

... ta zemë se Elbasani s'është i zoti ta mbronte Shkollën normale... C'mund t'i bante vetëm Elbasani nii ushtrive së cilës s'mundi t'ia presë hovin as trimneshë Kosovë? Asht e ditun se Shkollën normale e mbylli nji qeveri ushtërore zonale dhe ai turp i mbet po asai...

C'do të thotë Faik beu që shkruan: S'ka ma asnjë arësve ai Shkolla normale e kombit shqiptar të mbahet në Elbasan?

Asht lehtë t'i fvesh nderin nji qyteti a të kritikosh nji punë për së largu, po asht ma e sigurt e ma e arësveshme të gjykosh për së afërmë e me prova të mira.

Sa për të zgjedhë Vlonën si vendin e Shkollës normale... që propozon Faiku, lypsen anije lufte për ta rueitun shkollën nga nepërkat e nga ujqërit, ai s'ianë dhe aq larg, po afër saj».¹⁾

Krahas përpjekjeve të tij për t'i dhënë një shtytje të re lëvizjes patriotike të Elbasanit në fushën e kujdesit të vërtetë

1) Gazeta «Drita» e Manastirit, nr. 85, datë 13 shtator 1912.

shën e arësimit, propagandës e kulturës, Emini, duke zbatuar misionin e ngarkuar nga «Shoqëria e zezë për shpëtim» e Manastirit, luftoi edhe përgjallërimin e kryengritjes së armatosur në krahinat e vendlindjes së vet. Në qershori-shtator 1912, në afërsitë e Elbasanit, në Bushek, ishte formuar një çetë kryengritësish. Por drejtuesit e kësaj çete ranë nën ndikimin e bejlerëve Irfan Ohri dhe Hasan Biçaku, të cilët, për të mos u mbetur bashkë me gieminë turke, paraqiteshin si përkrahës të krijimit të çetave, me qëllim që të mos lejonin vësielinë ta merrte në dorë flamurin e luftës për çlirimin kombëtar, gjë që do të conte në humbjen e pozitave të tyre. Si pasojë kjo çetë nuk po zhvillonte veprime konkrete të armatosura kundër turqve. Emin Matraxhiu, i veshur si komit dhe i armatosur, shkoi në çetën e Bushekut ku bëri të gjitha përpjekjet për ta hedhur në luftë kundër «halldupit aziatik», duke kritikuar rëndë udhëheqjen e saj për pasivitet, në një kohë kur në viset e tjera të Shainërisë luftohei me armë në dorë kundër këtij armiku. Midis tij dhe dvjkrerëve beilerë u zhvilluan diskutime të ashpra. Megjithë përkrahjen që pati nga patriotët Ali Celirama, Hysen Sulova, etj., që bënin pjesë në këtë çetë, propozimet e tij u hodhën poshtë, nën pretekstin se duhej pritur përgiegia e qeverisë turke ndai 14 vikave të memoranumit të deputetit Hasan Prishtina.

Por puna e Emin Matraxhiut ndihmoi në demaskimin e bejlerëve reaksionarë dhe bëri që patriotët e vërtetë të shkëputeshin nga kjo çetë dhe të krijonin çeta të tjera patriotike, radhët e të cilave i mbushnin kryesisht masat e varfëra fshatare.

Ndërkohë Emini, në vazhdim të misionit të tij, u largua për në Korçë, ku në fillim vajti në cetën e Spiro Bellkamenit dhe më vonë në atë të Themistokli Gërmenjit, me të cilin bashkëpunojnështë, dhe lidhi një miqësi të thellë. Pra. në këtë periudhë vendimtare të luftës heroike që bën populli shqiptar për liri e pavarësi, Emin Matraxhiun e gjejmë me pushkë në dorë në radhët e këtyre çetave, në malet e Shqipërisë. atje ku ishte ndezur flaka e kryengritjes, e cila do të çonte së shnëjeti në ngritien e flamurit, në manifestimin solemn para gjithë botës, të vullnetit të popullit tonë për ta shnallur Shaipërinë të pavarur dhe për ta mbrojtur atë me gjak nën parullën «Ja vdekie, ja liri».

Shnallja e pavarësisë së Shqipërisë, e gjen Emin Matraxhiun në vendlindjen e tij. Sivat orientimit të dhënë nga Ismail Qemali, më 25 nëntor 1912. patriotët elbasanë, ndër të cilat edhe Emini, megjithëse ushtria turke ndodhei akoma në Elbasan, muarën inisiativën dhe shnallën pavarësinë, duke ngritur flamurin kuq e zi. Ja përbaitja e telegramit që i dërguan ata Vlorës për këtë akt solemn:

«Proklamimi i Indipendencës Shqiptare, Elbasan, 12 vjeshtë III (25 nëntor sh.a.) 1328-1912.

Shkëlqesisë së tij Ismail Qemal beut

Vlonë

Gjithë populli ynë, muslimanë e të krishtenë, me nji za, kanë pranue indipendencën e Shqipnisë.

Manastir, e Pyle 13 Janar 1912—1327

or i Pyetje
Panariti

E GAZETES
qëdoja Manastir

UTIMI

..... 40
per nesaj 25

E TURQISE
..... 10 Jr.
6

DRITA

Del në here ne javë

Mpron te drejtat Kombiare politike e literare

Ajkuqet që p
programt partit
tun, qëndruesit q
ne çerta përm
1912 kohë

Ajkuqet që
boshën e që
letur 1912

Përvec tave pë
përmision
dëshv. 1912

He Number 20 para.

Sotë, 27 Mars (2 Prig) 1915.

Me adhur
dëshv.
irasi,
me sh
dëshv.

Dëshv.
Buletin

Shkronje
mëtej

ONE,

te mposh
mëtej
di pse, llo
jet që jo
gjera i pse

Liri e Shqipërisë

Mpron te drejtat e kombit Shqiptar

KOPËSHTI LETRAR

E PERKOHËSHME E PERMUSHME

E BOTON "QARKU LETRAR".

VITI: Parë

Vjeshtë e Tretë

1915

Nr. 1

FIR JU
28 Nëntor 1913

Për ja që bëni mësuar që t'ka kthe
shkronja që dëshv. me këtë numrin

Gazeta «Drita», «Liri e Shqipërisë» dhe revista
«Kopshti lettar», në të cilat Emini ka shkruar rregullisht
si korrespondent i tyre.

Në emën të të gjithë popullit të prefekturës së Elbasanit...» (vijojnë 35 firma).¹⁾

Çfarë mallëngjim dhe gjëzim i papërshkrueshëm për Eminin, autorin e djegjes së flamurit turk dy vjet e ca përpala në Elbasan, kur pa të valojë krenar në qytetin e lindjes flamurin kombëtar, simbol i lartë i lirisë dhe i pavarësisë së atdheut të tij të dashur, për të cilin dhanë gjakun me mijëra dëshmorë të kombit shqiptar!

1) «Dokumenta historike, viti I, Elbasan, prill 1924; nr. 2, f. 38.

MILITANT I ARESIMIT E KULTURES DHE MBROJTËS I VENDOSUR I PAVARESISE SË ATDHEUT

Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë dhe ngritjes së flamurit, më 28 nëntor 1912, qeverisë kombëtare të Vlorës, të kryesuar nga Ismail Qemali, i delnin përparrë probleme të shumta jetike, ndër të cilat ishin edhe caktimi definitiv i kufive të shtetit të pavarur shqiptar dhe i kryeqytetit të tij. Për zgjidhjen e këtyre problemeve preoku-pohej edhe Emin Matraxhiu. Në një artikull, botuar në gazeten «Liri e Shqipërisë» të Sofjes¹), me titull «Kryeqyteti», në vijim të bisedimeve midis Ismail Qemalit dhe Aqif Pashës për këtë problem²), ai shpreh mendimin se caktimi i Elbasanit si kryeqytet do të ishte një gjë e dobishme dhe bille e domosdoshme nga çdo pikpamje, sepse ky qytet ndodhet në qendër të Shqipërisë. Por, për shkak të dallaverave të Esat Toptanit rreth ndërhyrjes së komisionit ndërkombëtar të kontrollit, dëshira e tij nuk u realizua.

1) Gazeta, «Liri e Shqipërisë», nr. 76, dt. 31 maj 1913.

2) «Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj», Tiranë 1962, f. 247.

Me shpalljen e shtetit të pavarur shqiptar dhe formimin e qeverisë së parë shqiptare, problemi i arësimit dhe i kulturës kombëtare, hyri në rrugën e organizimit shtetëror. Ky ishte një problem akut për qeverinë, përfaktin se deri atëherë në vendin tonë vepronin shkolla nga më të ndryshmet si turke, greke, etj., të cilat ishin në shërbim ië atyre shteteve që i financonin. Krahas masave për hapjen e shkollave shqipe, qeveria e Vlorës shtroi edhe problemin e mësimit të gjuhës shqipe për të rriturit, sidomos për nëpunësit. Në lajmërimin e organit të saj zyrtar të datës 17 gusht 1913, theksohej:

«Tani në çdo degë të administratës na lypsen nëpunësa, të cilët ta njohin mirë me shkrim e këndim gjuhën amëtarë... Dhe nëpunësit që ndodhen në shërbim do të jepin një provim në gjuhën shqipe»¹⁾

Prandaj menjëherë, pas krijimit të qeverisë kombëtare, ministri i arësimit, Luigj Gurakuqi, thirri në Vlorë ish-nxënësin e tij të Normales, Emin Matraxhiun, dhe i ngarkoj hapjen e kurseve të mësimit të gjuhës shqipe për nëpunësit e administratës shqiptare. Në fillim ai u muar me organizimin e këtyre kurseve në Vlorë e pastaj në Lushnjë. Ja çfarë shkruan gazeta «Shkëndija» lidhur me veprimtarinë e Eminit në këtë fushë:

«Një punë të palodhshme bëri në administratën e Lushnjës mësuesi patriot elbasanas, Emin

1) Gazeta «Shkëndija» e Lushnjës, Viti III, nr. 2 (80), dt. 11 janar 1973.

Matraxhiu, i cili pas pune e kthente zyrën në shkollë dhe me durim e zell u mësonte nëpunësve gjuhën shqipe».¹⁾

Pasi e kreu këtë detyrë, Emin Matraxhiu u kthye në qytetin e tij të lindjes për të ushtruar misionin fjsnik të mësuesit, edukatorit të brezit të ri. Por këtu, për shkak të pikëpamjeve të tij të avancuara demokratike revolucionare, të cilat u përpoq t'i përhapte edhe në shkollë, ai pati që në fillim grindje me Mustafa Krujën, i cili në këtë kohë mbante postin e drejtorit të arësimit në Elbasan. Thellimi i vazhdueshëm i këtyre grindjeve, e detyroi Eminin të heqë dorë përkohësisht nga arësimi.

Me qëllim që të ndihmonte drejtpërdrejt në përhapjen e gjuhës dhe të kulturës kombëtare, Emin Matraxhiu hapi një librari të vogël te porta e kalasë, në krahun e djathit. Me shpirtin e iniciativës që e karakterizonte dhe dinamizmin e tij, ai sillte nga kolonitë shqiptare të Bukureshtit, Sofjes, Shteteve të Bashkuara, etj., libra të shkrimitarëve patriotë të rilindjes Samiut, Naimit, Asdrenit e të tjerve si dhe gazeta përparimitare në gjuhën shqipe, duke e bërë librarinë e tij vatër edukative për popullin, e sidomos për rininë. Në të njëjtën kohë nga Elbasani ai bashkëpunonte si korrespondent i rregullt i gazetës «Liri e Shqipërisë» të Sofjes, me pseudonimin Haxhi Begari.

Qarku i Elbasanit luajti një rol me rëndësi në përkrahje të qeverisë kombëtare të Vlorës dhe

1) Gazeta «Shkëndija» e Lushnjës, Viti III, nr. 2 (80), dt. 11 janar 1973.

populli i tij patriot dha një kontribut të çmueshëm për konsolidimin e pushtetit të kësaj qeverie të përkoheshme në Shqipërinë e Mesme, duke luftuar me vendosmëri kundër tradihetisë separatiste të agjentit të shitur tek të huajt Esat Pashë Toptanit e vegjave të tij ne Elbasan si Dervish bez Biçaku me shokë. Në këtë luftë vendimtare për ruajtjen e pavarësisë dhe tërësisë tokësore të atdheut, militoi me pushkë e sidomos me pendën e tij të mprehtë edhe Emin Matraxhiu.

Ja çfarë shkruante, ndër të tjera, lidhur me veprimtarinë tradhëtare të Esat Toptanit, në artikullin e tij me titull «Letër nga Elbasani» dërguar gazetës «Liri e Shqipërisë» të Sofjes, në janar 1914:

«Esat Tirana¹⁾ s'po e le rehat vendin. Pandehnim se tani hoqi dorë nga dhëlpëritë e nga ligësitë. Po ja se ku ka dy javë që përpinqet te hedhë trazim e trubullim n'anë të Gollobordës. Këta kattunde nuk është mjaft se i dogji serbi, po tani kërkon t'i djegi edhe Esat Tirana.

Esati nisi nga Durrësi tre njerëz... për të bérë teshqilat (organizacion), d.m.th. që të bëjnë qeveri në Dibër të Poshtme e në Mat, etj... u thonë botës që të bëhen me Esatin, se Esati do haben dhe do Turqinë; vanë në Dibër të Madlie e në Ohri, ku u priten prej autoriteteve serbe me shumë nderime e gjëzime».²⁾

Po në janar të vitit 1914, ai demaskon me forcë veglën e Esat Pashës në Elbasan, Dervish bez Biçakun. Ky i fundit, kundërshtar i 'erbuar i

1) Esat Pashë Toptani

2) «Liri e Shqipërisë» — Sofje, nr 90, dt. 18 janar 1914

qeverisë kombëtare të Vlorës, u ngrit kundër përkrahësit të kësaj qeverie, patriotit Aqif Pashë Elbasanit. Dervish beu përdori si mjet mashtrimi fenë. Mori një ungjill e një kuran dhe iu drejtua katundarëve naivë, duke u thënë: «kush don kurannin të vijë me mua, kush don ungjillin të mos vijë, se Aqif Pasha don të na bëjë kaurë». Por populli nuk u gënjiye nga demagogjia e trashë e këtij çifligari të ndyrë. Shumë veta rrökën armët kundër tij dhe në një përpjekje që u bë afër qytetit, në fshatin Godolesh, Dervish Biçaku u thye. Duke përshkruar këtë bez turkoshak Emini shkruante:

«... djalli na polli një viç tjetër: Dervish Elbasani,¹⁾ bashkë me të vëllanë, Qamilin, (çë të dy këta bejlerë janë djemt e Jusuf bej Elbasanit) ish nisur nga Kavaja me 50 xhandarë që i kish dhënë Esati dhe ardhni kundrejt Elbasanit... Punët e këtyre dy njerëzve, Esat e Dervish, na bënë një të ligë shumë të madhe. Mund të themi se këta dy njerëz janë më të mëdhenjtë e më të ndyrët tradhëtarë të Shqipërisë, dhe se një ditë do të vijë që bota do ta ketë për turp t'u verë djemvet të tyre emrat Esat e Dervish. Këta dy të ndvrë u bënë shkak që të thotë Evropa, jo vetëm shqiptarët janë të ndarë në mes tyre dhe s'kanë bashkim, po edhe vriten si qentë».²⁾»

Ndërsa në korrespondencën e tij të muaiit mars 1914, dërguar po kësaj gazete, Emin Matraxhiu, pasi përshkruan disfaten e tradhëtarëve,

1) Dervish bej Biçaku

2) «Liri e Shqipërisë», nr. 91 dt. 31 janar 1914.

ngre lart kontributin e dhënë nga Aqif Pasha në mbështetje të qeverisë së Vlorës.

«... Këtu duhet që të përmendim — shkruan ai — edhe shërbimet të Aqif Pashës, i cili ka ditë me mbajtë peshën e Shqipnisë tue i kundërqëndrue Esatit, Lal Dervishit dhe Mahmut Biçakut; mundena me thanë se të mos kish ditë Aqif Pasha me e mbajtë kaq mirë peshën e sundimit, sot e tanë Shqipnia do të ish filiqun nan kambë të atij Mahmut Biçaku»¹⁾

Po në këtë gazetë Emini, si korrespondent i saj, trajtonte edhe probleme shoqërore, sidomos të arësimit dhe të kulturës:

«... Elbasani nga ana e shkollave — i shkruan ai gazetës, asht qyteti ma i lumtun... Këtu ka tri shkolla filltare, prej të cilave njena qendrore, me pesë rende. Në këtë shkollë qendrore ka 250 nxanës; në shkollen e kalasë ka 80 dhe në atë Shinkollit 55. Shkolla Normale ka 130 nxanës. Shkolla që u lajmue se u çel për natën po ban shumë përparime. Këto ditët e fundit ka pasun gjer më 70 nxanës, në mes të cilëve ca janë 70 vjeç dhe disa të tjerë 10 vjeç...

Mbi gjithë këto Elbasani ka edhe fatin qì të ketë edhe shkollë muzike. Z. Thanas Floqi, gjykatës në gjykatore të këtushme, po u jep çdo mbramje nga nji orë mësim muzike nja dyzet djelmoshave. Këto mësimë janë pa të holla, dhe z. Floqi punon me zell të madh që të formojë nji orkestër, me mandolina, qitarë, fyell, etj.»

Në këtë kohë shpërtheu kryengritja fshatare

1) «Liri e Shqipërisë» nr. 93, dt. 20 mars 1914.

kundër Princ Vudit, Esat Toptanit dhe feudalëve të tjerë reaksionarë. Me kryengritësit u bashkua edhe fshatarësia e Elbasanit. Qyteti dhe krahinat e tij deri në Qukës ranë në duart e kryengritësve, të cilët arrestuan Dervish bej Biçakun me vëllezërit e tij. Por ata u liruan nga krerët turkomanë, që penetruan në këtë lëvizje të gjerë popullore, e cila pasqyronte revoltën e fshatarësise kundër çifligarëve të shitur e gjakpirës që vunë në ankand paravësinë e atdheut. Si pasojë, megjithë protestat e rrepta të vegjëlisë, kjo rrymë turkoshake, që po merrte frenat e kësaj lëvizjeje në dorë, filloi persekuime kundër patriotëve të vërtetë elbasanas, duke arrestuar, bashkë me shumë të tjerë, edhe Emin Matraxhiun. Pasi qëndroi për afro një vit në burg, Emini mundi të lirohet më 6 maj 1915, me ndërhyrjen dhe të hollat e miqve të tij patriotë. Jecfarë thuhet ndër të tjera në kujtimet e Thanas Floqit mbi kryengritjen e vitit 1914: «Emin Matraxhiu u lishue nga burgu tyke pague shtatdhëtë e pesë mexhita».¹⁾

Edhe gjatë kohës që ishte në burg, penda e tij prej shkrimtarëve dhe gazetarëve të talentuar, lëvizi me shkathësi mbi letrën e bardhë. Emini në burg shkroi historinë e Ali Pashë Tepelenës, duke u nisur nga pozita krejtësisht kombëtare për t'iu kundërvënë varianteve të ndryshme subjektive të autorëve të huaj mbi këtë figurë të dëgjuar të historisë sonë.

Për fat të keq kjo vepër e Emin Matraxhiut

1) «Dokumenta historike» — Elbasan viti I, nr. 8, të-tor 1924.

nuk pa dritën e botimit, me përjashtim të një fragmënti të vogël, të cilin e gjejmë të botuar në të përkohshmen e përmua jshme «Kopshti letrar» të Elbasanit. Me rastin e botimit të këtij fragmenti Emini, si autor, shkruante këto radhë:

«Koha asht pëlhura e jetës... e çdo kut i kësaj pëlhere ka një çmim të shtrenjtë. Duke e pasun gjithnji përmendsh këtë këshillë të çmuashme... unë dojshe mos me e çuemun kot e kot kohën e mërzitshme kur isha në burg të Elbasanit,... po me gjithë ato vështirësi e rreziqe të asaj shultonie, m'u mbush mendja me i vleftë me nji farë mënyre atdheut tem, duke përbledhun jetën e Ali Pashës, për të cilin të huejt kanë shkrue volume të mëdha historish, porse gjithkush mbas pëlqimit të vet... kush gozhdës, kush patkoit. Mue më erди mirë mbasandaj me përdorë nii gjuhë popullore e të pastolisme me fjalë të rjedhme, që ta kuptojë gjithsekush».¹⁾

Në fragmentin është u botua ai vlerëson personalitetin e Ali Pashës, mbron kombësinë e tij shqiptare dhe traditat e moralin e lartë të malësorëve shqiptarë. Ja çfarë shkruan ai, midis të tjera:

«Deri kur iu shkref Shqipnisë vetëqeverimi e liria jetike me vdekjen e heroit të madh Skënder Be Kastriotit, më 1467, e deri nga mezi i shekullit tetëmbëdhjetë, në Historit Shqiptare nuk ndodhet i shënum ndonji burr ma i madh e ma me emën se Ali Pashë Tepelenasi, që leu më 1744 në Tepelenë...

1) «Kopshti letrar», nr. 9, prill 1919.

E ama e Ali Pashës, që thirresh Smihan, ishte nji prej ma të mirash e të mençëmesh bija të Zejnel bej Konicës. Prindt e Ali Pashës që nuk ishin fort të pasëm, si djalin ashtu edhe gocën e vetme, emënit Shihishah, i rritën qysh prej së vogëli me dhelatje e duke iu vu re për së tepërti. Fatkeqësi, si për këto si për t'amën e këtyneve, se posa pat mbushun nandë vjeç Ali Pasha, ra e vdiq i ati. Veli Beu më 1753, duke i lanun së shqipës dy kërthij të njomë e duke e porositun që të ketë kuides për mirërritjen e tyne.

... Asnji historian nuk e siguron se Ali Pasha ishte nga dera e Dervish Hvsenit a Nazifit, sikur e dëften z. Myfit Libohova në historit turqisht që ka shkruem ay vetë. Ky Dervish, si thotë z. Myfit Libohova, nat ardhun prej shtetit të Azies së Vogël emënit Katalie, e si që shkulun s'andeimi nëri nji punë të turpshme, erdhri e zuni vend në Tanele, ku u martue me nji zonië çalamane të vendit.

... Pa ia ditun zakonet të shqiptarëve, dhe pa iau çëmues vleftën q'i abin këta nderit, a ma kjasht. Pa farë turpi, kanë shkrue disa historitës të Evropit, që sikur ia shkelën nderin kardhiqasit si të amës, ashtu edhe të motrës së Ali Pashës, për andai ky desh edhe e shfryni këtë duf, si u rritë e muer fuqi, duke i diegë e i fërgullue...»¹⁾

Gjatë kohës që Emini ndodhej në burg dhe pas lirimit të tij, u krijua një konjunkturë ndërkombëtare e rrezikshme për vendin tonë. Në fillim të shpërthimit të Luftës së parë botrore, Greqia dhe Italia, duke mbajtur një qëndrim asnjanës midis dy grupeve ndërluftuese: fuqive të Antantës

1) «Kopshti letrar», nr. 9, prill 1919.

dhe Lidhjes tripalëshe (blokut qëndror), që e përdorën Shqipërinë si plaçkë tregu, u përpoqën të realizonin qëllimet e tyre grabitqare ndaj saj. Në tetor 1914, qeveria greke ndërmori pushtimin e Shqipërisë së Jugut, ndërsa Italia, si kundërveprim, në dhjetor të po atij viti pushtoi Vlorën. Në mars të vitit 1915 Italia, e joshur prej fuqive të Antantës iu drejtua me një memorandum, duke i njoftuar se pranonte të hynte në luftë përkrah tyre me kusht që të kënaqeshin kërkesat e saj në Adriatik e në Mesdhe. Si rezultat, pas disa javë bisedimesh, më 26 prill 1915, u nënshkrua traktati i fshehtë i Londrës për ndarjen e viesës më të madhe të territorit të Shqipërisë midis Italisë, Greqisë, Serbisë e Malit të Zi dhe nër krijimin e një shteti të cunguar autonom dhe të neutralizuar shqiptar, interesat e të cilit në fushën ndërkontinentare do t'i përfanësonte Italia.

Megjithëse ky traktat famëkeq u mbajt i fshehtë, shtypi dhe personalitetë politike të huaja folën vazhdimisht mbi svnimet e fuqive të ndryshme për copëtimin e Shqipërisë. Përpara këtvre çasteve të vështira, patriotët shqiptarë nuk e humbën toruan por morën masa për riorganizimin e lëvizies kombëtare, duke krijuar në Shkodër, që në këtë kohë ishte bërë qendër e kësaj lëvizjeje, një komitet të fshehtë me pjesëmarrjen e patriotëve nga të gjitha krahinat e vendit. Degë të këtij komiteti u krijuan në të gjitha qytetet kryesore të Shqipërisë, duke përfshirë edhe Elbasanin.

Territori i vendit po shkelej vazhdimisht nga trupa të fuqive të ndryshme. Në qershor 1915 hyri në të ushtria serbe e malazeze, e cila pushtoi Shqi-

përinë e Mesme dhe Veriore, ndërsa nga fundi i vitit 1915 dhe fillimi i vitit 1916, hynë në luftë kundër saj, ushtritë aleate bullgare dhe austrohungareze. Me zgjerimin e pushtimit italian në Shqipérinë e Jugut dhe me hyrjen e ushtrisë franceze në Korçë, në tetor 1916, Shqipëria u kthye plotësisht në një fushë të luftës imperialiste. Përsa i përket Elbasanit, atje hynë me radhë katër ushtri të huaja, duke filluar nga serbët, bullgarët, austrohungarezët e deri te italianët, të cilët hynë nga mbarimi i luftës, pas tërheqjes së austro-hungarezve.

Në këto kushte të rënda, para patriotëve shqiptarë shtroheshin detyra të reja e të vështira për të mbrojtur atdheun. Në luftën e tyre për sigurimin e lirisë, pavarësisë dhe tërësisë tokësore të vendit, ata duhej të shfrytëzonin me zguarsi çdo rrëthanë të favorshme, duke përfshirë edhe interesat e çastit si dhe kontradiktat që ekzistonin midis fuqive pushtuese kundërshtare dhe aleate, lidhur me qëllimet e tyre grabitqare dhe ekspansioniste ndaj Shqipërisë. Ka patur raste që, për të arritur qëllimin e tvre strategjik, patriotët shqiptarë nga ana taktkike kanë bashkëpunuar dhe mbajtur forca të armatosura shqiptare në të dy grupet ndërluftuese, për t'i përdorur në momentin e volitshëm për mbrojtjen e atdheut. Kështu p.sh. ndodhi në Korçë më 1916; ndërsa ceta e Sali Butkës vazhdoi të qëndronte në zonën austrohungareze, ceta e Themistokli Gërmenjit i shkëputi lidhjet me blokun qendror dhe, duke shfrytëzuar interesimin e francezëve për të patur siguri e qetësi në pranavijat, pa besuar në dashamirësinë e tyre, siguroi dëbimin prei Korçë të shovinistëve grekë dhe shpaljen e krahinës «autonome» të Korçës, si një bërthamë të

shtetit shqiptar dhe mbështetje për lëvizjen kombëtare kundër synimeve të Greqisë ndaj Shqipërisë së Jugut.¹⁾

Një demagogji të gjerë zhvilluan në Shqipëri imperialistët austro-hungarezë, por pa dobi. Me t'u vendosur në Shqipëri, ata e paraqiten veten si «mbrojtës» të çështjes shqiptare, dhe me mbështetjen e klerit katolik, u përpinqën më kot ta tërhiq-nin popullin shqiptar kundër armiqve të tyre, duke proklamuar se vinin këtu si «miq», për të përzënë armiqtë e përbashkët. Megjithékëtë një pjesë e personaliteteve politike shqiptare dhe e intelektualëve përparimtarë e patriotë. midis tyre dhe Emin Matraxhiu, i besuan propagandës së Vjenës, shpresuan se Austro — Hungaria nuk do të kundërshtonte rimëkëmbjen e shtetit të pavarrur shqiptar dhe kujtuan se ishin krijuar kushtet e favorëshme përmimin e një qeverie shqiptare, duke u preqatitur edhe për thirrjen e një Kongresi në Elbasan. Këtë Kongres, për zhgënjin e tyre, e ndaluan autoritetet austro-hungareze, nën pretekstin e përhapjes së epidemisë së kolerës, por në fakt për shkak se planet e tyre ekspansioniste synonin që Shqipëria të përfshihej në suazën e Perandorisë së Habsburgëve. Në të njëjtën kohë ata arrestuan, madje dhe internuan disa nga iniziatorët e këtij Kongresi.

1) Më vonë, kur mbreti filogjerman i Greqisë abdikoi d'he Venizelosi, aleat i fuqive të Antantës, e radhiti Greqinë përkrah tyre, autoritetet ushtarake — franceze, mbi bazën e shpifjeve të elementeve grekomane dhe bejlerëve të Korçës, e arrestuan Themistokliun dhe, duke e akuzuar si agjent të blokut qëndror, e dënuan me vdekje dhe e ekzekutuan.

Ndalimi i Kongresit të Elbasanit prej austro-hungarezëve dhe masat tyre represive, u hapën sytë patriotëve shqiptarë. Megjithëkëtë ata, nga ana taktkike, vazhduan t'i shfrytëzonin kontradiktat e fuqive ndërluftuese mbi Shqipërinë, në favor të luftës për rimëkëmbjen e shtetit të pavarur shqiptar.

Emini, në këtë periudhë, si një nga pjesëtarët më aktivë të degës së Komitetit të fshehtë në Elbasan dhe bashkëpunëtor i ngushtë i Aqif Pashës, u ngarkua me detyrën e ndërlidhësit të këtij të fundit dhe të komitetit me Themistokli Gërmenjin, Sali Butkën e udhëheqës të tjerë patriotë të çetave shqiptare në sektorët e trupave të fuqive të ndryshme ndërluftuese.

Duke kryer këtë mision nën maskën e kregëtarit shitetës, Emin Matraxhiu, u rrezikua shpeshherë të kapej prej serbëve, francezëve e grekëve. Dhe nuk i shpëtoi deri në fund këtij rreziku. I kallëzuar nga një agjent i serbëve, ai arrestohet prej tyre me 1917 dhe dënohet me vdekje. Ky lajm i hidhur u përhap me shpejtësi në Elbasan dhe shkaktoi shqetësim të madh tek miqtë dhe bashkëpunëtorët e tij. Patriotët elbasanas Simon Shuteriqi e Filip Papajani, të cilët njiheshin me një familje intelektuale në Pogradec, njëra prej vajzave të së cilës ishte martuar me komandantin e Garnizonit francez të këtij qyteti, kolonelin Mortje¹⁾,

1) Koloneli francez Ogyst Mortje, u martua me pograde-caren Athina Llazar Sotiri me 1914 dhe, pas Luftës I botërore, në fillim të vitit 1920, e mori me vehte në Paris. Më vonë ai u bë gjeneral armate. Ka ardhur herë pas here në

bënë menjëherë përçapje për shpëtimin e Eminit. Me ndërhyrjen e tij pranë komandës së serbëve, aleatë të francezëve, ai u lirua.

Sic dihet, në Kongresin e shtatorit të vitit 1909 në Elbasan dhe në mbledhjen e komisisë letrare të Shkodrës, u vendos që të botohen libra e studime në dialektin e Elbasanit. Në dritën e këtyre vendimeve dhe me qëllim që të përpunohej si gjuhë letrare ky dialekt, në fillim të vitit 1918, u themelua Qarku letrar i Elbasanit, në gjirin e të cilit merrnin pjesë të gjithë intelektualët përparimtarë të këtij qyteti.

Emin Matraxhiu qe ndër iniciatorët e krijimit të

Shqipëri për të shoqëruar të shoqen në familjen e saj. Vizitën e tij të fundit në Pogradec e bëri më 1934. Vdiq si mik i Shqipërisë më 1937 në Nice, ku ishte komandant i garnizonit të zonës ushtarake Alpes Maritimes; në kufi me Italinë. E shoqja, Athina Mortje, së bashku me shqiptarë të tjerë patriotë, që ishin emigruar në Francë në të kaluarën, për shkak të kushteve të këqia ekonomike; kur shkoi delegacioni shqipëtar në Konferencën e Paqës në Paris, i kryesuar nga shoku Enver Hoxha, u takua me të dhe i shprehu urimet dhe gëzimin e saj për çlirimin kombëtar e shoqëror të atdheut. Ajo në vitin 1946 vizitoi Shqipërinë, ku qëndroi 6 muaj. Pas kthimit në Francë shprehte adhurimin e saj për çlirimtarët dhe ndërtuesit e Shqipërisë së re jo vetëm në Paris, Dizhon, Perpinjan, Grenoblë, Nice e vende të tjera të Francës, ku kishte njerëzit dhe farefisin e burrit, por edhe gjatë vizitës që bëri te i vëllai; në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 1961; ku qëndroi më se një vit në qytetin Rocëstër, Nju-Jork. Vdiq në Nice më 1963, në kohën kur pregatitej të kthehej përfundimisht në Shqipëri.

këtij Qarku dhe mori pjesë aktive në të gjithë veprimtarinë e tij. Ai bashkëpunon në organin periodik «Kopshti letrar» dhe tok me patriotët Aleksandër Xhuvani, Simon Shuteriqi, Sali Çeka, Dervish Hima, Ahmet Gashi, Petër Dodbiba, Ismail Haxhihyseni dhe anëtarë të tjerë të këtij qarku, përhap në masat e rinisë e të popullit idetë përparimtare të kohës, organizon konferenca mbi probleme kulturale e shoqërore, mbledh folklorin e vendit, etj.

Por jeta e rëndë, mundimet që kishte kaluar që në fëmini, burgimet e herëpashershme, vështirësitë e luftës së armatosur nëpër çeta dhe detyra e rëndë dhe e rrezikshme e ndërlidhësit të Komitetit të fshehtë e kishin dëmtuar shumë shëndetin e Eminit. Megjithëse i sëmurë nga tuberkulozi, ai nuk e ndërpren punën dhe luftën e tij patriotike.

Pas mbarimit të Luftës së parë botërore, me mbledhjen e Kongresit të Lushnjës, me tërheqjen e trupave italiane nga Elbasani dhe hedhjen e tyre në det në Luftën e Vlorës, ndryshuan kushtet politike dhe, si rezultat i kësaj, edhe detyrat e intelektualëve përparimtarë.

Prandaj Emin Matraxhiun, nga mezi i viti 1920, e gjejmë, për një periudhë të shkurtër, mësues në klasën e katërt të shkollës qendrore të qytetit dhe, nga fundi i atij viti, inspektor të arësimit të prefekturës së Elbasanit.

Gjatë kësaj periudhe të dytë të punës së tij pedagogjike, Emin Matraxhiu lufton me pasion për të kryer sa më mirë misionin fisnik të edukatorit të brezit të ri, përpinqet t'i japë atij dije sa më të plota dhe me ide të larta patriotike, demokratike e përparimtare. Edhe sot akoma, ish-

-nxënësit e tij dhe arësimtarët veteranë të asaj kohe, e kujtojnë me respekt të thellë mësuesin dhe inspektorin e tyre, të dobët e të verdhë në fytyrë, por me një vullnet të çeliktë, që buronte nga dashuria e tij e pakufishme për popullin dhe atdheun, nga urrejtja e thellë për armiqtë e brendshëm e të jashtëm. Mjafton t'i pyesësh, bile të përmendësh vetëm emrin e Eminit dhe ata fillojnë të tregojnë me zjarr për patriotizmin dhe inteligjencën e tij, për aktivitetin e gjithanshëm që zhvillonte ai, për dashurinë atërore me të cilën rrethonte nxënësit e vet si mësues dhe për ndihmën e madhe që u jepte mësuesve në kryerjen e detyrës së tyre, si inspektor arësimi. «Emin Matraxhiu ishte njeri i zgjuar, i talentuar dhe i vendosur në luftën e tij kundër pushtuesve dhe bezlerëve çifligarë — thotë arësimtari dhe patrioti veteran Ahmet Gashi. Në periudhën e rilindjes ai luftoi për lirinë e Shqipërisë dhe pas shpalljes së pavarsisë për mbrojtjen dhe përparimin e saj. Unë isha shok i ngushtë me të, çdo mbrëmje vimin në klub së bashku dhe bisedonim për hallet e vendit e të popullit. Bile nga frika se mos e vrisnin njerëzit e Vërlacit dhe të Dervish Biçakut, që e kishin halë në sy, natën e shoqëroja deri në shtëpinë e tij, i armatosur».

GAZETAR I TALENTUAR DHE I GUXIMSHËM

Në janar të vitit 1921, Emin Matraxhiu, krahas punës pedagogjike, fillon veprimtarinë e tij më intensive dhe më të frytshme për lëvizjen përparimtare demokratike e revolucionare të kohës, duke ia kushtuar gjithë energjitë dhe talentin e tij letrar krijimtarisë publicistike, gazetarisë.

Gazeta e parë shqipe në Elbasan, e përkohshmja politike letrare «Tomori», në faqet e së cilës shkruanin patriotë të ndryshëm si Aleksandër Xhuvani, Simon Shuteriqi, Kristo Dako, etj., doli gjatë pushtimit turk, në mars të vitit 1910. Por jeta e kësaj gazete nuk zgjati, veçse disa muaj, pasi operacioni i egër i Shefqet Durgut Pashës e ndaloi botimin e saj.

Më vonë, sidomos pas shpalljes së pavarësisë, patriotët elbasanas e nájenin gjithnjë më shumë nevojën që qyteti i tyre të kishte një gazetë me një program të përcaktuar politik, ekonomik e shoqëror. Por hyrja e pushtuesve serbë, gjatë Luftës ballkanike, dhe e trupave të disa fuqive të huaja, gjatë Luftës së parë botërore, prej të cilave ato të imperialistëve italianë qëndruan edhe pas mbarimit

të kësaj lufte, e bënë të pamundur realizimin e këtij qëllimi.

Mbledhja e Kongresit Kombëtar të Lushnjës, mbi bazën e vendimeve historike të të cilit u rimëkëmb shteti shqiptar dhe qeveria kombëtare, si dhe hedhja e ushtrisë imperialiste italiane në det në Luftën heroike të Vlorës, e bënë më të domosdoshme problemin e zhvillimit të shtypit kombëtar përparimtar. Ndërsa në periudhën e viteve 1912-1920, detyra kryesore e këtij shtypi ishte të luftonte përuajtjen e lirisë dhe pavarësisë së atdheut, pas vitit 1920, pa lënë mënjanë luftën kundër planeve dhe komploteve të reja të imperialistëve dhe shovinistëve fqinjë, kundër pavarësisë dhe tërësisë tokësore të Shqipërisë, doli në plan të parë detyra e luftës kundër feudalizmit, për një zhvillim demokratik të jetës së vendit.

Pikërisht në këtë periudhë, kur dalin në pah kontradiktat e brendshme klasore, rimëkëmbja dhe zhvillimi i një shtypi përparimtar në Elbasan u bë një nevojë e domosdoshme për patriotët e këtij qyteti. Ata luajtën një rol të rëndësishëm në Kongresin e Lushnjës, punimet e të cilit u kryesuan nga Aqif Pashë Elbasani, dhe tani u binte detyra të luftonin me të gjitha mjetet për zbatimin e vendimeve të rëndësishme të këtij Kongresi dhe për demokratizimin e vendit.

Duke qenë të ndërgjegjshëm për rëndësinë dhe rolin e madh të shtypit në kryerjen e kësaj detyre jetike, elbasanosit patriotë e përparimtarë, vendosën të nxirrnin gazeten e përvjavëshme politike e letrare «Shkumbini», botim i një grupei redaktorësh. Numri i parë i kësaj gazete doli në qarkullim më 14 janar 1921 me drejtor Filip Pa-

pajanin, kryeredaktor Sali Çekën, që të dy patriotë të shquar dhe pjesëmarrës në Kongresin e Lushnjës, redaktorë Aleksandër Xhuvanin dhe Emin Matraxhiun. Ky i fundit, katër muaj më vonë, u bë drejtor i këtij organi.

Në kryeartikullin redaktorial, botuar në numrin e parë të «Shkumbinit», me titull «Mpron Lirinë e Njisinë e vërtetë», që është sintetizimi i nënvizuar i programit politik të këtij organi, bëhet një zërthim i rendësisë së unitetit dhe supjegojhen rreziqet që kërcënojnë një popull, kur nuk është i bashkuar duke e konkretizuar këtë me shembullin e së kaluarës së hidhur, por të lavdëshme, të popullit tonë. Këtë unitet gazeta nuk e kuption si pajtim të luftës së klasave, por si unitet të të gjitha forcave përparimtare në luftë kundër shtypësve dhe shfrytëzuesve që zbatojnë moton «përça eundo».

Ja çfarë shkruhej, ndër të tjera, në këtë kryeartikull:

«Kur në nji popull mungon njisia e të drejtavet si dhe ajo e detyravet, natyrisht mungon bashkimi dhe përparimi shoqnor mbetet pas.

Grindjet, ngatërresarat e përpjekjet ndërmjet vedi, shtohen, shumëzohen e shkaktojnë anarkinë, e cila sjell pas vetiu zgjedhën e huaj.

Atëhere dhuna e shtypja që përdor i hueji, krijojnë nji shtet psikologjik të ri edhe fillon me u kuptue vlefta e lirisë së humbun, arsyaja e njisise dhe nevoja e bashkimit. Elementi intelektual i atij populli i përvishet barrës së randë të rilindjes... me nji guxim të pashtëmangun e plot therori hap rrugën e re dhe e qit në breg të shpëtimit.

Populli shqiptar, i shtypun e i ndrydhun pesë

shekuj rrjesht ndën zgjedhën e nji monarkie absolute, qì qindronte mbështetun mbi fuqina feudale... hoqi shumë të këqia nga të huejt dhe bijtë e vet që bashkëpunuen me ta... Intelektualët e tij i ranë kambanës së rrezikut, edhe pa humbë kohë nisën veprën e shenjtë të tyne, e cila ish rilindja kombëtare».

Po në këtë numër me anë të një artikulli të gjatë, me titull «Shkumbini» shkruar nga patrioti Aleksandër Xhuvani me frymëzim që emocionon lexuesin, bëhet e qartë përse botuesit i kanë vënë gazetës emrin «Shkumbini». Në këtë artikull lufiohen me forcë pikëpamjet e ndarjes së vendit në toskëri e gegëri e të popullit në toskë e gegë, pikëpamje këto reaksionare, të propaganduara prej shekujsh nga pushtuesit e huaj dhe veglat e tyre. Duke hedhur poshtë mendimin reaksionar se lumi i Shkumbinit plak është një vijë ndarjeje, autori thekson me patos patriotik duke e argumentuar historikisht se ai, përkundrazi, është një shenjë bashkimi e lidhjeje midis «dy lagjeve» të vendit, siç i quan Jugun dhe Veriun.

«Shkumini — thuhet në këtë artikull — asht për t'u quejtun për gja të madhe e ka nji vleftë mbë vete nga puna e vendit ku ndodhet e ku ecën. Shkumini asht kufi i të dy lagjeve të mëdha të Shqipnisë...

Sa kujtime të bukura qì përmban ky lum plak me valat e tij, qì kanë pamë sa e sa ngjarje historike të vendit tonë. Sa fort i rreqethet e i knaqet shpirti njeriut kur shef këtë kufi madhështuer të dheut tonë e kur i shkon mendja se nëpër këtë si nëpër nji pasqyrë të gjallë, asht përshkuem e asht endë shumë herë fati, e mbara e e liga e dheut

tonë! Sa e sa herë ujnat e këtij i kanë kapërcyem ushtritë e të dy pjesëve të vendit tonë, për me i dhanë dorën shoqja shoqes, në kohë të rrezikut a për me u défryem në kohë të gëzimit!..

Sa e sa herë ushtritë e Skënderbeut kanë kapërcyem ujnat e Shkuminit pér t'u dalë zot tokavet t'Arianitit e të tjera princëve të Toskenisë! Sa e sa herë ushtritë e Toskénisë kanë kaluem Shkuminin qi të bashkohen me gegët e të luftojnë së bashku ndën urdhën e Divist të Krujës! Sa kalori krushqish toskë, të veshun me fustanella e t'armatosun anekand, kanë kapërcyem atëhere Shkuminin, kur Arianiti nisi të bijën Domnikën e e çoi në Krujë pér t'i shtiem kurorë me Skënderbenë! ..

Shkumini pra, nuk dan Gegënинë nga Toskënia, ai, si kufi i natyrshëm qi asht, i ka afroem e i ka bashkuem këto dy lagje...

Sikundër asht Shkumini shej bashkimi i gëgëvet e i toskëvet e me ujnat e veta e ban të trashë tokën qi ujit, kështu edhe gazeta që muer emnin e ktij, tjetër sy s'ka, veç se ta trashi e ta shtojë këtë vllazni e këtë bashkim, t'i ngrofi mendimet e të dy fiseve pér të mbarën e dheut e të kombit tonë.

Por bashkimi s'mund të jetë i plotë pa një vegël të përbashkët. Pra, «Shkumini» pér ta ndjekun këtë qëllim do të përdori pér mënyrë shkrimi të gjuhës të folmen e Elbasanit, e cila... asht e kuptueshme prej çdo shqiptari, ka me vete majanë e brumin e nevojshëm pér t'u bamë gjuhë e përbashkët e kombit tonë edhe vegël bashkimi e qytetnimi.

Tue përdorë pra këtë gjuhë e këtë mënyrë shkrimi, «Shkumbini», porsi lumi të cilit i ka ma-

rrë emnin e qi asht kufi bashkimi, do të jetë edhe ky nji vegël bashkimi e vllaznimi në mest të gegëve e të toskëve.»

Në kuadrin e këtij programi politik të gazetës «Shkumbini» do të shikojmë në shkëlqejnë, idetë përparimtare, demokratike e revolucionare të Emin Matraxhiut, dashuria e tij e flaktë për atdheun e popullin, talenti i tij i shquar letrar, guximi dhe vendosmëria në luftë për zhvillimin demokratik të vendit dhe për demaskimin dhe dështimin e komploteve të armiqve të jashtëm dhe veglave të tyre kundër shtetit të ri të pavarur shqiptar. E shkurtër ishtejeta e gazetës «Shkumbini» (14 Janar 1921-27 Janar 1922) por i rëndësishëm është roli që luajti ajo për mbrojtjen e interesave të popullit e të atdheut. Një rëndësi të veçantë, në këtë drejtim ka krijimtaria publicistike e Eminit. Si redaktor në fillim dhe drejtor i «Shkumbinit» më vonë, ai u bë kritiku më i fortë e më i talentuar i kohës në Elbasan dhe një ndër më të shquarit në shkallë kombëtare. Përmes shtyllës satirike «Tragézat e mullinit», nënshkruar me pseudonimin «Shigjetja», duke përdorur me aftësi humorin, hiperbolin e deri groteskun e sarkazmën therrëse, Emin Matraxhiu fshikëllon, godet e shpon me majën e imprehtë të pendës së tij, ministra e deputetë reaktionarë, bejlerë çifligarë e borgjezë pseudopatriotë, tradhëtarë të shitura e shovinistë të huaj.

Krijimtarinë e tij publistike, ai nuk e ndau asnjëherë nga veprimitaria e tij patriotike. Përkundrazi, Emini e shikon dhe e përdor gazetën e tij si një mjet të fuqishëm, si një tribunë në të cilën mbështet dhe propagandon idetë demokratike revo-

lucionare të kohës, lufton të vjetërën prapanike dhe afiron të renë përparimtare.

Në prill të vitit 1921, Avni Rustemi, bashkë-luftëtar i Emin Matraxhiut që në Shkollën normale, bën thirrje për krijimin e Federatës «Atdheu», në gjirin e së cilës do të përmblidheshin të gjithë shoqëritë përparimtare të vendit. Emini iu përgjegj me entuziazëm kësaj thirrjeje dhe, tok me patriotë të tjerë elbasanas, aktivizohet me zell të veçantë, nëpërmjet gazetës e jashtë saj, për të propaganduar domosdoshmërinë e këtij bashkimi, duke pregarit kështu terrenin që, menjëherë pas Kongresit të Vlorës për themelimin e kësaj federate patriotike përparimtare, të krijohet edhe në Elbasan dega e saj.

Dhe kjo degë, që njihet si dega e shtatë e Federatës «Atdheu», u themelua me kryetar Emin Matraxhiun. Në mbledhjen e organizuar për themelin e saj, ku Avniu dërgoi si të deleguar Halim Xhelon, Emini mbajti një fjalim të rëndësishëm. Në këtë fjalim, ndër të tjera, ai kritikoi dhe akuzoi rëndë bejlerët elbasanas, në radhë të parë Shefqet bej Vërlacin, të cilët bënин çmos për të penguar bashkimin e forcave demokratike të vendit. Ky fjalim dhe kritikat e vazhdueshme në rubrikën satirike «Tragëzat e mullinit», shkaktuan reagim dhe armiqësi gjithnjë e më të tërbuar ndaj tij, nga ana e klikave feudo-borgjeze në fuqi. Puna arriti deri atje sa që miqtë e tij patriotë, duke parë mospërfilljen e Eminit ndaj rreziqeve që e kërcënonin dhe mungesën e çdo kujdesi për të mbrojtur veten, të merrnin masa për sigurimin e jetës së tij nga kurthet e pabesa kriminale të bejlerëve, si-

domos të Vërlacit, pa e lënë asnijëherë vetëm, gjatë lëvizjeve të tij në qytet e jashtë tij.

Të admirueshme janë energjia, vullneti dhe frymëzimi i këtij biri besnik e kurajoz të popullit të Elbasanit. Megjithëse mushkritë ia brente gjithnjë e më thellë mikrobi i tuberkulozit, megjithëse trupi po i tretej nga ethet e vazhdueshme, krijimtaria e tij letrare publicistike në këtë periudhë arrin kulmin e saj si sasi, cilësi artistike e pjekuri mendimi, veçanërisht në fushën e satirës. Edhe kur shkon për kurim në malet plot pisha të Qafë Shtamës, edhe kur më vonë e futin në burg, ai vazhdoi të shkruajë dhe rubrika e tij satirike «Tragëzat e mullinit» botohej pa ndërprerje, në çdo numër të gazetës.

Gazeta «Shkumbini», e para gazetë përparimtare e Elbasanit, pas shpalljes së pavarësisë, me një program të përcaktuar politik, shkaktoi, që në numrin e parë, reagimin armiqësor të qarqeve reaksionare feudoborgjeze dhe, si pasojë, pati njerëz të lëkundur që e vunë në pikëpyetje botimin e saj të mëtejshëm. Lidhur me këtë, Emin Matraxhiu, në numrin e katërt të gazetës, më 4 shkurt 1921, shpreh ndër të tiera, besimin për të ardhmen e «Shkumbinit», tallet me sektet e ndrvshme fetare. që i sillnin popullit vetëm dëm e përçarje, dhe mban me guxim përgjegjësi për kritikat e tij në shtyllën satirike, duke e shkëputur Shigjetën, d.m.th. veten e tij, nga redaksia e «Shkumbinit». Ja çfarë shkruan ai lidhur me këto tri çështje:

«Katër numrat i mbushi «Shkumbini» e kështu kujtojmë se do t'u dali frika disave që u trembën (!?) se mos u mbyllte!..

Kater qitape janë hak: Teurati, Zeburi, Ungjilli e Kurani.

Katër redaktorë ka gazeta jonë, por mos e harroni jashtë këtij numri asht: «Shigjeta».

Në këtë periudhë, si rezultat i përçarjes dhe i luftës përfuqi të klikave feudaloborgjeze, ra qeveria e Kongresit të Lushnjës, e kryesuar nga Sulejman Delvinë¹), dhe erdhi në fuqi qeveria e Iliaz bej Vrionit, që përfaqësonte cifligarët më të fuqishëm, si Vërlacin me shokë. Duke u kapur nga ky ndryshim negativ në qeverisjen e vendit, Emin Matraxhiu tallet me ata që përpiaen më kot të gjejnë gjurmat e fajtorit, kur atë e kanë përpara.

«T'u them të drejtën — shkruante ai — qysh se hoqi dorë kabineti i Sulejman Delvinës, duke ndigjue gjithfarë fjalësh se cila Këshillë e pati fajin, mue më ka zanun halli nj'aq sa s'më hahet, as më pihet, as qì më flihet! S'kam lanë njeri pa mërzitun duke e pyetun kush e ka fajin... Të gjithë më rrudhin krahët e faleminders nji mik më tha: «unë nuk di politikë, po vetëm të dëftej këtë ndodhie e ti zgjidhe vetë problemin si ta marri mendja...²)»

Më poshtë në këtë shkrim, Emini tregon se si një fshatar, që shkonte në pazar me djalin e tij të vogël e një gomar, gjeti belanë nga mendimet e ndryshme të njerëzve që takonte rrugës. Ai kishte hypur djalin në gomar, por disa i thanë pse e cte vetë në këmbë. Hypi vetë dhe të tjerë i pëshpëritën pse la djalin, atëhere ai mori dhe djalin në vithet e kafshës dhe përsëri e shanë si nuk i

1) Shkaku i dorëheqjes ishte refuzimi nga Këshilli i Lartë i kërkesës së saj për organizimin e zgjedhjeve për Asambleën Kushtettonjëse.

2) «Shkumbini» nr. 1 d. 14 janar 1921.

vinte keq për gomarin. Zbritën të dy dhe prapë e kritikuani pse e ngiste gomarin kot dhe nuk i hypte. Me këtë ndodhi, në formë alegorike, Emini i thotë lexonjësit se në luftën për pushtet të klikave feudoborgjeze, ku vepron ligji: «peshku i madh e ha të voglin», sido që të veprojë një qeveri mund të gjinden shkaqe për ta akuzuar dhe për ta rrëzuar.

Emin Matraxhiu indinjohej thellë kur lexonte në organe të tjera të shtypit shqiptar të kohës shkrime që pengonin bashkimin dhe favorizonin përçarjen. Pikërisht kundër këtyre shkrimeve që conin ujë në mullirin e armiqve të brendshëm e të jashtëm, ngrihet ai në artikullin e tij panflet me titull «Mosni», të shkruar me ndjenjë e pasion patriotik.

«Artikullat e kritikat, që kanë nisë me botue disa gazeta sot në Shqipni — thekson ai, — me thanë të drejtën janë shigjeta të drejtueme për me shpue trupin e atdheut... Sa fatkeqësi për këtë komb! Shikoni këtë shembull të ligë, të dashun këndues, dhe më drejtoni, ju lutem, n'asht se gaboj unë.

Nji nga këto gazeta shkruante një ditë se Shqipninë e banë të krishtenët e bektashijtë!. Nië tietër, mbas disa ditësh shtonte se në e bani Evropa Shqipninë, u mbështet në elementin e krishtenë... .

Peshoni vetë, ju lutem, ç'përshtypje të keqe, ç'dëshpërim e ç'dam sjell ndër popull kjo mënyrë shkrimi, dhe më lini të pyes këta gazetarë: pse vallë për vetullat e Ismail Qemalit e bani Evropa Shqipninë? Apo pozicioni gjografik dhe interesat e kundërtta që kishin armiqt e saj shoq me shoq,

i ndihu qi të fitojë vetëqeverimin e saj? Ç'qenë vallë ato fatosa qi na zbardhën faqen në Luftën e Vlorës? Ç'asht vallë ai heroi i madh, qi shtrini mu në mes të Parisit tradhëtorin e atdheut qi na nxinte faqen përpëra botës?

Sa gia e keqe asht për nji gazetë kombtare ai duke bamun kritikë barabit Qeverin Shqiptare me atë të merhumes Turqi!

S'mund t'i mohojë kurrikush dobitë e shërbimet qi i bainë gazetat kombit. të tyne, por, të mos harrojmë edhe damin qi mund të sjellin ato. Kujtoi se s'ka nevojë për prova, se ngjarjet e viteve të fundit janë nji pasqyrë për këtë dëshmi.

Me nji fjalë, gazetat tonë livoiset të kenë për detvrë, ai të mundohen për bashkimin e kombit, për zgjimin e popullit, për të sque qeverinë e për ta kritikue atë, por jo me nji mënyrë ai t'i hieri dam atdheut e t'u shërbejë interesavet të armiqvet. Për ndryshe mosni!»¹⁾

Kur filloi botimin e saj gazeta «Shkumbini», në Shqipëri zhvillohej fushata e zgiedhjeve për këshillin kombëtar (parlamentin). Këto zgiedhie zhvilloheshin mbi bazën e nië ligji antidekomratik, me votim indirekt dhe me shumë kufizime të tiera në pjesëmarrie, duke përfshirë edhe nëriashimin e grave dhe të ushtarëve nga votimi. Kundër këtij ligji antidekomratik dhe pasojave të tij shumë të dëmshme për vendin, u ngrit që në numrat e saj të parë gazeta «Shkumbini» në përgjithësi dhe Emin Matraxhiu në veçanti. Në një artikull ku kio gazetë merr në mbrojtje fshatarësinë, midis të tjera rave thuhet:

1) «Shkumbini» nr. 6, d. 18 shkurt 1921

«Për fat të keq katundarët nuk do të kënë t'snii përfaqësues të parë.¹⁾ Katundarët do të bëhen vegla të parësisë, të borgjezisë ose të nationalistit. Ligja e zgjedhjeve kérkon që përfaqësuesi i parë të ketë mësim. Duhet pra qi qeveritë shqiptare të kujdesen për t'i dhënë katundsisë mësim qi të mundi të përfaqësohet në Këshillin Kombëtar. Çdo Këshillë Kombëtare pa katundi, nuk mundet të auhet e vërtetë shqiptare. Ajo Shqipni qì përbau shumicën (90%), ajo Shqipni qì paguin, ajo Shqipni qì ka derdhë dhe do të thirret për të derdhë gjakun e saj bujar, sot nuk do të përfaqësohet. Faji s'asht i katundsis, qì nuk u kujdes për mësim, por i qeveritarëvet të kohës qì shkoi, të cilët nuk u kujdesën për zhvillimin e mendjes së saj».²⁾

Emin Matraxhiu ndiqte me vëmendje dallavaret dhe komplotet e elementeve reaksionarë, sidomos të bejlerëve çifligarë, për të shtënë në dorë plotësisht pushtetin me anë të forcës. Ai demaskonte para popullit këto komplotë dhe kérkonte marrjen e masave karshi shkaktarëve, që zakonisht aëndronin në prapaskenë. Pra kronikat që botonte Emini në «Shkumbini», nuk ishin lajmë të thjeshta mbi ngjarjet që ndodhnin, por ai i tregonte lexonjësit edhe pse ndodhnin, kush ishin shkaktarët dhe çfarë duhej bërë për të mënjanuar të keqen. Kështu veproi ai, p.sh., edhe kundër trazirave të shkaktuara me nxitjen e Ahmet Zogut në Mat. në Prill të vitit 1921.

«Një tufë matjanësh t'armatosun, shkruante

1) Zgjedhjet bëheshin dy shkallësh. Zgjedhësit e parë zgjidhnin deputetët.

2) «Shkumbini» nr. 9, d. 11 mars 1921.

Emini, kanë ngritë krye kundër qeverisë e kanë zanë qafën e Shtamës. Si flitet, kjo kryengritje e ka rranjën në Tiranë. Qeveria çoi sot kundër tyne një batalion shëtitës dhe dy mitroloza. Kryetarë të kryengritjes janë Hamit Çollaku e Selim Noka, qi kanë fëmijët nëpër çifliqet e Ahmet Zogollit. Të shofim sa do të na çudisë koha...

Cubat e Selim Nokës... sa diktuen për së largu fuqitë e rregullta të qeverisë e shumicën e tyne, ikën e u arratisën pa farë qëndrimi. Vërtetohet në popull se këta trazimqarë ishin afrue për qëllime reaksiioni e të damshme për qeveri e për çudi thohet se iu kanë pasë que prej Tirane 20 okë duhan e kafe. Lypset qi qeveria të bajë hetime dhe të dënojë këta gjarpëna, qi na rrinë brenda në vatër. Populli i pafajshëm i Matit e priti me të mirë gjithëkah ushtrinë tonë.¹⁾

Që nga numri 20, datë 27 maj 1921, pas transferimit të Filip Papajanit si mjek në Pogradec, drejtimin e gazetës «Shkumbini» e mori Emin Matraxhiu. Duke marrë përsipër këtë detyrë të rëndë, ai i kishte parasysh mirë pengesat politike dhe sidomos vështirësitë ekonomike që do të haste për botimin e gazetës. Në përgjithësi drejtuesit e gazetave përparamtare të kohës, duke përfshirë edhe Eminin, ishin intelektualë patriotë, që nuk kishin asnjë pronë ose të ardhur suplementare dhe me vështirësi përballonin nevojat minimale të jetesës së tyre. Të ardhurat nga abonimet nuk i mbulonin shpenzimet për sigurimin e bazës materiale dhe për shtypjen e gazetës. Qeveritë e kohës jo vetëm që nuk e ndihmonin materialisht shtypin, por edhe

1) «Shkumbini» nr. 16 e 17 dt. 29 prill e 6 maj 1921

lajmërimet dhe urdhëresat e veta i botonin pa pagesë. Drejtuesit e gazetave «Fjala e lirë», «Drita», «Posta e Korçës», «Jeta e re» dhe «Shkumbini» në vjeshtë të vitit 1921 iu drejtuan qeverisë për këtë problem me një letër të hapur të botuar edhe në këto gazeta, në të cilën kërkonin që ajo të caktonte në buxhet një font të posaçëm për subvestionimin e shtypit, duke nën vizuar rolin e madh që lozta ai për bashkimin e kombit dhe zgjidhjen e problemeve të kohës. Ata ishin të bindur se rezultati i kërkeshës do të ishte negativ, por, kryesisht, qëllimi i tyre ishte demaskimi i regjimit obskurantist feudo-borgjez para opinionit publik. Dhe nuk mund të ndodhë ndryshe, pasi shtypi përparimtar ishte halë në sy për qeveritarët reaksionarë. Ndryshe ndodhë me gazetat reaksionare. Ato zakonisht financohen nga feudalët çifligarë, nga borgjezë konservatorë dhe kleri, siç qe p.sh. rasti i gazetës «Elbasani» që doli në nëntor 1922, e subvestionuar nga Shefqet Vërlaci, me drejtor njeriun e tij Shefqet Daiun. Por Emin Matraxhiun nuk e penguan vështirësitë, të cilat vendosi t'i kapërcente me ndihmat e patriotëve elbasanas, durrsakë, etj.

Në kryeartikullin redaksional, me titull «Dy fjale kënduesve», që u botua me rastin e marrjes prej tij të drejtimit të gazetës «Shkumbini», ai i siguronte lexonjësit e gazetës se do të vazhdonte si edhe më parë të mbronte me vendosmëri idealet e përcaktuara në programin e saj.

«Shkumbini», duke ndërrue drejtorin e tij nuk ndron aspak programin qi ka ndjekun deri sot-shkruan Emini. Pa farë ndroje e interesit do të vijojë në fushën e botimit ballë hapët e duke ndjekë udhët ma të dobishme e ma të fitimshme

për atdheun. Do të lavdërojë veprat e shkëlqyeshme, e do të dënojë ato që janë të damshme. Lark tij anësia e mbështetun në personalitet. Ndonfta mund të bahan edhe gabime, por jo duke u ditun e duke dashtun, jo as kurrë duke u shitun e duke u ba vegla e verbët e ndokujt.

Me këtë ideal e me këtë shpirt, duke u mbështetun në djersën e popullit, në rrënkrahjen e rinisë shqiptare, «Shkumbini» nuk ka me u shterrë gjithmonë, e në asht se do t'i shërbejë vendit të vet ndopak, ka me qenë një gjëzim, një kënaqësi për 'të'.

Por ndërsa ujët e Shkumbinit plak, megjithëse nuk shter kurri, shtohet e pakësohet sipas stinave, guximi dhe lufta e Eminit nepërmjet gazetës «Shkumbini» për të mirën e atdheut, në radhë të parë për bashkimin e popullit dhe sidomos për t'u bërë ballë synimeve grabitqare të shovinistëve grekë e jugosllavë për ndryshimin e kufive të viti 1913, rritej vazhdimisht.

Në këtë kohë në parlament ishin krijuar dy grupe ose «parti» politike, siç i quanin: «Partia Popullore» dhe «Pártia Pérparimitare». E para përkrahte platformën e Kongresit të Lushnjës dhe krahas bejlerëve dhe elementit borgjez konzervator, në gjirin e saj përfshinte edhe deputetë demokratë si Fan Noli, Stavro Vinjau, etj. Ndërsa e dyta, veç iridentistëve të pakët kosovarë si Hasan Prish-tina me shokë, përbëhej kryesisht nga çifligarë të mëdhenj dhe ish-ministra të qeverisë së Durrësit, kundërshtarë të vendimeve të Kongresit të Lushnjës. Në parlament kishte gjithashtu edhe disa deputetë që nuk bënин pjesë në asnjë grup por anonin nga të frynte era, herë nga njëri e herë nga tjetri grup.



Emin Matraxhiu: nga e majta me Filip Papajani (Lipi)
ish drejtor i gazetës «Shkumbini»

I shqetësuar nga lufta pa princip që zhvillonin midis tyre këto grupe, për të zënë kolltuqet dhe për të nxjerrë sa më shumë përfitime, duke shkelur e marrë nëpër këmbë interesat e larta të atdheut e të popullit. Emin Matraxhiu, boton kryeartikullin me titull «Partitë politike», në të cilin dënon rreptë me argumenta të forta vetë krijimin e këtyre grupave, si një kopjim të thjeshtë, të parakohshëm e të dëmshëm për vendin tonë, të sistemeve politike të shteteve të tjerë.

«Në vallen e re po vërtitemi duke marrë she mbull të tjerët — thekson ai — ... si majmunët do përpinqemi t'i shëmbëllejmë botës, si papagallët do kërkojmë të flasim një dialekt qi s'kemi nevojë, një gjuhë qi s'e kuptojmë dhe do këndojmë një kangë qi s'e kemi për zemër...»

Pas mendjes sonë asnji nevojë nuk qe për partina, as një shkak nuk shkaktoi të damit mbë dysh të Këshillës Kombëtare veç t'interesuemet. Sot për sot s'kemi teori të ndryshme qeverimi; as Partia Popullore nuk asht me mendimet e Haxhi Qamilit, as Përparimtarja me Esatin.

Partia «Popullore» me një program të bukur na u shfaq dhe, duke heshtë mbi mënyrën kryesore të qeverimit — mbretnuer a republikan, rrjeshton thashetheme të lehta për t'i shkrue dhe të randa për t'i vumë në veprim.

Partia «Përparimtar», pa program të shfaqun gjer sot, kërkon të forcohet për një qëllim qi ende s'na asht shfaqun.

Duke marrë parasysh se të dyja partitë janë formue prej elementesh qi nuk janë homogjenë ose ma mirë me thanë me mendime, principe e dëshira të ndryshme, e qi vetëm rasti e ka prumë me u

gruposun (mbase për nji kohë krejt të shkurtën), na duket se do të ishte shumë ma e dobishme që të pritnin dhe ca kohë gjersa t'i studjonin mirë karakterin dhe mendimet e njeni-tjetrit e pastaj të shfaqeshin përparrë kombit si partina.

... dëgjojmë aq shumë kandidatë ministrash a këshilltarësh e prefektash ndër deputetët, sa që t'ishte që t'u mbushesh dëshira, mund të ngjiste që të mbeteshin zbrazë shumë selia të parlamentit.

Koha shkon, dhe atdheu, sikurse me qenë sot nii provincë e Turqisë, qeveriset me kanunet e saj. Në vend që të merremi me andrrat e të ngjitunit në seli, do të jetë ma mirë t'i përvishemi punës së organizimit të shtetit me seriozitet. Ata që do të tregohen të zotët në këtë shërbim, i thërrët ndera e vet për me zanë selinë e detyrës¹⁾!»

Shqetësimi i Emin Matraxhiut mbi pasojat e luftës së paprincipë midis dy grupeve politike u vërtetua. Përcarja dhe grindjet në gjirin e parlamentit, i shtuan akoma më shumë vështirësitë e mëdhë të qeverisë së Iliaz Vrionit, të shkaktuara nga politika armiqësore diversioniste që ndiqnin kundrejt Shqipërisë Greqia dhe Jugosllavia, veçanërisht nga gjendja e nderë në kufirin shqiptaro-jugosllav. Kryebajraktari Marka Gjoni, i prekur që nuk iu rezervua ndonjë post i rëndësishëm në shtetin e rimëkëmbur shqiptar, shfrytëzoi pakënaqësinë e drejtë të malësorëve mirditorë, të rrrenuar ekonomikisht, ndaj moskokëçarjes së qeverisë, u hodh në Jugosllavi e, duke u bërë vegël e shovinistëve serbë dhe me ndihmën e tyre, ngriti krye

1) «Shkumbini» nr. 22, d. 10 qershori 1921.

për shkëputjen e Mirditës nga Tirana. Qeveria e Iljaz Vrionit dërgoi trupa për mposhtjen e kryengritjes.

Këto trazira të brendshme, sa të hidhura, aq edhe të rrezikshme, sepse lehtësonin realizimin e qëllimeve grabitqare të fqinjëve shovinistë, e kishin burimin në pazotësinë e qeverisë për të fituar besimin e popullit dhe për ta bashkuar atë rrëth saj. Me dhimbje të thellë për popullin që, duke rënë viktimi e luftës së klikave feudoborgjeze për pushtet, po derdhte përsëri gjakun e tij, dhe me zemërim të papërbajtur për shkaktarët e kësaj gjakderdhjeje, Emin Matraxhiu, në kryeartikullin e tij me titull «Fjalë të reja e mentalitete të vjetra». ngre një akt-akužë të vërtetë kundër qeverisë së Iljaz Vrionit.

«Sot asht tue u vra shqiptari me shqiptarin! Sot nji krahinë e përmendun e Shqipnisë — Mirdita, asht tue u la në gjak të shqiptarëve. Punë fort e ligë; punë e keqe fort! Kush e ka faiin?»

Më poshtë, duke theksuar se qeveria e Iljaz bej Vrionit nuk bëri asgjë për Shqipërinë, sidomos për atë të Veriut, «as ndreqi rrugë, as shtroi ura, as çeli treg, as vuni rend e rregull», Emini vazhdon:

«Në punë tek asht, të kallxoj vetë, ç'të mirë i suell qeveria e tij Shqipnisë së Epër, qi ta tërheqi prej vedit besimin e saj? Këtu, posë mungesash të kësaj qeverie, kishim me mujtë të njohim edhe snumë e shumë gabime e shpërdorime autoriteti të bame prej anet të kësaj qeverie, por ngushtica e fletores na pengon të zgjatena ma tepër ndër këto fjalë.

Tash, nji qeverie qi s'asht e zoja t'i sjellë nji të mirë vendit edhe asht ngushtuem të ngrefë luftë

dy tre herë në vit me popullin e vet, do me thanë se gjindja e saj ende s'e kanë mentalitetin e përbamë, për me vu nevojat e kohvet të sotshme e të sistemave të reja. Edhe turqit e rij dhanë kostitucionin e mbasandaj çuen Durgut Pashat e Xhavit Pashat me topa e mitraloza nëpër Shqipni...

Por, mos të harrojë qeveria se ka thanë i moçmi që kush mbjell erë, korr duhië (fortunë — sh.a.)¹⁾

Qeveria e Iljaz Vrionit dhe qarqet e tjera sundonjëse feudo-borgjeze, e kishin halë në sy gazetën «Shkumbini» dhe drejtuesin e saj Emin Matraxhiun. Ata e përgjonin që t'u vinte në shteg dhe ta goditnin. Dhe këtë rast ua dha kryeartikulli që përmendëm për çështjen e Mirditës. Me nxitjen edhe të armikut të tij të betuar Shefqet Vërlacit, si dhe të dhëndrit të përkohshëm të këtij krye-feudali, Ahmet Zogut, të cilin Emini e kishte vënë gjithashtu në majën e pendës së vet, duke demaskuar veprimtarinë e tij puçiste, qeveria reaksionare e Iljaz Vrionit, më 21 shtator 1921, arrestoi drejtorin e «Shkumbinit». Ky ishte arrestimi i tij i katërt.

I shoqëruar nga xhandarët, Emin Matraxhiu dërgohet në zyrën e hetuesisë politike në Tiranë. Në vendimin e prokurorisë për arrestimin e tij, thuhej:

«Faji qi po i ngarkohet, me qenë se formon një faj kriminal politik, kërkoj qi të vendoset për të pandehurin Emin Matraxhiu, në mënyrë që hetimet të vazhdojnë tue qenë i rreshtuem...»²⁾

1) «Shkumbini», nr. 30, d. 16 shtator 1921

2) Arkivi i Shtetit — dosja e gjyqit politik 1920-1924 vendimi nr. 31, datë 20 shtator 1921.



Emin Matraxhiu i shoqëruar nga xhandarët, gjatë
arrestimit të tij të katërt më 1921

Një ditë pas arrestimit të Emin Matraxhiut, gazeta «Shkumbini», botonte kryeartikullin me titull «Liria e të drejtat e shtypit duhen caktue», në të cilin tërhiqte vëmendjen e opinionit publik mbi rrezikun që i kanosej shtypit përparimtar nga masat arbitrale të qeverisë kundër botuësve të tij.

«Telegrafi na bani me ditë, më 21 të këtij muaji, se drejtori i kësaj gazete kërkohesh me nxitëm në Tiranë — thuhej në këtë krveartikull. — Edhe kurajos së tija ma në fund iu kish gjindë dermani për me e thye. Ndënligji i posaçëm ose ma mirë freni i gazetarëvet, që u vu këto ditë në veprim e gjet që... prishja e qetësisë së vendit rriddha nga kryeartikulli i numrit 30 të gazetës «Shkumbini... Puna ka me e tregue në asht tradhëtor apo patriot... por ku shkon ndera e prestigji i shtypit kur drejtuesit e tij merren nëpër kambë e burgosen si me qenë elementi ma i damshëm e ma i rrezikshëm? Në vend që të nderohen e të çmohen për flitë e theroritë që bajnë duke humbun kohën, interesat edhe fuqinë e tyne të vogël ekonomike, përkundrazi përbuzen e burgosen...»

... Me këtë situatë që u krijue sot me ndënligjin e posaçëm e me këto masa që asht duke marrë qeveria, besoj se nuk asht keq që të bahet në kryeqytet nji mbledhje e drejtorave të gazetave përmes bisedue mbi të drejtat e detyrat e shtypit shqiptar. Se vëse po të vazhdoië puna kështu si asht nisë, nuk asht çudi që të piqen një ditë gjithë bashkë në burgun e kryeqytetit».¹⁾

Po në këtë numër, «Shkumbini» denoncon kon-

1) «Shkumbini», nr. 31, dt. 22 shtator 1921.

trollin arbitrar të redaksisë së gazetës nga policia e Elbasanit:

«Polici z. Q.D., pas urdhënët qì i qe dhanë, erdh edhe shkeli zyrën e «Shkumbinit» — thuhet në lajmin e botuar për këtë kontroll. Për çudi, nga qì s'dinte rregullat e detyrës apo nga tjetër shkak, pa qenë njeri në zyrët e pa bamë formalitetet e ligjshme, hapi banko e çekmexhe për me gjetun fletët e numrit 30 të gazetës «Shkumbini», të cilët policia kish marrë urdhën me i mbledhë. Vallë a kështu thotë rregullorja e policisë?».

Gjatë këtij kontrolli u muar dhe u zhduk në dorëshkrim një dramë e Emin Matraxhiut, që trajtonte një problem të rëndësishëm shoqëror, problemin e korruptionit dhe të degjenerimit të familjeve të mëdha feudale dhe veprimet pa skrupull të bejlerëve dhe pashallarëve reaksionarë ndaj vegjëlisë. Këtë temë ai e shtjellonte duke u nisur nga ngjarje konkrete, të marra nga veprimet e turpshme kriminale të Ismail Pashë Vërlacit (babai i Shefqet Vërlacit) dhe qehajallarëve të tij, që rrëmbenin vajza të reja nga familjet e varfëra, për të kënaqur epshet shtazarake të padronit të tyre të shthurur, duke i braktisur pastaj në mëshirë të fatit. Pashai arriti deri atje sa disa prej këtyre vajzave që i rezistonin, t'i vriste për të zhdukur dëshminë e gjallë të veprimeve të tij të ulëta, ndërsa të tjera përfundonin deri në vetëvrasje, duke mos duruar turpin.

Armiqtë e Emin Matraxhiut menduan se duke e arrestuar atë do t'i thyenin kurajon që e karakterizonte si patriot e gazetar demokrat revolucionar. Por ata gabuan. Emini edhe nga burgu vazhdoi të lëshonte shigjetat e kritikës së tij të mprehtë

përmes rubrikës satirike «Tragëzat e mullinit». Edhe në një numër të «Shkumbinit» që nuk ka tekst për këtë rubrikë të dashur të lexonjësve, redaksia e gazetës e la shtyllën e saj të bardhë, duke vënë në mes këtë shënim: «Ngritun nga censura...»¹⁾ Në këtë mënyrë gazeta denonconte para lexonjësve hqjen arbitrarë, prej censurës policore, të një shkrimi satirik të Emin Matraxhiut, dërguar nga burgu.

Një ditë pas arrestimit të tij, Emini, në «Tragëzat e mullinit» me një alegori, ironi dhe humor të hellë shkruante:

«Mjerisht nuk e kam kuptuem deri sot shkakun pse mue shumë sende më bajnë impresione të këqia e të paka janë ato që më bajnë impression të mirë. Ndofta gaboj se më mbyt pesimizma, apo pse mendoj jashtë mendimit të njerëzve!.. Por edhe kjo sikur të jetë e vërtetë s’kam fajin unë, por natyra ime!.. Nji kështu pra:

Më vjen keq që ministri i luftës nuk merr vesh bisedimet e këshillit ministruer.

Më vjen keq që gjithë ato ujna të ftohta derdhen kot nëpër malet.

Më vjen keq që ato farë drunash të gjatë kramasiten nëpër pyje.

Më vjen keq që në shtetin shqiptar, ka ende nëpunës turq!..

Më vjen keq që ma në fund ra në grackë (burg) Shigjeta».²⁾

1) «Shkumbini» nr. 32, dt. 7 tetor 1921.

2) «Shkumbini», nr. 31, dt. 22 shtator 1921.

Në një shkrim dërguar nga burgu, Emin Matraxhiu duke treguar gjoja një të paktën i përshkruan lexuesit kushtet katastrofale për shëndetin e tij të dobët, në të cilat e mbanin autoritetet qeveritare, dhe denoncon me forcë regjimin feudo-borgjez, që sundonte vendin, duke nxjerrë në pa rezistencën e vegjelisë, rezistencë që shprehet deri në atentate kundër shtypësve dhe tradhetarëve nga ana e patriotëve trima si Avni Rustemi me shokë, të cilët bejlerët çifligarë i quanin «harbutë».

«Nëpër vende që kanë lagështinë e përbimi tulla të ftohta — shkruan ai, gjumi u bika miqist i randë e njeriu paka gjithfarë andrrash të këqia... Kështu pësova dhe unë vetë mboramë. S'kishte kalue mezi i natës, kur të randët e dheut më kishte kapallisë keqas, prej gjumit të keq q'ishi duke bamë. M'u ba sikur më kishin burgosun më nji vend qe kishte armë, kërbaca, fallaka, fishekë, bajoneta e gjithë të zezat, e unë rrisha tue shikue habitshëm e friksueshëm nëpër terr... M'u ba sikur po shkoja buzë Shkumbinit, aty afër Peqinit, dhe ndiva disa të zbrazuna pushkësh bam! bam! edhe shpejtova e pyeta: ç'asht ba? E vranë, m'u përgiegjén: Ata!»

Më poshtë Emini, pasi thekson se iu bë sikur vajti në Durrës e në Lezhë dhe i ndodhi po e njëjtë gjë, vazhdon:

M'u duk sikur kisha shkue në Paris në hotel... Kur dbe këtu po bam! bam! E vranë më thanë. E marrkën mbë qafë (!) thashë dhe pyeta: cilët e vranë? Ata! ishte përgjegja që mora! (është fjala për vrasjen e Esat Toptanit nga Avniu — sh.a.). Vendosa e u shpërndau. Erdha në Vlonë. Kur në mes të nji karakolli të qytetit e meje, përsëri u

ndinë zana: bam! bam! Edhe këtu po Ata! E vranë më tha njeri që kisha pranë. Po cilët janë Ata?! e pyeta zotninë që paç afër. Mos ban za, tha, janë Harbutët!. . Zemra më hofte gjithnjë, fryma zu të më zihesh, e prej frikës së madhe u ngrita menjipherë mbë shtrat duke britë: Harbutët, si Harbutët!.

Duke ndi britmën teme gjendari që kishte rojen. erdh e më tha: s'janë Hajdutë, zotni, no bjer e flij, se të ruejmë ne. Kur mblodha mendjen e shikova, unë isha me të vërtetë brenda»¹⁾.

Arrestimi dhe burgimi i këtij gazetari të ri të talentuar e të guximshëm, shkakttoi një zemërim dhe indinjatë të thellë në të gjithë vendin. Intelektualët patriotë e ngritën fort zërin e protestës. Shoku i idealeve të Eminit. Avni Rustemi, në emër të gjithë rinisë revolucionare dhe të patriotëve të grumbulluar në Federatën «Atdheu», kërkoi lirimin e tij të menjëherëshëm. Deputetë demokratë bënë interpelancë në parlament, duke kritikuar ashpër qeverinë për shkeljen e lirisë së shtypit.

Para këtij presioni të gjithanshëm, qeveria e Iliaz Vrionit, pasi e mbaiti Eminin 23 ditë në burg, u detvrua ta lironë, duke i hequr të drejtën e dreitimit të gazetës «Shkumbini».

Ky burgim i shkurtër miaftoi për t'i dhënë grushtin fatal fizikut të tij të tretur nga bacili i kokut. Shëndeti i Eminit, pas kësaj, mori përfundimisht tatënietën. Ai lëngoi gjatë në shtrat. Më gjithatë, edhe i sëmurë rëndë, Emiri nuk hoqi dorë nga puna. Duke ndjekur gjendjen politike të

1) «Shkumbini» nr. 33, dt. 14 tetor 1921.

brendshme e të jashtme, përmes shtypit dhe miqve e të afërmve që e vizitonin përditë, ai vazhdoi të shkruante pa ndërprerje për shtyllën satirike «Tragëzat e mullinit» si dhe artikuj të tjerë për «Shkumbinin». Emri i tij nuk figuronte më si drejtor i kësaj gazete, por në fakt ai mbeti deri në fund fryshtuesi, redaktori dhe drejtuesi i saj i vërtetë.

I prekur thellë nga kujdesi që tregoi rinia revolucionare e Tiranës, kur ishte në burg, dhe nga urimet e shumta që i erdhën nga të katër anët e vendit, pas lirimit të tij, botoi këtë falnderim:

«U falemnderit gjithë atyne miqve që më uruen lirimin tem prej burgut, me telegramë, letra e kartëpostale.

Gjithashtu edhe djelmënisë së Tiranës për vizitat e shpeshta që më bante kur isha i burgosun».¹⁾

Parashikimi i Emin Matraxhiut, shprehur në kryeartikullin «Partitë politike», lidhur me rrezikun që paraqiste për mbrojtjen dhe konsolidimin e Shqipërisë së pavarur lufta e paprincipitë midis dy grupeve politike në parlament, po vërtetohej për ditë e më shumë.

Trazirat e Mirditës, të kurdisura nga shovinistët jugosllavë me tradhëtarin e shitur, agjentin Marka Gjoni, u dhanë mundësi armiqve të Shqipërisë të intensifikoinë veprimet e tyre të armatosura grabitgare në kufitë e saj veriorë. Këtë gjendje të vështirë në veri e shfrytëzuan edhe shovinistët grekë. Në një mbledhje të përsjithshme të «vorio-epirotëve», organizuar më 25 shtator 1921, ata kërkuan pushtimin e Shqipërisë së Jugut nga ushtria greke.

1) «Shkumbini», nr. 34, dt. 21 tetor 1921.

Kjo gjendje po bëhej akoma më e rëndë për ta përballuar, nga acarimi i luftës midis grupeve të ndryshme politike, nga përpjekjet e Ahmet Zogut dhe oficerëve nën ndikimin e tij për të peshkuar në ujë të turbullt, që të uzurponin pushtetin, nga propaganda e veprimitaria e klerit katolik të Shkodrës për kompromis me kërret e shitur bajraktarë të Mirditës dhe nga paaftësia e qeverisë reaksionare të Iljaz Vrionit.

Përpara presionit të popullit të alarmuar nga rreziku që i kërcenohej integritetit tokësor të atdheut, të dy grupet politike të parlamentit u detyruan më 11 tetor 1921 të shkriheshin përkohësisht në një grup të vetëm të përbashkët, derisa të stabilizohej gjendja në kufi, grup që e quajtën «Bashkim i shenjtë». Vendimi i narë i këtij grupi ishte rrëzimi i qeverisë së Iljaz Vrionit dhe caktimi i një komisioni, në të cilin bënin pjesë edhe Bajram Curri e Avni Rustemi, për të propozuar qeverinë e re. Më 19 tetor u krijuat qeveria e borgjezit konservator Pandeli Vangjelit, në gjirin e së cilës nuk kishte asnjë cifligar. Kundër kësaj qeverie ishin cifligarët e mëdhenj, Vrionasit e Shefget Vërlaci, të cilët e quajtën qeveri «harbutësh».

Duke trajtuar çështjen e rënies së qeverisë së Iljaz Vrionit, Emin Matraxhiu godet veprimitarinë e saj nepërmjet disa porosive që jep për pjesëtarët e kabinetit të ri. Ja çfarë thuhet në këtë shkrim tërheqës satirik:

«A thue se nuk e zunë qivnahet e mia kabinetin Vrion që më mbajti 23 ditë në burg mbi tulla? A thue se nuk ia banë mirë këtij kabinetin koalicioni që i dhanë votë mosbesimi për faqe të zezë, e ndoshta për nderë (sic) si pati dëshirën vetë krye-

ministri, i cili i tha dërgatës së grupit të shenjtë që nuk jap dorëheqjen, por due të bie me nderë?! Unë them se nji kryetari të kabinetit që i ban për asgja çastet e rrezikshme, ai që vepron mbas qejfit, e tallet duke u spërdredhun e duke qeshun mbi tribunën e parlamentit, kur ushtarët e ngratë u kanë hapë krahanorët gjyleve t'anmikut... t'ia bajshin ma mirë e ta dëbojshin me bështima, e jo të mjaftoheshin deputetët duke i vu juha me oooo...

A thue se kabineti Vrion perëndoi përgjithmonë?.. Nji hata e madhe dhe nji dam i randë e ka gjetun shtetin me ramien e kabinetit Vrion, se asht prishun nji rregull e nji zakon që asht nderuem prej tetë vjetësh e këndeje!.. Sa keq, se mbas sodit kabinetin e Shqipnis s'ka për ta kryesuem ma beu ase pashai, por ndonji «harbut». Ah, sa dam për Shqipni!

S'kam arësyte të flas mbi kabinetin Vrion, se i vdekuni nuk kujtohet veç për të mirë (!), por, si gjithëkush, s'kam guxim të them gja për kabinetin e ri, se asht i shenjtë e i pëlqyem prej 40 të shejtëvet që përbajnë grupin e «Bashkimit të shenjtë!» Por sido që të jetë, unë, duke lypë ndjesë prej perëndis dhe hirësi prej shenjtnisë së tyne, po i kujtoj me nga nji kartëpostale, si vijojnë këtu poshtë:

Z. Kryeministrat! — Mos u mundo me shpallë programa të bucura si të Vrionit as mos u zoto kot pér shumë gja që s'mund të bajsh, se populli asht mërzit prej sish...

Z. Ministrit të punëvet të brendshme! — Mos shko mbas këshillash e mos len punën në dorë të

tjetrit, e të thuash mbasandaj si z. Sulo¹⁾ që s'kam haber. Mos i çil plagë shtetit si Mehdi Beu,²⁾ por mundohu të mbyllish ato që janë hapun.

A je i zoti të fshish gjyslykët e të shikosh aty pranë? A mund të gjesh nja 'pesë prefekta të zotët, të shkathët e t'i vesh re pesë drejtorave të përgjithshëm që kërcasin gishtat shumë herë? Mos u merr me botime qarkoresh, por gjëj nji fshesë e ... Dëftei botës se burgu asht për kusarë e jo përgazetarë...

z. Ministrit të drejtësisë! — Mos thirr Avni Dabullën, si kanë ba shokët, por shko mbas mentalitetit që ke. A do të mundish ta zbatosh vendimin e Këshillit Ministruer që asht mbi shpërnguljen e kryetarëvet të zyrave që janë vendës, se ban nji punë për faqe të bardhë.

z. Ministrit të luftës! — Mendohu shumë, se po vjen dimni, por mos le të blihen edhe rraqe kartash sikurse asht ba deri sot. A mund të gjesh nji ilaq për degradim, e për fabrikën e aspirantëvet?

z. Ministrit të arësimit! — Leni mënjanë disa kohë mendimet poetike, dhe u kujdes për arësimin botuer, se asht hallakatun gjithë andej. Mos luej tavëll gjithnjë si zoti P. dhe mos i ngul sytë kulltukut si ai. Bashkëpuno me të zotin e punës dhe çil Shkollën normale të Elbasanit, se ke ndriçue arësimin.

z. Ministrit të financavet! — Merre e mçife

1) Sulejman Delvina — ministër i brendshëm në kabine-tin e dytë të Vrionit.

2) Mehdi Frashëri — ministër i brendshëm në kabinetin e parë të Vrionit.

çelësin e arkës që s'ka mbetun gja, dhe mos mba të holla aty, se nuk t'i lenë. Gjij ndonji krahën ndokund e zen e krifi aktet e mbledhuna në ministri, që janë përzi ma keq se flokët e arapit.

Kurrë mos ndigo që të shkojnë njerëz... në Evropë pér të ble tesha pér shtetin.

Z. Ministrit të punëve botore! — Mos u gabotë dalish në Evropë, se thonë bota si pér Mehdi Ben¹) që shkoi t'i bjerë mbrapa vagonit të sheqerit që pat blemë, edhe mos u zoto si ai që do t'i mbarosh rrugët e Shqipnisë pér dy vjet».?)

Në një shkrim tjetër satirik shumë të goditur, Emin Matraxhiu duke përshkruar në formë ëndërrre, mënyrë që e përdor shpesh si mjet pér të shprehur mendimet e veta, një bashkëbisedim imagjinar me babanë e tij të vdekur, godet rreptë shtypjen dhe shfrytëzimin e vegjëlisë prej bezlerëve çifligarë dhe shpreh vendosmërinë e tij të patundur dhe guximin e pamposhtur në luftë kundër tyre, pa përfillur rreziqet që i kërcënoheshin nga armiqësia me ta. Shkrinin e tij Emini e myll, duke u shprehur pér një parim të rëndësishëm, që ka qenë, është dhe do të mbetet kurdoherë aktual, atë të vénies së interesit të përgjithshëm mbi atë personal, duke sakrifikuar gjithshka, deri edhe jetën në luftë kundër armiqve të popullit dhe të atdheut.

«... mbramë m'u ka shtimë andërr im atë, e bamë kuvend atë e bir — thuhet në këtë shkrim. — Im atë me atë fytyrë të ndriçme duke ba buzën në gaz tha:

1) Mehdi Frashëri — ministër i botores në kabinetin e dytë të Vrionit.

2) «Shkumbini», nr. 34 dt. 21 tetor 1921.

Biri im, je duke ecë apo je duke çelë nji rrugë plot me ferra e driza... Puna asht shumë e vështi-rë e shokët mos të lanë në baltët. Ke hapë luftë me të gjithë, e kjo ka për të dalë për të zezët tate! T'i harrosh të gjitha, por me bejlerët ke çelë shtek kot, se nji proverb thotë: «Beu gomar të bahet, mos i hyp nalt».

Je i ri e nuk ia ke pa tymin, por ndigjomë se ç'më ka ndodhun mue nji herë, kur ishje i vogël. Ma të vegjël se ti, kisha edhe shtatë të tjerë. Për t'ju sajue kafshatën tuej bana mend me ble të dhjetën e nji katundi e për këtë punë shkova në financë edhe e vuna. Mirëpo këtij katundi ia kishte pasë vu synin edhe nji bej, nga ata që ti të duken si miza. Coi e më thirri, dhe unë shkova. Më tha të hiqsha dorë e nuk ju binda. Më tha që t'i paguej diçka, nuk ndigjova. U keqësue beu dhe unë...

Shkuen kohë e kaluam vjete. Unë kisha blemë të dhjetën e nji katundi tjetër. Mirëpo këtu më qëlloi që dy bejlerë të tjerë nuk dojshin me më pague hakun e të dhjetës së orizit, që bujxit e tyne kishin mbjellë. Asokohe qe shpallun Liria e Njisja e Vërtetë (!) si ajo që keni vu ju në gazetët e kështu unë fitova gjyqin që ngrita mbi ta. Megjithëkëtë unë e disha se ujku sado që qimen e ndron por huqin jo, e kësisoji iu ruejta sherrit shumë kohë. Kisha frikë të madhe për bullicën se mos e gjente gja e i thante shpis lugë e kupë. Nga ky hall i epsha loparit shpeshherë bakshishe, që ta kishte kujdes ma tepër. Por sa kot u ruejta, biri im, se ata prapë-serapë e banë zullumin. Të kanë pre katër kamza ullini në vesht, erth e më tha nji ditë bekciu e unë u kujtova menjiherë...

Biri im! Ndigjomë këshillat e ecë pas tyre, se

përndryshe ata kanë për ta ba ndonji send edhe ty! A thue se nuk ke bjerrë? Të shkojshë mirë me ta, do të të falshin dhe ty si të tjerëvet, dikush nji pallto, dikush nji palë potika, dikush nji gjel deti e dikush një top duhan. Ani, se për hatrin e këtyne ti, duke u ba vegël, do të mundoheshe t'i qisje sytë ndonji vëllait tat!.

Pa mbarue mirë fjalën, i dashuri im atë u zhduk, e unë u sqova menjisherë. Por edhe njime, kur më bien ndër mend këshillat e tija them me vete: Edhe sikur të vërtetohen ato, nuk ka për t'u përmbyshë bota. Tomori s'ka me u ba fushë, veçse!... Shigjeta»¹⁾

Më 9 nëntor 1921, Konferenca e Ambasadorëve vendosi të njihte qeverinë shqiptare, kufijtë e 1913-tës në Jug dhe të dërgonte një komision ndërkombëtar për stabilizimin e gjendjes në kufirin e Veriut, në të cilin shovinistët jugosllavë, që nga mbarimi i luftës mbanin të pushtuar një numër fshatrash shqiptare. Para këtij vendimi, qeveria jugosllave u detyrua të tërhiqte trupat e saj në vijën e demarkacionit të caktuar nga konferenca, e cila i bëri përsëri disa cungime territorit shqiptar.

Po me 9 nëntor 1921 fuqitë pjesëmarrëse në Konferencën e Ambasadorëve, Anglia, Franca, Japonia dhe Italia, aprovuan një deklaratë, duke i dhënë të drejtë kësaj të fundit të ndërhynët në Shqipëri, sa herë që do të «konstatohet» rreziku i prekies së tërësisë tokësore ose i interesave të saja ekonomike. Njohja Italisë e kësaj të drejte

1) «Shkumbini» nr. 40 dt. 2 dhjetor 1921.

të veçantë në Shqipëri, ishte një cenim tjetër i pavarësisë dhe i sovranitetit të shtetit shqipëtar.

Megjithëkëtë, si rezultat i vendimeve të 9 nëntorit, i tërheqjes së trupave jugosllave, i njohjes së qeverisë shqiptare nga një varg shtetesh dhe i njoftimit, 11 muaj pas pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, për dërgimin e delegacionit të saj në këtë forum botëror, pozita ndërkontebtare e shtetit të pavarur shqiptar u forcua. Grupi i përbashkët parlamentar «Bashkimi i Shenjtë» dhe qeveria e Pandeli Vangjelit e kryen detyrën e tyre kryesore. Por, me zhdukjen përkohësisht të rrezikut të jashtëm ndaj kufive të atdheut, «Bashkimi i Shenjtë» u shthur dhe në parlament rifilloi lufta midis dy grupeve politike të mëparshme.

Tani në grupin «popullor» po fitonte terren Ahmet Zogu, i cili përpiqej energjikisht për të marrë në dorë qeverinë. Caktimi i Zogut si komandant i përgjithshëm i operacionit në Mirditë i shqetësoi kundërshtarët e tij në këshillin kombëtar dhe në këshillin e lartë. Pikërisht këtu zunë fill ngjarjet puçiste të dhjetorit 1921.

Dy ministra të qeverisë së Pandeli Vangjelit, që mbante anën e Zogut, dhanë dorëheqjen në shenjë proteste. Konflikti i kësaj qeverie me Këshillin e Lartë u acarua, në lidhje me kandidatët që propozoi ajo për zëvendësimin e tyre. Për t'ia arritur qëllimit të saj, kjo qeveri shpërndau parlamentin dhe tentoi të caktonte, pa aprovimin e këshillit të lartë, në postet e dy ministrave dorëheqës, dy anëtarë të grupit «popullor» pasues të Zogut. Si pasojë dhanë dorëheqien edhe dy ministra të tjerë. Duke marrë parasysh se qeverisë

i mungonin katër ministra, më 6 dhjetor 1921, këshilli i lartë e konsideroi të rrëzuar dhe ngarkoi Qazim Koculin për formimin e qeverisë së re. Në pamundësi për formimin e qeverisë, ky, pas dy ditësh, hoqi dorë dhe kjo detyrë kësaj radhe, iu ngarkua Hasan Prishtinës, i cili me aprovimin e këshillit të lartë në përbërjen e qeverisë caktoi si ministër të brendshëm Luigj Gurakuqin dhe të jashtëm Fan Nolin.

Por forcat reaksionare, të mbështetura nga kryefeuDALI Shefqet Vërlaci me shokë, kundërvepruan me tërbim, duke e quajtur ilegalë këtë qeveri. Më 14 dhjetor Ahmet Zogu, në krye të forcave të armatosura që komandonte në Veri, hyri në Tiranë, mori në dorë komandën e xhendarmërisë, rrithoi qytetin dhe thirri në mbledhje këshillin kombëtar, i cili rrëzoi e zevendësoi këshillin e lartë, të zgjedhur nga Kongresi i Lushnjës dhe u hoqi mandatin deputetëve patriotë, iredentistëve kosovarë, ku bënte pjesë edhe Hasan Prishtina. Duke mos e parë akoma momentin oportun për vendosjen e diktaturës së tij të hapur, Ahmet Zogu preferoi që, përkohësisht, të drejtonte nga prapaskena. Kështu, me propozimin e tij, u ngarkua për formimin e qeverisë reaksionari Xhafer Ypi, ndërsa vetë Zogu mbajti postin e ministrit të brendshëm, që ishte posti kyç për veprimtarinë e tij të mëvonshme puçiste. Për t'i hedhur popullit hi syve, në përbërjen e qeverisë futën edhe dy elementë demokratë, njërit prej të cilëve, Fan Nolit, i dhanë portofolin e ministrit të jashtëm.

Opozita parlamentare ndaj kësaj qeverie përbëhej nga deputetët demokratë që u larguan prej

grupit «Popullor», nga iredentistët kosovarë si ehe nga disa deputetë katolikë të ish-grupit «Përparimtar», që tashmë qe shkrirë, ndër të cilët ishte edhe Luigi Gurakuqi.

Për demaskimin e veprimitarisë komplotiste të elementit reaksionar, që kishte si qëllim vendosjen në Shqipëri të një diktature të hapur obskurantiste feudoborgjeze, për bashkimin e të gjitha forcave përparimtare të vendit dhe ngritjen e tyre në një revolucion demokratiko-borgjez, një rol të rëndësishëm ka luajtur shtypi demokratik revolucionar i viteve 1921-1924. Dhe nga gazetarët demokratë revolucionarë që reagoi me guxim edhe në këtë situatë, ishte dhe Emin Matraxhiu.

Me shkrimet e tij satirike dhe kryeartikujt panfletë, ai përpiquej të vinte në lëvizje forcat përparimtare të parlamentit për të ndaluar të keqen që po i vinte atdheut nga reaksiuni feudoborgjez.

«Kam prej kohësh që s'e shof plangun në telesi — shkruante ai, — e për këtë shkak nuk shkon natë pa ba fjalë me gjindt e shtëpisë. Nuk jam aq nervoz që t'u bërtas, por u jap gjithnjë këshilla, me shpresë se ndofta ndërrojnë udhën e u jatin fund dameve të panjehuna. Kur më ndigjoi mbramë nji im nip i vogël, se po shqirresh zanit si përhera, u hudh e më tha: Sa kot lodhe dajë se nuk ban dobi asnji këshillë, por ma mirë... Nuk e mbaroi fjalën im nip, dhe nisi të këndoje me vehtet përsëri librin «Përralla» që mbante ndër duer. Për të zbutë sadopak nervat e shkreta, që m'ishin egërsuem prej vetiut, i thashë të këndoje atë pjesë të librit të naltpërmendun...»

Duke vazhduar më poshtë, Emini përmend përrallën në vargje «Një mbledhje që bajnë

mijtë», ku flitet së si ata, për të shpëtuar nga maçoku, vendosën t'i varin një zile në qafë përtatë dëgjuar kur vinte për së largu, por kur erdhi puna se kush do t'ia varte këtë zile maçokut, nuk guxoi asnjë dhe u futën përsëri nëpër vrima. Moralin e kësaj përralle ai ia përshtat gjendjes politike të Shqipërisë në atë kohë, duke e përfunduar shkrimin me këto vargje:

«*Shokë, si u suall miu
Sillet e flet edhe njeriu;
Shumë mbledhje kemi parë,
Q'u nisn e s'u sosën mbarë,
Kur asht vetëm për fjalë,
Plot njerz me mend kanë dalë,
Por kur vjen radha për punë,
S'gjen asnji njeri këtunë»¹⁾*

Kur Ahmet Zogu kishte hyrë në Tirane përtë zbatuar planet e tij djallëzore, Emin Matraixhiu botoi në «Tragëzat e mullinit» 12 gjëza, përmes të cilave demaskonte para popullit shkeljen e statutit të Lushnjës, anarkinë e krijuar në vend, përpjekjet e Zogut, të mbështetura nga Vërlaci, për vendosjen e diktaturës së tij dhe arbitraritetin e censurës që ndalonte në postë telegramet e protestës që i vinin «Shkumbinit» prej elementeve demokratë të indinjuar nga veprimet e rrezikshme të reaksionit. Ja disa prej këtvere gjëzave, për zgjidhjen e të cilave Shigjeta u premtonte lexuësve si dhuratë një koleksion të gazetës «Shkumbini»:

1) «Shkumbini», nr. 41, dt. 9 dhjetor 1921.

«Ç'asht nji gjazë e nji gjazë, ç'asht ai 7 ut (statut sh.a.) që shkelet e përshkelet prej kujdo?

Ç'asht nji gjazë e nji gjazë, ç'asht ai vend që nuk e njef qeni të zotin? (e ka fjalën për anar-kinë e krijuar atë muaj në Shqipëri — sh.a.).

Ç'asht nji gjazë e nji gjazë. ç'asht ai kazan qi do zien në Tiranë? (nënkupton veprimtarinë puçiste të Ahmet Zogut sh.a.)

Ç'asht nii gjazë e nji gjazë. ç'asht ai Don Qishot që polli parlamenti? (për Ahmet Zogun sh.a.).

Ç'asht nji gjazë e nji gjazë, ç'asht ai i marrë. që nalt në kalë shitet nënër bazar. duke dhënë nvtke (politik?) nëpër ushtarë? (për Mehdi Frashërin sh.a.).

Ç'asht nji gjazë e nji gjazë, ç'asht ai mi që hangri telegramet e «Shkumbinit» në zyrë të postës?»¹⁾

Po në këtë numër të gazetës, Emini botoi edhe një krveartikull panfletë. nën titullin «Populli pret». ku. i ndikuar nga jehona e ideve të revolucionit socialist të Tetorit, u thotë hapur deputetëve të parlamentit se në rast se ata nuk do t'u thonë ndal atyre aë marrin nëpër këmbë interesat e atdheut, «fjalën e fundit do ta thotë vetë populli».

«Lojnat e damshme dhe të rrezikshme që u lueitën ndër ditët e fundit në kryeqytet, s'ka dyshim se kanë pikëlluem zemrën e çdo atdhetari — shkruante Emini. — Në qoftë se nuk dahet shapi e sheqeri, në qoftë se puna vete si ka

1) «Shkumbini», nr. 42, dt. 16 dhjetor 1921.

shkue e deputetët mbyllin sytë për hatër të selisë, atëhere thomi çiltas se fjalën e fundit do ta thotë vetë populli e davaja ka m'u da si ma mirë. S'ka për të durue aspak populli i ngratë që të ngjasin ma kësi lojnash mbi kurriz të tija, s'ka për t'i durue asnji çast ata intrigantë e ata ambiciozë qi i venë shkelmin interesavet t'atdheut për interes vetiak, e për dallavera partish e personash, si nuk ka pasë durue as klikën e xhonturqvet as tradhëtitë e Esadit.

Mjerisht provat e idhëta që na ka dhanë deri më sot këshilli kombëtar nuk na jep farë shpresa, por megjithëkëtë neve na ka anda të besojmë se ai mbaskëndej do të drejtojë udhën e do të lerë mbënjanë ambicit...

Gjendja e përbrendshme asht për t'u vajtue nga çdo pikpamje. Kemi nevojë për një qeveri të zonjën e punës, të drejtë e të fortë, që t'i përgjigjet nevojave të sotshme me shpeiti. Le të shpresojmë se burrat e parlamentit do të dinë t'ia gjejnë barin këtyre plagëve të atdheut, që vetë ata ia kanë hapë. Populli pret me padurim formimin e një kabineti që me të vërtetë të ketë dalë nga gjini i tij e t'i përvishet sa ma shvejt nërmirësimit të kësaj gjendje të përvashme. Përndryshe!...»

Pas shkrirjes së grupit «Përparimtar», me heqjen e mandatit deputetëve iridentistë kosovarë, dhe krijimit të qeverisë reaksionare të Xhafer Ypit, prapa të cilil fshihei Zogu, Emin Matraxhiu botoi një shkrim satirik, në formën e një letre me disa pyetje, nëpërmjet të cilave kritikohej përbërja heterogjene e grupit «Popullor», mbizotërimi i bejlerëve në qeverinë e Ypit dhe

bojkotimi i qeverisë së Hasan Prishtinës nga disa nëpunësa reaksionarë.

«Si qesh ba mirë — shkruan Emini, — dola dje në zyrë të redaksisë e aty gjeta mbi tryezë të dreitorit nji plikë të drejtueme për mue. Letra shkruante këto:

«Me ndërmjetësi të Shigjetës, zotnisë depu-
tetit tonë Shqipnisë!

H. Y. B.

Tiranë

Mund të pyesja edhe deputetët e qytetit tem, por e di se ata sadoqë e mbaruen nji hall të madh, prapë nuk kanë nge sa që të mbarojnë edhe do shërbime të tjera...

Ja pyetjet e mia:

... Sa rrok numri i bejlerëve të Partisë «Popullore», e cila asht ajka e tyne?

Sa kap numri i ishavet (ministër) dhe i ushavet?

Mirë se qeveria e P. V. (Pandeli Vangjelit sh. a.) u quejt Demokrate, se kishte katër harbutë, por si i asht vu emni qeverisë së Ypit, që numron katër bejlerë?

Sa nëpunsa (përqind) pati nga ata që nuk deshën me i shërbye kabinetit «illegal» të Prishtinës (Hasan Prishtinës sh.a.) e që i patën shërbye qeverisë «legale» (sic) të Esadit?

Thumbi

Për dije e të gjejun i paraqitet deputetit të naltpërmendun. Shigjeta». ¹⁾

1) «Shkumbini» nr. 44 dt. 30 dhjetor 1921

«TRAGEZAT E MULLINIT» TË «SHIGJETËS»

Krijimtaria letrare publicistike e Emin Matra-vhijut është e gjithanshme dhe përfshin shumë gjini, deri te poezia. Nië ndër poezitë e tii është p.sh. viersha elegiike për patriotin elbasanas Kamber Seidini, vrarë më 1914 në Shijak, gjatë nië nërnjekjeje me turkoshakët. Ja disa vargie të kësaj viershe prekëse, por njëkohësisht optimiste dhe frymëzoniçëse:

*«Ku t'qilloj aj plumb i shkretë,
Ty, Kamer, o trim ushtar?
Re si burr, pr'atdhe...
Vdiqe e shkove si shqiptar.
S't'u dhimb vetja, o Kamer.
Nuk kujtove gru e vlla?
E tan bota t'ka për nder.
Elbasani asht tuj qa.
Vërtet shkove, o Kamer,
N'zemrat tonë por je gjallë,
Shpejt do të ngrifet një mermer
Për ta pa të gjithë me mall».1)*

1) «Shkumbini» nr. 39 datë 28 nëndor 1921

TRAGÈZAT e MULIMIT

Menatitjet

Në qatë që ndër këto ditë 24.07.07 thjeshtë këtë, këtë menatitjet e Friderikut i cerninjti e Lindjes (oriental). Për më dalluarja se kush është ma i mirë, nuk po shtroj këtu poshtë dy ndodhura:

1. Shih nga mesi i shekullit XVIII kur Prindëritët të Hënë ne mbretërente madhepiqart të front te Oqeranis, kati si nje vites 14 një këshijell (chateau) aty Iserlini. Mirë po afer këshijelli u-ndodhë aso koha aji noll i nji komunitati, tra h. i të cilët tyke u-persat mbredha zhukuroata për se teprë këshijelljan. Dhaje e muren me të mirë ujerzit e Friderikut i Malit, që është a blejxhiq nullish trailin e militair, por ait nuk e shust. A n-kelbyea edhe me t'leq, por ait mak u-bimile kurrëse. Ma n-ë fum i kaltxa Friderikut që nullisi nuk udëgjimit t'ë qarri minnit e ky qoi e thirri vete.

2. Sa kot u-mundur me t'mir? Është ne pëckdhelinje, se ait nuk i a vñ veshin fare tjalvetet t'ë tija. Së bandi Frideriku i tha nullisit, çuk e di ti se une t'a marri aec perdhunet e ti auk be se ç'ban? Atë z. di fort mirë ma i apërzigjith nullisi, por a e t'edhe zotria e jote se në Berlin ka gjykalore e gjykatës? Satoqë i erth keq Friderikut që nuk i umbush, deshira, por i erth mirë kur udëgjot se populli i vet kishte besin t'ë plotë ne gjykatet e gjykatës.

Prap po ne këtë sh-koll kë heutin edhe udodhia tjercë M' atberë kurë Shqipnia (sh'te province) e Turqis, me e vides kadiu i Peqinit, Mudici (krashinari). Peqinit i shkriven Abdipli Pashës mytesarit (sumlumtarit) i Elbasanit për Gjegj nji kadi skujet nga turpi! . . .

Qysh ase kuhë populli Shqiptar nuk ka pasë farë besoni ne gjykatës. Por edhe s'a qysh t'ë kete besin populli kui ndërgjon se gjykatës i Beratit kane festme nji gjyksuer? Qysh t'ë këtë besin populli kurë ndërgjon se gjykatë i Tiranës tyke pasë edhe më të pandehin (?) për një kran dëmon disa prej sish e nuk pret përuandimin e gjyqit përgjithësish. Thonëm jn ihetë kë asht pa apo udëgjue kjo çudh?

Qysh t'ë këtë Lesim pripilli i ngratë këtë ndërgjon se gjykatës pashës i Elbasanit (me diplome) për nji padh që i pati tani e poħol, ai ngrihet e i kerkon pagħiġi dokumenta e shalni.

A ihu nuk temi ne shkallin e teāmbiedhett?

Ka-edhe mă keq!

Sligjetta

Rubrika Satirike e Emin Matraxhiut

Por gjinia më e preferuar dhe ku ai dha më shumë është ajo e satirës. Duke hapur që në numrin e parë të «Shkumbinit» një rubrikë të veçantë satirike me titull «Tragëzat e mullinit», gjatë jetës së shkurtër njëvjeçare të kësaj gazete të përvjetorë, Emini botoi, nën pseudonimin «Shigjeta» 45 shkrime të ndryshme, me vlerë të vërtetë ideo-artistike. Prandaj nuk është e rastit që ai njihet më tepër, si letrar e gazetar i talentuar, përmes kësaj rubrike.

Përse vallë Emin Matraxhiu zgjodhi pikërisht si më të përshtatshme për krijimtarinë e tii publicistike në gazeten «Shkumbini» një gjini të tillë shkrimi, sa interesante për lexonjësin aq edhe të vështirë për autorin? Ai e zgjodhi këtë gjini jo vetëm sepse kishte talent e pasion për satirën dhe humorin, jo vetëm sepse e çmonte si një gjini të këndrë hme dhe tërheqëse për masat po edhe sepse nisej nga premisa me karakter politik. Nëpërmjet rubrikës «Tragëzat e mullinit» Emini synonte ta bënte «Shkumbinin», ashtu siç e bëri në fakt, një mjet të fuqishëm në luftë kundër armiqve të popullit e të atdheut, jo vetëm në Elbasan, por edhe në gjithë vendin. Ai zgjodhi gjininë e satirës, sepse, për vetë karakterin e saj, kjo gjini e lejonte të godiste me ashpërsi të madhe politikën antipopullore të klikave sundonjëse feudo-borgjeze, pa u dhënë mundësi atyre ta vinin para përgjegjësisë ligjore dhe të merrnin masa me aq lehtësi, sa mund të merrnin për shkrimet kritike të gjinive të tjera. Sa të drejtë pati në këtë drejtim u vërtetua më vonë, kur ai u arrestua.

Shkrimet satirike të pendës së talentuar e të guximshme të Emin Matraxhiut, u sillnin shumë 'elashe armiqve. Por vetëm kur u botua nga Emini kryeartikulli «Fjalë të reja e mentalitete të vjetra»,

qeveria reaksionare e Iljaz Vrionit gjeti rastin të vinte dorë mbi të. Ky qe preteksti. Në të vërtetë arrestimi i tij lidhej me shtyllën satirike të «Shkumbinit», e cila, me shigjetat e saj të mprehta, jà çirrte vazhdimisht maskën para popullit, kësaj qeverie, dhe nxirrte në shesh të gjitha anët e errëta të shoqërisë feudoborgjeze në kalbëzim. Kjo vërtetohet edhe nga proces verbalet e hetuesisë. Ja çfarë e pyet hetuesi Eminin midis të tjera shqip:

— Në artikujt «Tragëzat e mullinit» kritikat kundër bejlerëve pse i keni bamë?

— Pjesa e «Tragëzave të mullinit» — përgjigjet Emini — asht një pjesë satirike. Pjesët apo fletoret satirike as më ndonji vend nuk kanë përgjegjësi. Në qoftë se thoni se bahet kritikë mbi ndonji person, ai mbas ligjit lypset t'i drejtohet gjykatore së vendit, nëse e merr për shnderim!)

Shtylla «Tragëzat e mullinit» luajti një rol të rëndësishëm në kuadrin e programit politik të gazetës «Shkumbini» dhe meriton një vëmendje të veçantë për të çmuar vlerat ideo-artistike të krimtarisë publicistike të Emin Matraxhiut.

Kjo gazetë, me rubrikën e saj satirike «Tragëzat e mullinit», doli në qarkullim në një kohë kur lufta për zbatim e trupave të huaja, që kishin invaduar Shqipërinë, kishte marrë fund, në përgjithësi, me betejën heroike të Vlorës. Tani, krahas barutit, që duhej mbajtur gjithmonë i thatë, përdështimin e veprimtarisë grabitqare e diversioniste të klikave shoviniste të vendeve fqinjë dhe të agjentëve të tyre si Marka Gjoni me shokë, një rëndësi të veçantë, për bashkimin e popullit në

1) Arkivi i Shtetit — dosja e gjyqit politik 1920-1924.

luftë për konsolidimin e shtetit të pavarur shqiptar dhe për zhvillimin e tij në rrugë demokratike, merrte penda. Dhe penda e talentuar dhe e guximshme e Eminit e bëri si duhet punën e saj.

E gjithë krijimtaria publicistike e Emin Matraxhiut, për vetë zhvillimin e vrullshëm të ngjarjeve në periudhën kur militoi ai, dallohet sidomos në fushën e kritikës, karakterizohet nga stili i mprehtë polemist i pamfletit. Por një forcë të madhe mori penda e tij, si nga përbajtja ashtu edhe nga forma artistike në «Tragëzat e mullinit». Dhe kjo nuk u arrit lehtë nga Emini. U desh një punë shumëvjeçare, një bashkëpunim i gjatë në faqet e shtypit shqiptar me artikuj e reportazhe, me korrespondencia informative e përshtypje udhëtimi, për të formuar atë gjuhë të pasur, të thjeshtë e të kuptueshme nga masat, atë stil luftarak, plot humor të lehtë e tërheqës për popullin, por therës e dërmjonjës për armiqtë, atë logjikë të mprehtë për mohimin e së vjetrës dhe pohimin e së resë, që është kërkesa themelore e satirës, e cila në pendën e tij arrinte deri në sarkazëm.

Që në fillim, autori i «Tragëzave të mullinit» nëpërmjet kësaj rubrike kishte dy qëllime: e para t'i jepte vegjëlisë një armë të shëndoshë në dorë për të demaskuar me forcë armiqtë e saj të brendshëm e të jashtëm; e dyta, të krijonte në shtypin përparimtar të Elbasanit traditën e satirës që, në qoftë se një ditë ndalohej botimi i «Tragëzave të mullinit», të ngriheshin luftëtarë të rinj të pendës, të delnin gazeta të reja përparimtare, rubrika të tjera satirike, të cilat të vazhdonin më tej, në gjurmë e «Shkumbinit, luftën për çështjen e popullit e të atdheut.

Mbi qëllimin e kësaj rubrike dhe rezultatet që arriti ajo, Emin Matraxhiu botoi një shkrim të bukur satirik, ku përdor, si kurdoherë, një gjuhë plot figura dhe alegori, të bazuar në gurrën e pasur të folklorit populor. Në këtë shkrim autorime mjeshtëri godet shfrytëzimin e egër të vegjëlisë nga zengjinët e bejlerët, paaftësinë e qeverisë feudoborgjeze dhe mospërfilljen e saj ndaj kritikave të shtypit përparimtar.

«Prej zhurmës që bajnë paprajtun tragëzat e mullinit, të shurdhojnë veshët — thekson ai. Por, nuk do mohuar se dhe ato bajnë dy shërbime të dobishme: shërbimi i parë asht se duke tundun ko-shin e drithit e lëshojnë drithin përposh, ndërmjet gurëve me nji rregull të plotë, dhe i dyti, asht se, si mbarohet drithi së bluemi, duke pushuem vetë tragëzat, sqojnë mullisët e ngratë, që janë kaptitun prej punës e i ka rrëmbye gjumi i natës!.. A thue se «tragëzat» e mullinit që kam marrë unë me qesim koke kanë muftun me ba ndonji kësi shërbimi?»

Për të parin shërbim kujtoj se «tragëzat» e mia janë munduem sa ka qenë e mundun, e kanë hudhun kokrra drithi mbi gurët e akikut të mullinit qeveritar, por pa dobi, se kanë shpëtue edhe pa u bluem prej këtyne gurëve të lëmuet. E sa për të dytin shërbim, them se kur të pushojnë ndonji ditë edhe «tragëzat» e mia, atëhere dru se kanë m'u sque edhe qeveritarët tanë e do të kujdesohen makari sa mullisët, që i mbajnë veshët pipëzë edhe kur janë në gjumë!..

Shpesh më kanë ndi veshët edhe shumë fjalë që flasin myshterinjt rreth këtyne tragëzave e rrotull këtij mullini: nji palë thonë se bluen imët e

nxjerr miell tē butē, nji palē tē tjerē thonē se nuk zihet brumi mirē me kaq miell tē ashpér; edhe disa thonē se mullini i em nganjiherē bluen pér hesapt s'di se kujt? !..

Kjo nuk asht e värtetē, sepse mullinjtē e Elbasanit thuajse përgjithësish janë tē zotnijvet, tē cilët, tashti nē verë, pér tē shitun ujet, ua mejnë (presin) mullijvet tē tyne dhe e shesin me minuta! Sa herë ka mbetë nga ky shkak pa bluem fare populli i ngratë?

Sa arave e qipshteve u janë pasë thamun bimët, se zotnijtē apo qehajallarët janë pasë idhë-nue me tē zotënët e arave e s'u kanë da ujë?! A thue se prej Zotit e kanë trashëgim këtë ujë këta zotnij, apo prej lumenjsh e kanë marrun?

Po kësi trashëgimi kanë ndofta edhe bejlerët e Tiranës, që shesin ujet e lumit e tē türkosit!

Lavdi i goftë ati tē lumit Zot, se mullini i em s'punon me ujë, por me erë, e kështu bluen gjithë-monë pér hesap tē vet, derisa era tē jetë e lirë! Por çar ka fitue ky mulli? mund tē pyesin tē dashunit këndues. Unë u siguroj se s'ka muft makari tē mbëledhi nji tē tretën e ujemit. Mullini s'ka farë faji se barrët q'i ka fut me rranxë i ka nxjerrë me kapul; por hall se ata që e kanë pasë vetë drithin tē keq nxehen kot e bahan anmiq kot nga së koti!...»¹⁾

Shumë rubrika satirike pati shtypi përparimtar shqiptar që nga koha e rilindjes, rubrika që erdhën duke u shtuar pas shpalljes së pamvarësisë, por vetëm disa prej tyre patën forcën goditëse, pér

1) «Shkumbini», nr. 28, dt. 22 korrik 1921

armiqtë, dhe efektin edukativ, për masat e lexonjësve, që pati rubrika «Tragëzat e mullinit».

Nëpërmjet kësaj rubrike tërheqëse satirike, të botuar rregullisht në çdo numër të «Shkumbinit», Emin Matraxhiu diti t'u përgjigjej flakë për flakë problemeve të ditës. Kritikat e tij të guximshme e bënин të qeshte lexuesin e thjeshtë, të tallej me armiqtë e tij, por edhe të mobilizohej në luftë kundër tyre. Ato, në të njëjtën kohë, duke qenë të shkruara qartë, të realizuara me mjeshtëri artistike, me një stil konçiz, demaskues e stigmatizues luftarak, i dërmonin keqas ata që viheshin në majën e shigjetës së Eminit.

V.I. Lenini, në artikullin «Nga e kaluara e shtypit punëtor në Rusi» shkruan:

«Historia e shtypit punëtor në Rusi, është e lidhur ngushtë me historinë e lëvizjes demokratike che socialiste. Prandaj neve duke i ditur mirë etapat kryesore të lëvizjes clirimtare mund të arrimë të kuptojmë pse preqatitja dhe lindja e shtypit punëtor kanë ndjekur këtë rrugë dhe jo ndonjë rrugë tjetër»¹⁾

Këto parime themelore metodologjike të Leninit mbi studimin e historisë së lindjes dhe zhvillimit të shtypit punëtor në Rusi, janë të vlefshme edhe për studimin e historisë së shtypit përparimtar të të gjithë vendeve, pra edhe të vendit tonë.

I bazuar në këto parime marksiste-leniniste, duke i zbatuar ato në mënyrë krijuese, në kushtet konkrete të vendit tonë, shoku Enver Hoxha na mëson:

1) «Lenini për kulturën dhe artin» faqe 202

«Rilindasit tanë duhet të vihen drejt në epokën kur kanë jetuar, punuar e luftuar, duhet të vihen në dukje idetë e tyre, të cilat ishin prodhimi i zhvillimit të shoqërisë së asaj epoke, duhet të vihen në dukje qëllimet e tyre ku synonin imediatistht dhe në perspektivë. Po të shtrohen gjërat kështu drejt, do të dalë se rilindasit ishin njerëz të shquar me ide përparimtare, ishin iluministë revolucionarë, të guximshëm dhe me një atdheda-shuri të madhe e të zjarrtë. Ata luftuan me pushkë e me pendë përlirinë dhe pavarësinë e popullit, përzgjimin e tij»¹⁾

Partia ka porositur kurdoherë që të ruajmë dhe të zhvillojmë më tej traditat patriotike e përparimtare të popullit tonë në të gjitha fushat, duke përfshirë edhe atë të kulturës.

«Ne çmojmë, ruajmë dhe zhvillojmë nga arti dhe letërsia e së kaluarës — ka thënë shoku Enver Hoxha — gjithshka që është e mirë, është e afërt me idealet dhe aspiratat e punonjësve dhe u shërbën atyre... Është e drejtë kërkesa dhe përpjekja që trajtimi i temave historike të përshkohet nga fryma e kohës, që ngjarjet historike të vlerësohen nga pozitat marksiste leniniste»²⁾

Po ta shikojmë problemin e studimit të historisë së shtypit tonë në këtë prizëm, që të vlerësojmë drejt krijimtarinë e figurave të shquara të publicistikës sonë të së kaluarës, duhet të përdorim çelësin e metodologjisë dialektike materialiste, duhet të zhytemi në dallgët e ngjarjeve të epokës

1) E. Hoxha — Raporte e fjallime 1967-1968; f. 369

2) E. Hoxha — Raporte e fjallime 1967-1968; f. 480-481.

kur kanë jetuar është vepruar ata, të ndjejmë thellë shqetësimet, vështirësitë dhe rreziqet në të cilat kanë punuar e luftuar këto figura përparimtare për interesat e popullit e të atdheut.

Po ta studjojmë nga këto pozita marksiste-le-niniste krijimtarinë publicistike të Emin Matraxhiut, ne nuk do të nisemi nga dëshira abstrakte dhe të kërkojmë tek ajo ato që ai nuk mund të na jepte, por do të zbulojmë dhe do të vlerësojmë atë që ai dha të re në raport me publicistët e tjerë përparimtarë paraardhës.

Koha në të cilën filloj të botohej gazeta «Shkumbini» e, tok inë të, «Tragëzat e mullinit», nxirrte në plan të parë problemet shoqërore, kontradiktat e thella klasore në gjirin e shoqërisë së kalbur feudoborgjeze, luftën e forcave përparimtare kundër atyre reaksionare për zhvillimin demokratik të vendit, për mbrojtjen dhe konsolidimin e shtetit të ri të pavarur shqiptar. Në këtë kohë ishin të freskëta idetë iluministe revolucionare të rilindasve tanë të shquar, të cilat nuk kuqizoheshin vetëm në zgjimin dhe ngritjen e popullit në luftë për liri e pavarësi, por shtriheshin edhe në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj lufte kundër obskurantizmit feudal, për demokraci, dritë dhe arësim. Ishin pikërisht këto probleme dhe këto ideale të shtrenjta në zhvillim, që preokuponin dhe frymëzonin edhe Emin Matraxhiun në krijimtarinë e tij publicistike.

Po të marrim e ta studjojmë këtë krijimtari që në fillimet e saj, do të konstatojmë se ajo ka qenë e përshkuar kurdoherë nga fryma përparimtare e kohës dhe, në të njëjtën kohë, do të vërejmë aftësinë e autorit për t'i zhvilluar më tej idetë patriotike përparimtare e më vonë ato demokratikë

revolucionare, duke kaluar gradualisht nga interpret i lëvizjes patriotike për liri e pavarësi në një luftëtar të vendosur për zhvillimin e vendit në rrugë demokratike.

Dhe Emin Matraxhiu ndoqi këtë drejtim në aktivitetin e tij, jo vetëm duke marrë si model demokracinë borgjeze të shteteve të zhvilluara evropiane po edhe duke qenë i ndikuar nga idetë e Revolucionit socialist të Totorit, sidomos pas denoncimit publik nga V.I. Lenini të traktatit të fshehtë të Londrës, të prillit 1915, për copëtimin e Shqipërisë. Nuk është e rastit që ai duke përdorur një gjuhë alegorike, lidhur me tmerrin e kapitalizmit evropian nga krijimi i shtetit të parë socialist në botë, shkruan se «kolerë për Evropën asht Lenini»¹⁾. Ndërsa duke parashikuar dallgët e revolucionit, që po afroheshin edhe në vendin tonë, pyet lexonjësit e tragëzave: «Ç'asht nji gjazë e nji gjazë, ç'asht ai yll që do të ndriçojë Shqipnин për së afërmë?»²⁾

Këto shkrime dëshmojnë se me gjithë kufizimet ideore që hasim në krijimtarinë e Emin Matraxhiut, të cilat janë edhe kufizime të vetë lëvizjes demokratike revolucionare të kohës, idealet e tij shkonin përtej caqeve të kësaj lëvizjeje, në drejtim të një ndryshimi të thellë revolucionar të shoqërisë, duke patur besim të plotë se në këtë rrugë, siç shkruante ai «fjalën e fundit do ta thotë vetë populli».

Por, duke studjuar krijimtarinë publicistike të

1) «Shkumbini» nr. 21, dt. 3 qershor 1921.

2) Idem nr. 42, dt. 16 dhjetor 1921.

Eminit, sidomos atë satirike, nuk duhet të harrojmë pér asnjë çast se ai shkruante nën kërcënimin e vazhdueshëm të censurës së rreptë policore se atij i duheshin përpjekje të mëdha, shkrirja e gjithë talentit, mjeshtërisë dhe aftësisë së tij krijonjëse në përdorimin e sa më shumë formave e figurave letrare, njer t'i bërë shkrimet e tij të botueshme.

Qeveria reaksionare e Iljaz Vrionit, u bënte shpeshherë paralajmërimë të hapura kërcënuese drejtuesve të shtypit përparimtar, pér t'i detyruar të hiqnin dorë nga kritikat shqetësuese pér të. Janjë lajm redaktorial i gazetës në këtë drejtim:

«Javën që shkoi, e ndershmja polici i bani me dijtë drejtorisë sonë se nuk ka leje të botojë artikuj që prishin qetësinë e shtetit, ndryshe do mirenn masa pér të ndalue botimin e «Shkumbinit»!»¹⁾

Si pasojë e këtij faktori që frenonte të shprehurit e ideve haptas, është e qartë se nga krijimtaria e botuar «me qesim koke», siç shkruante vetë Eminit pér shtyllën e tij satirike, nuk mund të kemi një perceptim të plotë të shkallës së zhvillimit të botëkuptimit të tij.

Por, megjithëkëtë, po të studjojmë me vemannje «Tragëzat e mullinit» ne mund të krijojmë një ide mjaft të qartë mbi vlerën ideo-artistike të krijimtarisë satirike të Emin Matraxhiut. Përmbytja e kësaj krijimtarie karakterizohet nga një urrejtje e papërbajtbur ndaj klasave sundonjëse feudoborgjeze dhe nga dashuria e thellë dhe e pakufishme pér vegjelinë e shtypur e të shfrytëzuar, pér të «durueshmin komb shqiptar», siç e quan ai popullin

1) «Shkumbini» nr. 12, dt. 8 prill 1921.

në njëren nga fabulat e tij. Në këtë fabul, Emini, duke personifikuar me qenin dhe macen dy partitë kundërshtare në gjirin e parlamentit dhe grindjet e tyre të paprincipa, shkruan:

«Zakon m'asht ba, sa herë që jam i ngeshëm, vete e vizitoj ndonji shkollë. Kështu shkova dhe dje e vizitova drejtorin e shkollës..»

Drejtori flet e nxansi Petrit shkruen këto radhë:

Nji herë u zunë shoq me shoq qeni dhe macja e shkuar e u qanë ke zotnia i tyne. Natyrisht gjithsekush ankohesh ma tepër se shoqi e rrëfente arësyena ma shumë, e ankimi filloj kështu:

Macja — Zotni, qeni më ka kafshue veshin!

Qeni — Jo, zotni, se edhe kjo më gërrici hundën.

Macja — Po, lum zotnia, se ky shkoi e i rrëmbeu zonjës nji felë mishi.

Qeni — Edhe kjo, zotnia im, piu tinëz qu-mështin që kishte zanë zonja në tenxhere, por unë e pashë.

Si i ndigjoi nji copë herë, zotnia u kthyte e u tha: ju njof që të dy, por mosni, se në ju zança me ndonji shkop do t'jua baj kurrizin ma të butë se barkun.

Kur mbaroi Petriti këto radhë së shkruemi, mue më fluturoi mendja ke dy partitë e parlamentit tonë dhe ke i durueshmi kombi shqiptar!..»¹⁾

Sa bukur dhe me çfarë mprehtësie e përdor Emini këtë fabul për t'i shërbyer aktualitetit politik! Sa e fortë është batuta e fundit e tij, e cila, në të njëjtën kchë, stigmatizon veprimitarinë për-

1) «Shkumbini», nr. 20 dt. 27 maj 1921.

çarëse të të dy partive dhe i thotë popullit se durimi i tij duhet të ketë kufi, se ai duhet t'u tre-gojë vendin atyre.

Po ta shikojmë nga pikëpamja artistike krijimtarinë e Eminit në «Tragëzat e mullinit», do të na rezultojë se në përgjithësi ajo priret nga satira therëse, humor i këndshëm, ironia e hollë, hiperbola dhe sarkazma e papërmabjtur për armiqtë, dallohet për shkrime të shkurtëra, plot kuptim dhe aktualitet, për një larmi formash dhe mënyrash të shkruari si dialogu, monologu, etj., të përshtatshme për këtë gjini të veçantë e tërheqëse të gazetarisë, në të cilën ai shkru është talentin e tij të rrallë letrar.

- Në qoftë se njeriu i lexon shkrimet e Emin Matraxhiut fluturimthi, në pamje të parë mund t'i duket se ka të bëjë me një përshkrues të rëndomtë objektivisht, që nuk mban qëndrim emocional ndai realitetit. Por mjafton t'u rikthehet këtyre shkrimeve që të shohë se autori shpesh me një fjalë, me një batutë, me një rresht nxjerr në pah moralin e tërë shkrimit, objektin që kishte vënë në shinjestër në këtë ose atë shkrim.

Por për vetë mënyrën alegorike e figurative që ka përdorur Emini për t'i shpëtuar çensurës, mjaft shkrime të tij satirike, që në kohën e vet ishin të kuptueshme, sot nuk mund të kuptohen lehtë pa njohur mirë ngjarjet dhe personalitetet politike të asaj periuudhe. I tillë është p.sh. edhe ky shkrim i botuar në «Tragëzat e mullinit»:

«Kam gjetë vrevën (belanë) me nervat, se ato... po të jetë vranët ma msyjnë turri gjermane trupin tem të drobitun — shkruan Emini — Kështu pësova edhe mbramë, më zunë shtrëngueshëm e

më dhanë tmerën... Më kapi nji mërziti, nji shëmtim e nji dëshprim i madh, aq sa as më rrithesh... as më flihesh...

... Kur, desh zoti, m'erdh miku i em i kur-dohershëm, i cili, duke mbërthyer krahun e vet me temin, më ngriti e shkuem të dy në cinematograf...

Pamja e parë dëftente nji ndërtesë të bukur, në portën e së cilës po hyjshin disa zotnij... ishte mitropolitanja e Korçës, dhe ata vizituesa s'ka dyshim se do të ishin ata të famëshmit...

Pamja e dytë shfaqte nji godinë tjetër, në oborr të së cilës po shëtitshin disa gjind, e, ndërmjet tyne, dajshin prej rrobesh nja katër zotnij... ishte fortesa e Gjinokastrës me burgun e saj. Në oborr ishin ata të pafajshmit (sic) esadistë, duke i dhanë gardianit disa letra për t'i vu në postë e në to u shkrujshin disa miqvet të vet në Tiranë për nji falje të përgjithshme (amnisti).

Pamja e tretë shfaqte një sallon të bukur të nji pallati në Tiranë, ku po rrishin disa zotnij duke biseduar. Ky ishte konaku i nji ish-ministri, dhe ata zotnij ishin disa deputetë që mblidhen atje nat' e ditë për të shpëtue Shaiipninë. Bisedimet bashedhin me nxehësi për kandidaturën e ish-ministrat fatos (!) për kryetar të R... (Regjencës sh. a.) së Shqipnisë!...

Pamja e katërt tregonte përsëri nji pallat në Tiranë përmbi portën e të cilil ishin shkrue këto fjalë: Qeveria Shqiptare. Kur pashë me habi se në këtë portë po hyjshin me nxitim nja dhjetë hamej me nga 8 sandallie për mbi kurriz. Oh, si lum qeveria, thash me vehte teme, se tani ua paska

gjetë barrin e heshtjes sharlatanëvet, gjithsekujt paska shënue me i da nga nji sandallie ministrish! Sa më ndigjoi, miku m'u kundërshtue menjisherë: Jo, ma priti ai, këto janë për të ndershmit deputetë, e sa për ministrat shqiptarë, në janë të zotët, le të ruejnë mundbare ato që kanë?!

Pamja e pestë përfytyronte dy vija të zeza e paralele, që duke fillue prej nji skele të Adria'ikut ndiqshin nji buzë lumi si gjarpnusha. U çudita. e pvetë mikun që kisha pranë, c'ishte kjo. Ai m'u përgjegj se ai lum ishte Shkumbini plak e ato vija ishin të shemendiferit Durrës-Maqedoni. që ishte ndërtue në vitin 1999 me përpjekjen e deputetëvet tanë.

Unë u hutova e më banë sytë sikur erdh nji tren që do të nisesh për Maqedoni; ec të hypim, i thashë mikut tem. Por kur u ngrita me rrëmbim mbë kambë c'të shoh! Ndodhesha mbi shtratin tem që flia!...»¹⁾

Le të shikojmë tani se ku godasin këto shkrimë të Eminit të paraqitura në formën e një ëndrre. Më pamjen e parë ai godet ish-peshkopin e Durrësit. Jakovin, dhe disa grekomanë të Korçës cë komplotonin me të pér ta bashkuar këtë qytet me Greqinë. Ky klerik kur erdhi në Shqipëri, erdhi si grek dhe vetëm pér t'u shërbyer interesave të Greqisë. Që në kohë të Turqisë ishte mik i zyrtarëve të lartë turq dhe më vonë bashkëpunëtor i ngushtë i Esad Pashës në Durrës. Në vitin 1912 u përpoq të pengonte ortodoksët elbasanas dhe të ndikonte tek myslimanët që të mos ngrinin flamurin

1) «Shkumbini», nr. 12, dt. 1 prill 1921.

kombëtar. Me pushtimin e këtij qyteti nga serbët ai u bë agjent i tyre, duke kallxuar patriotët vendas. Gjatë Luftës së parë botërore, me ndihmën e komandës franceze ai erdhi nga Selaniku në Korçë si agjent i shovinistëve grekë¹). Me pamjen e dytë të filmit godet vendimin e qeverisë reaksionare të Iljaz Vrionit për të nxjerrë të pafajshëm e për të liruar nga burgu disa tradhëtarë esadistë. Pamja e tretë e këtij filmi stigmatizon komplotiston dhe intrigandin e pa skrupull, Ahmet Zogun, i cili qysh atëhere aspironte e punonte nën rrugoz për postin e kryetarit të shtetit. Në pamjen e katërt, Emini me humor të hollë godet lakminë e deputetëve për të zënë poste të rëndësishme në aparatin qeveritar, ndërsa në pamjen e pestë e të fundit, ai vë në lojë bukur premtimet e bujshme mashtronjëse të deputetëve dhe qeveritarëve feudobor-gjezë, të cilat mbeteshin vetëm në letër.

Ja edhe një shkrim tjetër i fortë alegorik:

«S'di pse më k'anda të vizitoj ma tepër shkollat se parlamentin?! — pyet Emini. — Ndofta pse shkollat çilen në orë të caktueme edhe nxanësit ndigjojnë e thonë mësimet plot urti, rregull që fort rrallë e kam pa në Këshillin Kombëtar.

Por sa i çuditshëm m'u ka dukun nji mësim që më kanë ndi veshët nji ditë në nji shkollë! Isha

1) Për këtë klerik reaksionar, në përgjigje të gazetës «Koha», e cila njoftonte se ai u emërua nga Patriarkana si eksark i gjithë Shqipërisë, duke ngritur lart «meritat» e tij për zgjidhjen e çështjes së Kishës autoqefale shqiptare, gaza-ta «Shkumbini», numër 3, datë 28 janar 1921, botonte artikullin «Një eksark i huaj në Shqipni».

mbrenda në nji rend, kur mësuesi po epte mësim në gieometri edhe hyni një nxanës emnit **Mark**, i cili përshëndeti mësuesin:

Mirdita z. mësues! Mësuesi as që iu përgjegj, po vazhdoi në mësimt me këtë mënyrë: «Pra, për shembull, marrim nji pe e i varim nji trup të rindë pér fundit dhe drejtimi që merr ai quhet kulmore (shakul)». «Po tē jetë pe mirë, se i varim nji **plumb**, por kur asht litar ç'mund t'i varim?» pyeti nji nxanës mësuesin.

«Varim z. **Mekdi**» tha njani prej nxanësish, duke e diktue me gisht nxanësin që mbante këtë emën...

Mësuesi u nxe e u foli nxanësve.

Duke ndi fjalët litar e **plumb**, mue m'u kujtue titulli i nji kryeartikulli që u botue vjet në gazeten «Zani i ri» me kuptimin që tē përdoreshin këto pér popullin e ngratë, në vend që duhesh e lypset m'u përdorue pér ata që nuk dijnë apo nuk duen ta sundojnë (drejtojnë sh.a.) këtë komb fatzi!!!»¹⁾

Në këtë shkrim tē Eminit, nxënësi me emrin **Mark**, personifikon kryebajraktarin e shitur Marka Gjonin, përshëndetja e të cilit: **Mirdita** z. mësues, aludon krahanë e Mirditës dhe mospërgjigja e mësuesit stigmatizon mospranimin e qeverisë pér bisedime me përfaqësues tē kësaj krahanë, para dërgimit prej saj tē forcave ushtarake pér shuarjen e kryengritjes. Massa e nxënësve në këtë shkrim përfaqëson vegjelinë dhe emri i «nxënësit» z. **Mekdi**, personifikon ministrin e brendshëm, Mehdi

1) «Shkumbini», nr. 30, dt. 16 shtator 1921.

Frashërin, në kabinetin e parë të Iljaz Vrionit, të cilin autori e ngarkon me përgjegjësi për ngjarjet e përgjakshme të Mirditës.

Kriimtaria publicistike e Emin Matraxhiut shkon gjithnjë në rritie, si sasi dhe si cilësi, si formë dhe si përbajtje, duke iu përgjegjuri kurdoherë jo vetëm detyrave të kohës por edhe atyre të perspektivës.

Rubrika satirike «Tragëzat e mullinit», ngriti problemet më akute të kohës. siç ishin çështja e bashkimit të popullit dhe mbrojtja e kufive të atdheut, çështja e luftës kundër feudalizmit dhe padreitësisë shoqërore dhe. lidhur me këtë, çështia e zhvillimit të gjithanshëm demokratik të Shqipërisë së pavarur. Pikërisht rrëth këtyre problemeve të mëdha përqëndrohet tematika e pasur dhe e larmishme e shkrimeve të Eminit, të botuara në këtë rubrikë, që e vunë atë në radhën e publicistëve më të mirë të kohës. jo vetëm në qarkun e Elbasanit, por edhe në gjithë vendin. Që me daljen në dritë të kësaj rubrike satirike, Emini me një kurajo të admirueshme ngrihet kundër manevrave, dallaverave dhe komplateve të maqinës qeveritare dhe klasave feudoborgieze gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e deputetëve të parlamentit. Ja çfarë shkruante ai në «Tragëzat e mullinit»:

«Duke pamun gjithëfarë qarkoresh të bukura të qeverisë. që ndalojnë rrëptësish nëpunësit e zyrtarët që të përzihen në punë të zgjedhjeve, oh! si lum na. i thashë nji shoku. sepse edhe qeveria ionë zu të ndjeki metoda, ligje... masa paansie... traita qytetnimi, etj.

S'di pse m'aqë duf të madh zuni të më thotë shoku:

Mos u shpejto, të lutem, se gjithë këto shpallje mos na dalin fyçka... Druj se ato mos janë bamen për t'i hudhë popullit hi syvet?! A nuk ke ndi çar flet populli për disa krahinarë e zyrtarë që kanë dalun katund më katund si Maloshoviqet, duke i shpjegue çar bidati janë zgjedhjet dhe duke i këshillue se kujt (?) t'i japin votat?! A nuk të ka ra me dalë natën e me pamun se si luejnë fenerët duke trakullimun derë më derë për vota si në vaktit?..

Ndofta s'di gja qeveria për ksi rrjedhjesh, i thashë shokut, kur ai, me zemër në fyt, ma ktheu menjëherë:

Po, po, s'ka gja që s'bahet, se sa të mbarohen (sic) zgjedhjet, qeveria 'ban sikur ban hetime e ma në fund, në mos goftë e vërtetë, zë dhe e përgënjeshtron!.. Na rruat gazi».¹⁾

Dhe këtë shkrim të goditur mbi çështjen e zgjedhjeve e pason panfleti i tij satirik, në të cilin vihen në lojë programet demagogjike të kandidatëve për deputetë, pazotësia dhe injoranca e tyre, duke i treguar lexuesit se si do të veprojnë ata në realitet po të zgjidhen.

«Të dashun bashkëqytetarë! — thuhet në këtë shkrim. — S'ka si bahet ma i madh gjësim për mue. Më vjen ta flak përdhe kësulën prej gjëzimit! Oh! Sa rast i bukur për mue që t'i shërbej atdheut! Për të mos humbë këtë rast pra, sot kam nderin t'ju dal përpara dhe t'ju shpall kandidaturën teme për deputet, me këto qyshke (kushte sh.a.):

— Në goftë se unë do të bahem deputet, do

1) «Shkumbini» nr. 2, dt. 21 janar 1921.

të blej nji dry dhe do ta kyç gojën fare. Larg meje çdo kritikë, çdo kundërshtim, çdo ankim kundër çdo qeverie që të ketë frenin në dorë!.. Do të jem pohist (evetçi) plot goja.

— Në qoftë se në parlament kanë me u formue partina politike, unë do të marr pjesë nga ma e forta, por nuk do të jetë e vështirë për mue me luejtë bishtin nga të mund!..

— Në qoftë se më do zoti fort?!? e më ecën zari, që ishalla bahem ndonji ministër, do të përpinqem të shpiлk ndëpunsina vend e pa vend dhe do të vendos me rroga të plota: a) farefisin, b) miqt, c) gjithë shqiptarët!...

— Nuk kam me ndërrue mendjen (si Mustafa Kruja?) për punë të Asamblesë, por kundër kam qenë dhe kundër do të jem, deri sa të zbres ndonji statut prej qiejsh!...

— Sado që kam edhe unë nji pendë të fortë (që mund t'i afrohet asaj të Filip Podës), por do ta thyej menjëherë, sa që të bëhem deputet!..

— Asht e tepërme që të baj fjalë për dashni-në që kam për atdheun tem, e kujtoj se kjo frazë përfytyron mirëfilli atdhesinë teme:

*Atdhe kam gjithë tokën,
Vllazni kam tanë botën!...*

Kjo asht programma e eme, bashkëqytetarë të dashun! Pra mos ma hani hakun, por hudhni votat tueja me shkrim.¹⁾ Shigjeta».²⁾

1) Ironi e hollë për ligjin elektoral që parashikonte votimin me shkrim në një kohë kur mbretëronte analfabetizmi.

2) «Shkumbini», nr. 5, dt. 11 shkurt 1921.

Emini e mban kurdoherë zjarrin tē ndezur pēr t'u djegur kartat nē dorë armiqve tē popullit. Kësh-tu veproi ai gjatë zgjedhjeve, duke demaskuar demagogjinë mashtruese tē kandidatēve, fjalët e tyre tē bukura e premtimet boshe sa tē merrnin votat.

«Oh!... Si lum ata që do t'ia mbërrijnë dimnit tē vitit 1922... — shkruante ai nē njérin nga fejtonet e tij. Pse nē këtë vit Shqipnia do tē jetë ba porsi nji lulishte e qytetnimit mun nē mest tē Evropës!... tē thuesh si Svicra? Jo, se gabon, ma e mirë, ma e bukur, do t'ia shkojë edhe asajë!... Gjithë dhunitë e kësaj bote, që mund t'i përbledhë penda e Filip Podës, do tē grumbullohen menjisherë n'atdheun t'onë, edhe si? Sa tē çelësh e tē mybillysh sytë!... Me se? S'ka dyshim se me frymë!... Udhë tē hekurta si vija paralele do tē shtrihen mbë çdo kand tē Shqipnisë, banka kombëtare... shkolla bujqësie me laboratore, me çiflike model... shkolla navale (Deti).... Ndriçimi i Shqipnisë me dritë elektrike që tē shofit edhe i verbti brimën e gjylpanës... Aeroplana pa motor pēr postë... e ku ta di unë i ngrati çfarë tyrlahanesh tē tjera!... Të mos e harrojmë kurrë se gjithë këto mirësina shteti shqiptar do t'ua ketë pēr detyrë e pēr miradi nj'atyne kandidatëve me programe.

*Pra, popull dif! popull trim!
Popull kreshnik! popull besnik!*

Çëmoi edhe zgjidhi këta kandidatë pēr deputetë, që tē na ndrisin Shqipninë, sado që n'arkën e saj kërcejnë mijtë!... (Ting veshit Curanit)?».¹⁾

1) «Shkumbini», nr. 6, dt. 18 shkurt 1921

Dhe kur muarën fund zgjedhjet në disa kra-hina, Emin Matraxhiu demaskon flakë për flakë, para lexonjësve, qëllimet egoiste nga të cilat do të udhëhiqeshin deputetët feudoborgjezë të ardhur në fuqi, mbi bazën e ligjit elektoral antide-mokratik dhe të dallaverave pa skrupull.

«Deh, moj pikë!... — shkruan autor i Halle, por halle të pasosura. Mbarimi i zgjedhjeve të Gjirokastrës, që më plasën shpirtin prej kaq kohësh, ma patën hequn të thuesh nji të tretën e hallit që kisha, sado që me përfundimin e tyne u helmova ma keq se derëziu Mufit!... (Mufit bej Libohova sh.a.).

Dy të tretat e hallit të madh që shumë herë më nxori edhe gjumin e natës, kishin mbetë të m'i hiqte dita e hanë, kur gjetën fund edhe zgjedhjet tonë. U përmata njihetë të përshkruej hollësisht përshtypjet e kësaj dite, por duke pasë frikë se mos më mbesi maja e pendës mbrenda në mellant (bojë), po e le e vetëm po shënoj se pat edhe Elbasani nji obstruksionist!..

Po, për zotin, më zini besë, se nga përfundi mi i tyre jam shumë i kënaqun... tepër i gëzuem... Pse unë s'jam i marrë si populli që të kërkoj gjana që s'mund të bahan sot, shemendifer që të përtërijë Via Egnatia apo elektrike, ect. Por ma këndë t'i gjykoj punët mbas proverbit frengjisht që thotë: Chacun pour soi (gjithkush për vehte). Prandaj gëzimi em asht i pamasë... Sepse shikoni çar hesapi baj unë: me ra ngushtë, shkoj e i mbettem më qafë z. ministër, që të më vendosi mbë ndonji ndëpunësi, me ra sëmundë vete e i marr barnat pa të holla ke z. barnar, me më paditë ndokush vete e za për gryke z. avokat, që të mbarojë

gjyqin pa më marrë asnji koron, e me më mbetë shtëpia pa kafe a sheqer çoj e mbush zimilen ke z. tregëtar, pa i pague as gjasend!.. Shikoni, a kam shënue mirë, të dashun këndues? Apo doni të thoni se nuk kam arësy? E pse? A nuk kam dhanë edhe unë votën për ta?

Pse, detyra e deputetëve a nuk asht të përkrahin e të ndihmojnë bashkatdhetarët e tyne të pafuqishëm? A thue se libri i moralit nuk urdhënon kështu?..

Dasha të them edhe nji gja, mirë po:

*Them, t'ia them, s'ja them dot
Sytë... po qajnë me lot!...»¹⁾*

Sic shihet, në këtë shkrim Emin Matraxhiu na nxjerr në pah përbërjen shoqërore të deputetëve të zgjedhur në Elbasan, të cilët vinin të gjithë nga klasat feudaloborgjeze, ishin «zengjinë» (të pasur), sic thoshte ai, dhe si pasojë do të përfaqësonin në parlament këto klasa në dëm të shtresave të varfra, të vegjëlisë. Kur flet edhe për një «obstruksionist», që doli në këto zgjedhje Emini e ka fjalën për kameleonin Mehdi bej Frashërin, i cili u zgjodh deputet nga ana e Elbasanit me ndihmën e Vërlacit. Në fund të shkrimit ai shpreh se don të thotë edhe diçka, por nuk e thotë dot. Këtu e ka fjalën për Shefqet bej Vërlacin, i cili gjithashtu u zgjodh deputet. Për figurën e urryer të këtij kryezengjini, jo vetëm të Elbasanit por të mbarë Shqipërisë, Emini prej kohe përpiquej të shfrente urrejtjen e tij me anë të ga-

1) «Shkumbini», nr. 11, dt. 25 mars 1921.

zetës, por çensura nuk e lejonte, prandaj sytë i qanin «me lot», siç na thotë vetë në këtë shkrim.

Krahas demaskimit të demagogjisë elektorale të klikave sundonjëse, Emin Matraxhiu u tregon me largpamje lexonjësve edhe se çfarë do të ndodhi pas zgjedhjeve, kur të hapet parlamenti, duke i parapregatitur ata që të jenë vigjilentë kundër veprimtarisë karrieriste, përcarëse e të dëmshme të armiqve të popullit e të atdheut.

«Diplomat mbas gjuhës së politikanvet, quhet nj'ai që gjen sende të mrekullueshme (myxhize) para se të bahan!... — theksion Emini. — Dihet se për së shpejti do të mblidhen në Tiranë deputetët tonë e do të hapet parlamenti shqiptar. Mirëpo ç'do të bahet? Këtë askush s'mund ta gjejë veçse një diplomat gjeni (dahi)..., si jam vetë dora. E para punë që do të bahet atë ditë që do të çilet parlamenti asht se porsa t'i dalë përparrë kabinetin i Iljaz Beut për t'i dhanë shpjegim deputetëvet, këta pa vonim e përnjihërësh do t'i rrëfejnë mosbesim, për arësy, se shumë prej asish, mbasi i ka zanë sëmundja e ambicis! (sandallies), do të dëshirojnë që të zanë gjithsekush nga një kulltuk ministrish!... Nuk do të bajë dobi as zotimi që mund të bajë kabinetin për t'ua shtue ylefët (rrogat sh.a.) deputetëvet, sikurse për fat të keq s'ka për t'u çëmue as shërbimi, as shëmtimi që mund të ketë bamun kabinetin Vrion faqe At-dheut?!

Mbas disa ditësh, si të marrë fund Post-Kav-gasi (zënja për seli), puna e dytë që do të ndodhi asht që në parlamentin kombëtar do të bijnë vetë-vetiu dy partina politike: njana Aristokrate, që mbas gjuhës së kombeve quhet Feodale, e tjetra

Nacionale, që mbas gjuhës së feodalëvet quhet Harbute. Nga kundërshtimet e rrepta që do të kenë këto parti ndërmjet tyre, çashtja e kabinetit (për të zezët të atdheut) për disa kohë do të vijojë mbas proverbit toskërisht:

*Atje poshtë, te ajo ripa,
Her më zbrite, her të zbrita...»¹⁾*

Pas hapjes së parlamentit dhe mbarimit të pikave proceduriale të rendit të ditës, që zgjatën dy muaj, duke u zvarritur e duke u bërë tërkuzë, i erdhia radha qeverisë së Iljaz bej Vrionit për të raportuar para këshillit kombëtar mbi aktivitetin e saj. Lidhur me këtë moment të rëndësishëm të sesionit parlamentar, Emini botoi, nën titullin «Ora e fundit», një shkrim me forcë të madhe goditëse kundër bejlerëve dhe pseudopatriotëve, që kishin zënë pushtetin.

«A e dini, të dashun këndues, se sa e mërzitshmë asht ora e fundit?» pyet Emini. «A e dini se sa lemeri e tallaz ka për nji të burgosun që pret të dalë nga burgut, për nji fajtuer që pret me iu dëftye dënim, për nji nxanës që pret t'i kallëzohen numrat e provimit, për nji njeri që asht duke iu fikë jeta, për nji kryeministër që ka me kërkue besim prej parlamentit?

... Ah sa keq më vjen për kryeministrin tonë se ora e fundit për të e mbërrini!..

Po çka, se Iljaz beu, si thonë, ka gjetë nji udhë të kollajtë, ai bashkë me shpjegimet do të api edhe dorëheqjen. Disa thonë se e do ndera që

1) «Shkumbini», nr. 7, dt. 25 shkurt 1921.

Iljaz beu të matet dhe të kërkojë votëbesim, disa thonë se ai nuk asht i marrë që ta bajë këtë...

«Mos u gëzo o i gjëzuem, mos u helmo o i helmuem», thotë nji fjalë e urtë. Tiranësit thonë: «Kali ku bie, aty ngrihet» dhe kështu, nuk asht çudi që Iljaz beu në mos kollauz prapëseprapë do të jetë në karvant. Unë s'kam qeramet po kam arësyse se kabinetin shqiptar s'mund ta formojë tjetër kush veçse ndonji pashë apo bej! Ruejna zot nga harbutët!

Në këtë orë të fundit për kabinetin kushedi se sa mbledhje patriotike (!) bahen në Tiranë, e kushe-di se sa patriotë nationalistë (!) përmaten me zanë ndonji kulltuk ministri! Natyrisht atdhetaria në këso orësh dëftehet, kur asht atdheu në hall: edhe hall ma të madh se m'u ba ministër në Shqipni nuk ka!!!... O burrani prifni dhambët».¹⁾

Në çdo numër të «Shkumbinit» ku botonte «Tragëzat e mullinit», Eminin e preokuponte vazh-dimisht çështja e gjetjes së formave të reja në shkrimet e tij satirike, në mënyrë që ato të mos bëheshin monotone e të rëndomta për lexuesin. Një shembull i punës së tij krijuese novatore në këtë drejtim, i mprehtësisë së tij në shfrytëzimin e çdo rasti për forma të reja të shkruari, në përshtatje me temën, i lidhjes së ngushtë të formës me përbajtjen, duke e parë kurdoherë të parën në funksion të së dytës, që është primarja në letërsi dhe në publicistikë, janë edhe këto dy shkri-me satirike, ku, ndër të tjera, thuhet:

«Kryeartikulli «Pambesim» që pat botue drej-tori ynë (në këtë kohë ishte akoma drejtor i gaze-

1) «Shkumbini» nr. 24, dt. 24 qershori 1921.

tës Filip Papajani (Lipi) sh.a.) në nji numër të shkuem, më bani që paskëndej të kem besim pér çdo gja. Kështu pra:

Besoj se drejtori i doganës së Durrësit nuk i hapi fare syndykët e teshave të nji ish-ministri që kushtojshin ma tepër se 150.000 lireta.

Besoj se nji deputet që ka qenë major ma parë ende s'ia ka kthye arkës së batalionit 15.000 liretat që i ka marr!

Besoj se nji ministër i... si u kthye prej udhëtimit, shkroi 110 fr. ari si shpenzim prej Durrësi në Tiranë me avullor (?).

Besoj se në Sarajevë asht shtypë nji mevlud shqip me shkronja arabishte e ky i asht dedikue z. Ahmet Zogollit!

Besoj se nji ish-ministër fatosh (Ahmet Zogu sh.a.) asht duke studjue (mytebea) historinë e Napoleonit edhe ma tepër librin Prens (II principe), që ka botue Nikolla Makiaveli!

Besoj se me këto andrra që ka, ky zotni, do të pësojë si «Jean Lebaudy», që u përpoq duke u shkri së gjithash pér t'u ba... mbret i Shkretinës (Sahariës)!

Besoj se duke humbë nga tre deputetë në ditë, Partia «Popullore» nuk e ngrys javën!

Besoj se dikur do të plasi ndonji vullkan në Ballkan!

Besoj se në tre regjimentet e Ushtrisë Shqiptare, rrallë i takon syut me pamun ndonji djalosh beu a të pasuni!.

Besoj se gjithë çelësat e sythvet (çekmexhe) të tryezavet të parlamentit këndojnë: Roma!

Besoj se marrëveshja italo-shqiptare do të mbarojë në mënyrë që italianët do t'u apin shqip-

tarëvet çar të duen, e shqiptarët s'do t'u apin italjanëvet farësendi (sic)!

Besoj se serbët kanë arësyë (!) mbi Durrës e Sh'njin, e shqiptarët për Kosovë jo!

Besoj se ka të drejtë nji deputet që trembet se mos bahet kiameti (!) e mos idhënohet (!) Evropa po të kërkojë qeveria jonë të mbrojtunit e të drejtavet të shqiptarëve të Çamerisë e të Kosovës!...»¹⁾

Krahas demaskimit të komploteve të shovinisteve fqinjë dhe veglave të tyre, Emin Matraxhiu, në shkrimet e tij satirike, kritikon ashpër edhe fuqitë e Evropës, të cilat e konsideronin Shqipërinë si gur shahu për kombinacionet e tyre politike në Ballkan. Ja çfarë shkruan ai lidhur me këtë:

«Duke bisedue nji ditë me nji mik përmbi zakonet e ndryshme që ndajnë evropianët nga shqiptarët, ai më tha se... evropianët rrenën e kanë përgja të keqë dhe e dënojnë... etj. etj.

E ndigjova me katër veshë mikun dhe i dhashë të drejtë për shumë gja, por veç sun durova përpunjë të rrenës, se ai dalëngadalë po m'i bante evropianët të shenjtë!..

E pyeta menjiherë:

A beson zotnia e jote se evropianët nuk rrejnë?

Jo, kurrë.

Sidomos ata e nderojnë fjalë që të apin?

Po, po.

Po pse pra, ore lum miku, ata nuk e nderojnë fjalën që kanë dhanë në Londër mbë 1913 (për çështjen e kufive të Shqipërisë. Shén. aut.) por e

1) «Shkumbini» nr. 18 e 19, dt. 13 dhe 20 maj 1921

ridërlikin dhe duen t'i lëpijnë edhe nënshkrimet që kanë vu aty poshtë?

...
Mos i rrudh krahët ashtu, po thuaj edhe ti, bashkë me mue, se ka edhe evropianë rrenës, rrënues, grabitës!»¹⁾

Duke lexuar me vëmendje shkrimet e tij, do të shikojmë se ka raste që Emin Matraxhiu jo vetëm zbulon plagët e shoqërisë dhe gjen burimin e tyre, por e kuption edhe cili është ilaci dhe mjeku aë i shëron këto plagë. Nuk është e rastit që në «Tragëzat e mullinit», ai, duke polemizuar me gazeten «Zani i ri», shpreh mendimin se plumbi dhe litari «lvpset të përdoren për ata që nuk dijnë ta sundoinë (drejtojnë) këtë komb fatzi!!»²⁾. d.m.th. kundër shtypësve dhe shfrytëzonjësve të vegjëlisë. Gjithashtu nuk është na kuptim që në kryeartikullin «Populli pret» Emini, duke iu drejtuar deputetëve mbi komplotet e rrezikshme të Shefqet Vërlacit dhe Ahmet Zogut për usurpimin e pushtetit, shkruan: «Në qoftë se nuk dahet shapi e sheperi, në qoftë se puna vete si ka shkue e deputetët mbyllin sytë për hatër të selisë, atëhere thomi ciltas se fjalën e fundit do ta thotë populli e davaja ka me u da si ma mirë. »³⁾

Në këtë paralajmërim ne vërejmë jo vetëm besimin e Eminit në forcën e popullit, por edhe aftësinë e tii parashikuese për të ardhmen, për ngjarjet revolucionare, që do të çonin në shpër-

1) «Shkumbini», nr. 23, dt. 17 qershori 1921

2) «Shkumbini», nr. 30, dt. 16 shtator 1921

3) «Shkumbini», nr. 42, dt. 16 dhjetor 1921

thimin dhe triumfin e përkohshëm të Revolucionit demokratiko-borgjez të qershorit 1924.

Por megjithë këto nuanca, që i kalonin caqet ideore të lëvizjes demokratike të kohës, në përgjithësi Emin Matraxhiu, në veprën e tij patriotike mbetet një demokrat revolucionar, ndërsa në fushën e publicistikës një kritik i mprehtë realist.

Shkrimet e Eminit shponin si shigjeta dhe grisnin pa mëshirë maskat mashtronjëse të sunduesve feudoborgiezë, duke nxjerrë lakuriq para lexonjësve faqet më të errëta të realitetit të hidhur të kohës. Në majë të shigjetës së tij ai kishte vënë ata që shtypnin dhe shfrvtëzonin vegjelinë e fshatit, ata që e kthenin gunën nga të frynte era, ata që ishin gadi në çdo moment ta nxirrin Shqipërinë në ankand tek të huait për interesat e tvre klasore. Pra objekt i kritikave të tij dërmuese ishin bejlerët cifligarë, zengjinët, ministrat reaksionarë dhe deputetët e parë pseudopatriotë, të cilët e quanin veten «baballarë të kombit». Duke vënë theksin e kritikave të tij tek bejlerët cifligarë, ai i ieo të kuntoi lexuesit se në këtë kohë plaga më e madhe ishte mënyra feudale e sundimit, pa zhdukjen e së cilës nuk mund të hvnte vendi në rrugën e zhvillimit demokratik. Ja sepse, shkrimet e tij satirike, humori i tij i lehtë, cë shoesh herë merrte nuancat e hinerbolit dhe të një ironie të hollë, e cila, sipas obiektit që goditei shkonte deri te grotesku e sarkazma, përpjekeshin nga lexonjësit, dhe kjo ndodhje jo vetëm për bukurinë e tyre artistike, por kryesisht për përbaltien dhe frymën e tyre luftarake. Ja sepse, këto shkrime, kur i lexon, me-

gjithë format e tyre të ndryshme, që shpesh arrin në deri te fabula, nuk të shtyjnë të mendosh se ke të bësh me humor për humor, ose me përralla të treguara netëve të gjata të dimrit, por me probleme të rëndësishme shoqërore, që shqetësonin shtresat e varfëra në atë kohë. Dhe në shumë prej këtyre shkrimeve të duket sikur shpërthen nga thellësia e zemrës dufi i vegjëlisë, përmes pendës së birit të saj besnik, të talentuar e guximtar, të përgjuar e të rrezikuar vazhdimisht nga spiunët dhe agjentët e qeveritarëve reaksionarë dhe të bejlerëve vendës. «Zhurma shurdhuese» e tragëzave të mullinit të tij, siç e cilëson ai, i ngjante zhurmës së zgjatur të bubullimave në qellin e shqetësuar e plot re të zeza të Shqipërisë së atëherëshme, paralajmëruese të stuhisë revolucionare, që shpërtheu në qershori të vitit 1924.

«SHTYPI KOMBËTAR NDAHET NGA NJE SHOK I DASHUR E I DUHUR»

Të admirueshme ishin guximi dhe vullneti i hekurt i Emin Matraxhiut në luftë të pandërprerë e gjithnjë më të ashpër për interesat e atdheut e të popullit, të cilat buronin nga dashuria e flaktë që kishte për ta, nga urrejtja e thellë për armiqtë e tyre të brendshëm e të jashtëm. Ai përballoi pa u epur të gjitha goditjet e armiqve, të cilët e arrestuan katër herë me radhë, duke dalë çdo herë e më i vendosur nga birucat e errëta dhe plot lagështirë të burgut. Emini i shpëtoi edhe dënimit me vdekje të pushtuesve serbë, por ai, megjithë guximin dhe moralin e tij të lartë, nuk mundi t'u bënte ballë gjatë bacileve të kokut që po i copëtonin çdo ditë e më shumë mushkëritë. Të ndihmuar në punën e tyre vdekjeprurëse, ngajeta plot vuajtje e Eminit, dhe, sidomos nga kushtet shkatërrimtare të burgut, këto mikrobe e shkurtuan jetën e tij aq të vlefshme për më-mëdheun dhe vegjelinë.

Nga fillimi i janarit të vitit 1922, trupi i drobitur i Emin Matraxhiut lëngonte rëndë në shtrat. Por edhe nga shtrati, me dorën që i dridhej, po me përpikmërinë që e karakterizonte, vazhdonte

të lëshonte shigjeta të mprehta. Dhe shigjetën e fundit Emini e lëshoi kundër Mehdi Frashërit, duke parashikuar se ky tradhëtar profesionist edhe në të ardhmen do të vepron te kundër interesave të atdheut, ashtu siç bëri me të vërtetë, duke u shërbyer armiqve të vendit e të popullit edhe gjatë Luftës nacional-çirimtare.

Ja çfarë shkruan për Mehdi beun, në panfletin satirik, me titull «Nji i madh i vogël»:

«Qysh kur ishte i vogël, ai dante se dikur do t'u bante njeri i madh! Mbaroi shkollën në Stamboll, dhe, mbas dishirit që kishte për t'u ba burrë shteti, u hodh në nëpunësi. Ai nuk u përlëkur aq shumë në Sublime Porte (Bab-i-Ali), por u emnue menjicherë nënprefekt në Shaipni. Dha fjalën e bani edhe be se kishte për të punue besnikërisht për Sulltanin, dhe Stambolli e kishte besimin të patundun ke ai. Peqini, ku ai veproi si nënprefekt, edhe sot e kujton me mall (!) e nuk ia harron ri ndërtimin e disa shkollave (?) e rrugëve (?) që pat ba!..

Asokohe kur ai ndodhesh nënprefekt n'Ohri, bindi Maqedonin me riforma (isllahat), duke ndjekun e duke djegun nationalistët bullgarë me forra... .

Si shpërblim të zotësisë që dëfteu gjithkund, u ba prefekt nga fushat e Selanikut, dhe vinte shpesh herë në qendër të vilajetit. Ai qysh prej vjetësh ishte idealist e nationalist, por moderé (mytedyl). Vente e epte sa herë konferenca turkçe në «Bashkimi» të Selanikut, duke thanë: se na jemi besnikë Osmanlli, e Osmanllijtë janë ata që kanë shkue trionfisht deri nëpër portat e Vjenës!.. Në Turqi përmendesh me gisht për punë të ad-

ministratës bile ai pat botue edhe nji libër turkçe... Ma vonë ai qe emnue andej nga fusha e bukur të Felahijvet!..

Kur ndiu se Shqipnia ishte da më vete, ai rendi menjiherë pér në atdhe. Si nuk i erdh Vlona pér hesap, shpejtoi pér Durrës ke Esati. Kur plasi trazimi i rebelëvet (kryengritja e fshatarësisë e vitit 1914 sh.a.) ai, pér t'u shue rebelizma, desh që të vinte nga Stambolli nji komision këshillues, por nuk e ndigjuen?!

Ai, si i shkoi gjithë mjerimet e luftës së pérbotshme n'Itali, duel ma në fund në Vlonë, e aty bleu nii kalë 30 napolonash. Nisi të dyshojet gjithësekush, kur pa se ai që vuante ma pérpara uriet tash bleu kalë 30 napolonash!..

Mirëpo ai kishte ba mend që në kurrizt të këtij kali të shëtiste vendin mbarë, duke dhanë konferanca gjithëkund!..

Ai u mundue mjaft pér t'ia mbërrri nji qëllimi të naltë, por mjerisht u lodh kot, se puna i duel shpuet.

Në Kongres të Durrësit... ai, si delegat i tanë Shqipnisë (!), tregoi hollësi mendjeje veç shokësh, sa qì shkaktoi largimin e delegatëvet të Gjinokastrës. Mirëpo mundimi i gjithë atyne përpjekjeve që difteu ai duel plot fryt. Kur u ba ministër i punëve të brendshme lum ai e lum Shqipnia! Mbas pak kohësh ai shkoi si delegat në Paris. Në këtë qytet, që asht qendra e savantëvet të Francës, ai gjeti rastin m'u matun me ta!...

...Fati i keq i Shqipnisë se kur u ba Kongresi i Lushnjës, ai nuk u ndodh atv; kështu që statuti që shpëtoi atdheun duel çyryk! Kur u ba rebelioni nr.2, që Osman Bali zu të hajë barot me lugë, ai e

quejti për detyrë të vijë shpejt prej Parisi në Shqipni, për t'i shërbye atdheut.

Si u rehatue pak Shqipnia, ai u zu me tregëti. Kjo ishte edhe mënyra që mund t'u mbyllte gojet atynevet që flitshin keq për të.

Si ministër i punëve të brendshme që kje në kabinetin I të Vrionit, ai me sistemet e bukra të administratës së tija, ngatërroi sa Jugën sa Veriun. Në trazimin e Mirditës ai desh të bindi malësorët me forcë (?!), e kështu i hodhi zjarrit barot e e xhyrxhile!... Ai u ba edhe deputet, e për këtë i asht mirënjoftës nji miku, (Vërlacit sh.a.) se «ma mirë nji mik se nji çiflik»!..

Si ministër i punëve botore ai u zotue se do t'i mbaronte rruget e Shqipnisë për dy vjet! Shkoi për këtë punë në Evropë edhe pruni nga 15 ingjenjera e specialista, por ai harroi se në buxhet s'kishte kredi për ta!.. Kështu që sot ingjenjerët austriakë sillen e përsillen nëpër Tiranë!..

Projektet e tija, kur bisedohen në parlament, zgjaten me orë e me javë, se i ka ba të gjitha me qokë e me vend, si edhe mbas psikologjisë së...

Ai asht, me nji fjalë: administrator, orator, diplomat e filosof. Për së afërmë ai prapë do të zani ndonji seli, e m'atëhere lum e lum Shqipnia!..¹⁾

Pas botimit të këtij panfleti, aq të bukur e të goditur, që mbylli krijimtarinë publicistike të Emin Matraxhiut, gjendja shëndetsore e tij u këqësua shumë. Miqtë dhe patriotët nga Elbasani, Durrësi, Tirana, të shqetësuar u vunë menjëherë

«Shkumbini», nr. 46, dt. 13 janar 1922.

në lëvizje, siguruan lejen dhe të hollat e nevojshme për ta dërguar për mjekim në Napoli. Një natë përpara nisjes, shtëpia e tij u kthyte në vend pelegri-nazhi. Miqtë e tij patriotë, si Ahmet Gashi e të tjerë, së toku me njerëzit e shtëpisë, po bënин pregatitjet e rastit për udhëtimin e vështirë deri në Durrës, nga ku ai do t'i hypte vaporit për në Itali. Me dhjetëra njerëz nga vegjelia e qytetit dhe e fshatit, hynin e delnin në shtëpinë e Eminit për ta vizituar dhe për t'i uruar udhë të mbarë e shërim të shpejtë.

Para se të nisej, i përcjellë nga miq të tij të ngushtë dhe i rrëthuar nga dashuria e vegjëlisë, Emini i njofton lexuesit për largimin e tij dhe ndër-prerjen e përkohshme të botimit të «Tragzave të mullinit».

Në këtë lajmërim të shkurtër plot humor e optimizëm, duke e quajtur qerren me të cilën do të udhëtonë nga Elbasani në Durrës «aeroplan», Emini, ve edhe një herë në lojë klikat sundonjëse feudoborgjeze, që e kishin lënë vendin në prapambetje të madhe.

«Shigjeta ka dalë në udhëtim me nji aeroplan, thuhej në lajmërim, e deri sa të kthehet kërkon ndjesë prej kënduesve»¹⁾

Që ditën e largimit të Emin Matraxhiut nga Elbasani, kryefeuDALI Shefqet Vërlaci dhe feudalët e tjerë në qeverinë reaksionare të Xhafer Ypit, sidomos dhëndri i Vërlacit, Ahmet Zogu, e shtuan presionin e tyre të gjithanshëm kundër gazetës «Shkumbini». Tashmë mbyllja e kësaj gazete ishte çështje ditësh. Dhe ja, në numrin 48 të «Shkumbini

1) «Shkumbini» nr. 47, dt. 20 janar 1922.

nit», lexuesit gjetën këtë njoftim të drejtorisë së gazetës:

«Me idhnim të madh lajmërojmë kënduesit e dashun se «Shkumbini», i shtrënguem nga disa shkaqe, pushon përkohësisht».

Autorët e këtij lajmërimi nuk patën guximin e Emimit për të treguar shkaqet e vërteta të mbylljes së gazetës dhe për të goditur shkaktarët, por lexuesit e kuptuan mire se shkaktarët e vërtetë ishin shtypësit e lirisë dhe shfrytëzuesit e popullit.

Ndërkaq, vizita që bëri Emini në Napoli, tek një profesor ftiziatër i dëgjuar, tregoi se ishte tepër vonë për mjekim. Prandaj ai, pas disa ditësh, i përcjellë me dashuri nga studentët shqiptarë që ndodheshin në atë qytet, u nis për në Bari, me qëllim që të kthehej në atdhe ku, edhe po të vdiste, trupi i tij do të prehej në gjirin e tokës nënë, që aq shumë e deshi dhe për të cilën shkrua gjithë jetën e tij.

Me të arritur në Bari, Emini u shtrua në sanatorium, në pritje që të nisej. Mirëpo qeveria e Xhafer Ypit, me nxitjen e armikut të betuar të tij, Ahmet Zogut, ndonëse ai ndodhej në shtrat të vdekjes, i ndaloi hyrjen në Shqipëri, duke e quajtur «person të padëshiruar dhe të rrezikshëm».

Të revoltuar nga ky vendim, shokët e Emimit, në numrin e fundit të gazetës botuan në vend të «Tragëzave të mullinit», këtë shkrim prekës e demaskonjës satirik:

«E ngrata Shigjetë! (pseudonimi i Emimit sh.a.) — Duke u mundue të çajë udhën e qytetit Samble, aeroplani i ndeshi në nji erë të egër feudale e kështu, si u prish motori, ra këputas përdhe. Shigjeta asht dërmue keqas dhe vuen nga nji sëmundje e për-

brendshme. Doktorët i kanë dhanë peheris të randë, si agjënim ramazani, dhe sigurojnë se kur të vijë bajrami¹⁾ do të shofi gjithkush eles...».²⁾

I sëmurë rëndë, midis vështirësive të mëdha ekonomike, i përmalluar pér mëmëdheun, pér familjen dhe miqtë e tij, Emin Matraxhiu, nga fundi i marsit 1922, mbylli sytë përgjithmonë në Bari, në dhe të huaj. Por arkivoli me trupin e tij, mbuluar me flamurin kombëtar, u përcuall pér në banesën e fundit nga një numër i madh shqiptarësh, të larguar nga Shqipëria pér shkak të terrorist zogist, nga studentë shqiptarë dhe arbëreshë të Italisë, të cilët shikonin tek Emini patriotin e flaktë demokrat revolucionar, luftëtarin e paepur pér të drejtat e popullit dhe interesat e atdheut. Ata e kthyen vrrimin e tij në një manifestim të fuqishëm proteste kundër Ahmet Zogut dhe përkrahësve të tij.

Lajmi i hidhur i vdekjes së parakohshme, në moshën 32-vjeçare, të Emin Matraxhiut, pikëlloi thellë popullin e Elbasanit dhe gjithë patriotët përparimtarë, duke shtuar, në të njëjtën kohë, urrejtjen pér Ahmet Zogun dhe klikën e tij sundonjëse, të cilët e lanë këtë bir të denjë të popullit të mbyllte sytë larg atdheut të vet të dashur. Një emocion të veçantë ngjalli vdekja e tij në radhët e shtypit përparimtar shqiptar. Ja çfarë shkruante, ndër të tjera, me këtë rast, revista «Atdheu» e Vlorës:

«Muarëm vesht se drejtori i si vëllait tonë

1) Përmes fjalëve **ramazan** e **bajram**, në mënyrë alegorike goditet diktatura feudoborgjeze e Zogut dhe shprehet besimi se do të vijë dita që ajo do të përbysjet.

2) «Shkumbini», nr. 48, dt. 27 janar 1922.

«Shkumbini» Emin Matraxhiu, paska vdekur në Bari, ku kishte vajtur për t'u shëruar.

Me humbjen e parakohshme të këtij djaloshi tridhjetë vjeçar, i cili intelektin, talentin dhe atdhetarizmin e tij e kish treguar qartazi e me guxim në shtyllat e gazetës së vet, shtypi kombëtar ndahet nga një shok i dashur e i duhur...»¹⁾

Emin Matraxhiu vdiq, por krijimtaria e tij letrare publicistike mbeti dhe do të mbetet kurdoherë e pavdekshme, sepse ai futet në radhët e atyre autorëve për të cilët shoku Enver Hoxha ka thënë: «Këta kanë jetuar e krijuar në një periudhë tjeter, por veprat e tyre të bukura janë frymëzuar nga mendime dhe aspirata të mira, prandaj u kanë rezistuar kohërave, të këqiajve dhe kanë arritur të gjalla e të bukura deri në ditët tonas».²⁾

Partia dhe shoku Enver na mësojnë se e reja në kulturë, në letërsi dhe art, «nuk lind në vend të zbrazët. Ashtu si në natyrë edhe në shoqëri, çdo ndryshim cilësor nuk mund të ndodhë pa grumbullime sasiore»³⁾

Të nisur nga këto mësimë marksiste-leniniste, do të shohim se edhe në publicistikë e reja është rrjedhim logjik i zhvillimit dhe i pasurimit të pandërprerë të trashëgimisë letrare, i përpjekjeve të të gjithë gazetarëve tanë përparimtarë të së kaluarës, në radhët e të cilëve militoi me guxim edhe Emin Matraxhiu, për të pasqyruar me vërtetësi realitetin objektiv, vër të kontribuar pozitivisht në ndryshimin e tij.

1) Revista «Atdheu», nr 5, mars 1922.

2) Buletin i KQ të PPSH, numër 1, 1973, f. 34

3) E. Hoxha, Raporte e fjalime, 1967-1968, f. 480.

Shtypi ynë i ri popullor, i themeluar nga Partia dhe nga shoku Enver Hoxha, nuk lindi mbi një terren bosh, por mbi një bazë të shëndoshë, të përbërë nga trashëgimia dhe eksperienca e pasur e shtypit përparimtar shqiptar, mbi bazën e ndryshimit të dukshëm cilësor të këtij shtypi gjatë periudhës së fundit, pas krijimit të lëvizjes punëtore dhe komuniste në vendin tonë. Pikërisht, duke u bazuar në këtë trashëgimi revolucionare, Partia Komuniste e Shqipërisë, në zjarrin e luftës nacionalçirimitare, bëri hopin e ri cilësor, duke krijuar shtypin e një tipi të ri, shtypin marksist-leninist, si një mjet të fuqishëm, në duart e popullit, për çlirimin e tij kombëtar e shoqëror dhe, më vonë, për ndërtimin socialist të vendit, e për mbrojtjen e atdheut.

Partia ka porositur kurdoherë që shtypi ynë popullor të ruhet si në përmbajtje dhe në formë nga ndikimet e huaja. Ajo ka kërkuar që ky shtyp luftarak, boshti ideologjik i të cilit është marksizëm-leninizmi, të zhvillohet mbi tabanin kombëtar, të ketë dhe të forcojë gjithnjë e më shumë ftyrrën e tij shqiptare, të mbajë parasysh tiparet themelore të historisë së lavdishme të popullit tonë dhe psikologjinë që e karakterizon atë.

Në këtë drejtim një thesar i çmueshëm eksperience janë, në radhë të parë, traditat luftarake të shtypit ilegal të Partisë gjatë Luftës nacionalçirimitare si dhe trashëgimi i pasur i shtypit tonë përparimtar të së kaluarës, shfrytëzimi në përshtatje me kërkeshat e sotme, i çdo gjëje të mirë, të pastër dhe të vlefshme. Dhe në këtë fond të madh të publicistikës sonë kombëtare, përfshihet edhe

krijimtaria letrare, demokratike e revolucionare e publicistit të talentuar Emin Matraxhiut

Përmbajtja luftarake e shkrimeve të tij, stili i rrjedhshëm e kongiz, me fraza të shkurtëra, me gjuhë të pasur, të thjeshtë e të kuptueshme si dhe format e larmishme të përdorura nga ai, meritojnë një vëmendje të veçantë.

Kjo krijimtari na ndihmon për të njohur më mirë një periudhë të rëndësishme të së kaluarës së hidhur të vendit tonë, përpjekjet e rilindasve për liri e pavarësi dhe luftën e patriotëve përaparimtarë për ta vënë Shqipërinë dhe mendimin shoqëror e politik të popullit në rrugën e zhvillimit demokratik.

Vdekja e parakohshme e Emin Matraxhiut, kur talenti dhe aftësia e tij gazetareske ishte në lulëzim të plotë, ka qenë një humbje e rëndë për publicistikën tonë në përgjithësi dhe për atë të Elbasanit në veçanti. Por, më kot u nxitua Vërlaci, pas mbylljes së gazetës «Shkumbini» dhe vdekjes së drejtorisë të saj, të botonte gazeten reaksionare «Elbasani». Fryma demokratike revolucionare e përhapur nga Emini, për mes «Shkumbinit», mbeti e gjallë dhe pas vdekjes së tij. Vepra e këtij përfaqësuesi të krahut më të vendosur e më demokratik të publicistikës sonë, ku më parë kishin milituar Shahin Kolonja, Muço Qulli e Sali Nivica me shokë, u vazhdua nga bashkëpunëtori i tij i afërt Sali Çeka e të tjera. Publicistika përaparimtare e Elbasanit u zhvillua më tej me gazetat luftarake «Ura e Shkumbinit» dhe «Ku vemi».

Nën ndikimin e gjurmave të thella të «Tragëzave të mullinit», nëpër faqet e këtyre gazetave u hapën rubrika të reja satirike, siç ishin, «Andra

e përralla» dhe «Sqimet e plakës». Autorët e këtyre rubrikave fryshtoheshin, jo vetëm nga talenti, por edhe nga guximi dhe konseguenca e Emin Matraxhiut, në luftën kundër armiqëve të atdheut dhe të popullit.

Kur «Iriqi» (pseudonim i autorit të rubrikës «Andra e përralla», botuar në gazetën «Ura e Shkumbinit» sh.a.) kërcenohej, në Maj të vitit 1923, me masa represive nga klika sundonjëse feudo-borgjeze, ai kujton Emin Matraxhiun, «Shigjetën» e «Tragëzave të Mullinit», dhe merr kurajo prej tij të vazhdojë pa u përkulur luftën kundër bejlerëve çifligarë, e sidomos kundër Shefqet Vërlacit.

Ja çfarë shkruante «Iriqi», në formë alegorike, lidhur me këtë:

«Një palë ethe të vogla më kishin zanë, por shokët e miqtë, ishin ba merak e kishin thirr mje-kun. Pas 20 minutash, hyri në dhomë një zonjushë me një fytyrë jo edhe të huaj e të panjoftun.

«Jam doktoresha! Nuk më njeh?» — më tha dhe më dha dorën.

Nuk po bia më të, e, nuk po ja gjejsha emrin, megjithë që atë fytyrë e atë za e kishja pa e digjue se sa herë.

«Unë do të baj mjekimet e mia, e, ti, mendohu e kujtohu ta gjesh e ta përmendësh emrin tem» — tha ajo, dhe nisi të bajë shëkimet e studimet e zakonshme të doktorëve, duke shënuar pulsin (nabzin) e duke vue veshin në kraharor e në-për ijtë.

N'anën tjetër, unë po vrisje mendjen t'i kujtoje emnin doktoreshës së re. Si mbaroi shëkimet u ul në një karrige doktoresha, së cilës deshi t'i napë një cigare duhan një nga shokët, porse u për-

mbajt se ja priti një tjetër: «Nuk e pi duhanin zonjusha Shigjetë».

«A! Shigjeta! me të vërtetë ajo, vetë dorë!» — thashë unë dhe u qetësova. Me buzë në gaz, nisi ajo të thotë ç'kuptoi nga shëkimi: «Këto ethe, s'kanë rëndësi fare. Të kanë pasë ardh dhe nja dy herë ma parë. Një herë para 13 vjetëve dhe një herë vjet. Kjo hera e tretë nuk është me aq rrëmbim sa të parat. Mos mbaj gja të keqe në bark, ç'të kesh nxirre në shesh. Barna s'duhen fare. Pas kësaj here, s'ka me të dhamb kryet kurrë. Më beso, se jam doktoreshë praktike. Më patën ardh të gjitha në krye, e nga kjo, i njof mirë këto farë sëmunie. Mos e përtyp fjalën që duhet thanë, veçse ruhu nga era e ftohtë e Tiranës, se ajo ta acaron plagën e sëmundjes. Qe, këto janë mjeket e mia, lamtumirë» — tha, e u ngrit e iku.

Me të shpejtë u veshësh e dola nga shpija. Gjeta shoqin që merret me rrëfime andrash, dhe ja dëftova ngjarjen e sipërme. Shoqi më tha: «Bukur fort. Do të merresh në gjyq e do të dalësh i pafajshëm, sikurse të ka ngjajtë edhe herë të tjera; e, pastaj do të bahesh «Xhumari», si ata që thonë se po të shpëtojnë një herë nga kolera, nuk i ze ma ajo sëmundje».

Sa mirë!.....»¹⁾.

Emin Matraxhiu ka meritën e madhe që çau i pari rrugën e vështirë e plot pengesa, duke drejtuar të parën gazetë politike përparimtare, pas shpalljes së pavarësisë, në një qytet ku klasa e bejlerëve dhe e çifligarëve, e përfaqësuar nga krye-feudali Shefqet Vërlaci, përbënte një nga forcat

1) — «Ura e Shkumbinit» Nr. 8, dt. 19 Maj 1923

kryesore të reaksionit të brëndshëm, jo vetëm për qarkun e Elbasanit por edhe për gjithë vendin. Me këtë kundërshtar të fuqishëm u mat me guxim Emin Matraxhiu, pa përfillur rreziqet, me bindje të plotë se «kush mbjell erë, korr duhie», siç i paralajmëronte ai klikat sundonjëse feudoborgjeze.

Dhe nuk kaluan veçse dy dekada që ëndrra, aspirata dhe dëshira e tij për të parë popullin zot të vendit dhe të së ardhmes së vet u realizuan. Bile u tejkaluan në një masë që ai as mund ta përfytyronte në kohën kur jetoi dhe luftoi. Idetë ngadhënjimtare të Leninit, të cilat ai i çmonte, u përharën edhe në Shqipëri. Të kota qenë përpjekjet dhe terrori i klikës feudoborgjeze sundonjëse, me mbretin satrap Ahmet Zogollin në krye, për t'i prerë hovin përhapjes së këtyre ideve vdekje-prurëse për të. Të kota qenë edhe shpresat e kusilingëve si të Mustafa Krujës. Shefqet Vërlacit e të tjerë, që kullotnin në grazhdin e Romës, e që, duke shfrytëzuar politikën tradhëtare të dyerive të hapura të Zogut ndaj imberializmit italian, pre-gatitën okupacionin fashist të 7 prillit 1939, jo vetëm nër të plotësuar ambiciet e tyre për pushtet, no edhe aë, me ndihmën e pëdronit të tyre, fashizmit italian, të zhduknin lëvizjen e grupeve komuniste.

Idetë e Leninit ishin të pamposhtura. Mbi bazën e lëvizjes komuniste, të krijuar dhe të zhvilluar pas revolucionit demokratiko-borgjez të qershorit 1924, më 8 Nëendor 1941, lindi «ai vll. që do të ndriconte së afërmi Shqipërinë», për të cilin bënte aluzion, ndonëse pa e kuptuar ende plotësisht, Emin Matraxhiu në «Tragëzat e Mullinit», u themelua Partia Komuniste Shqiptare, me shokun Enver Hoxha

në krye, e cila, duke bërë që idetë e marksizëm-leninizmit të përvetësoheshin nga masat, i ktheu ato në një forcë të madhe materiale. E mbështetur në këtë forcë, Partia, kjo udhëheqje e parë revolucionare e besnike deri në fund që nxori populli nga gjiri i vet, mori përsipër detyrën e rëndë e plot përgjegjësi për të organizuar dhe për të udhëhequr Luftën nacionalçirimitare, epopenë më të madhe që ka njojur historia e Shqipërisë, në të cilën edhe populli i vendlindjes së Emrit, siç ka thënë shoku Enver Hoxha, «i ka dhënë Shqipërisë trima dhe heronj».

Edhe kësaj here, si gjithëmonë, popullin tonë u përpoqën ta pengonin shërbëtorët e të huajve, Shefqet Vërlacët e Mustafa Krujët. Dervish Bækët e Mehdi Frashërit, ata që Emin Matraxhiu me pushkën dhe pendën e vet i kishte luftuar deri në çastin e fundit të jetës.

«Ne e dinim — ka thënë shoku Enver Hoxha — se populli shqiptar, që kish vuajtur shekuj me radhë, do të haste në rrugën e tij edhe armiq të brendshëm. Cilët ishin këta armiq? Këta armiq ishin bejlerët e pashallarët si Shefqet Vërlaci, Ibrahim Biçaku, e të tjerrë, të cilët u lidhën kokë e këmbë për të shpëtuar çifliqet e tyre që ishin në rrezik. se populli do të ngrihei. se populli do të udhëhiqej nga një parti e fortë».¹⁾

Ishë pikërisht kjo luftë, ky revolucion i gjerë popullor, i udhëhequr nga Partia Komuniste, i cili, si një uragan i fuqishëm, përlau tok me pushtuesit fashistë italianë e gjermanë edhe veglat e tyre, klasat sundonjëse feudoborgjeze, duke i sjellë popullit lirinë e vërtetë kombëtare e shqipërore dhe du-

1) E. Hoxha, vepra, vëllim IV, f. 296.

ke e vënë Shqipërinë e re në rrugën e ndërtimit socialist.

Në Luftën heroike nacionalçirimtare dhe, pas triumfit të saj, në betejën jo më pak të vështirë e të lavdishme të ndërtimit socialist e të mbrojtjes së atdheut, duke patur si busull drejtuese të pagabueshme ideologjinë e proletariatit, doktrinën shkencore të marksizëm-leninizmit, Partia u mbështet dhe mbështetet mbi energjinë revolucionare dhe traditat e mëdha luftarake të masave populllore, të grumbulluara përmes qindra vjet luftrash të ashpra kundër shtypjes kombëtare e klasore, tradita që ajo i ruan dhe i zhvillon gjithnjë e më shumë.

Në këtë kuadër nuk mund të mos meritojnë respektin dhe mirënjojen e Partisë dhe të popullit edhe pionierët e shtypit tonë përparimtar revolucionar të së kaluarës, në radhët e të cilëve militoi edhe Emin Matraxhiu. Si bij të kohës së vet, tek krijimtaria e tyre, krahas anëve pozitive, ne hasim edhe anë negative, lloj-lloj iluzionesh, kufizimesh ideore dhe kontradiktash, por këto janë të meta, që, duke i vështruar me syrin e kritikës sönüne dialektike marksiste-leniniste, nuk e ulin aspak meritën e tyre të madhe që në kushte shumë të vështira për atdheun, me idetë e tyre iluministe revolucionare, shprehën dhe mbrojtën aspiratat më të ndritura të popullit tonë, besuan pa lë-kundje e plot optimizëm në triumfin e çështjes së tij të drejtë, ndezën në zemrat e vegjëlisë patriotizmin e flaktë dhe i ndriçuan Shqipërisë rrugën e përparimit dhe të zhvillimit demokratik.

Pikërisht për këto merita të mëdha, në shenjë respekti dhe mirënjojeje ndaj militantëve të shquar të shtypit tonë përparimtar, në përgjithësi, dhe

ndaj Emin Matraxhiut në veçanti, gazetës lokale, organit të Komitetit të Partisë të rrethit të Elbasanit, iu dha emri «Shkumbini», emri i gazetës pioniere të shtypit përparimtar në Elbasan, të drejtuar nga Emini.

Në faqet e «Shkumbinit» të ri të Partisë, nuk traitohen më problemt që traitonte «Shkumbini» i vjetër, por ruhen dhe zhvillohen traditat luftarakë të tij.

Për «Shkumbinin» e sotëm nuk është më problem shtypja, shfrytëzimi dhe veprimtaria kriminale e ish-klasave feudoborgjeze, sepsë këto klasa populli i hoqi me kohë nga fuqia dhe u dha dënimin e merituar. Por, ai lufton për zhdukjen e mbeturinave që shoqëria e sotme trashëgon nga shoqëria e vjetër obskurantiste e këtyre klasave, lufton për edukimin e njeriut tonë të ri me normat e moralit socialist, për mobilizimin e ndërgjegjshëm të masave punonjëse të rrethit të Elbasanit në frontin e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, në kushtet e luftës kundër presionit të rrethimit imperialisto-revisionist të vendit tonë.

Ndryshe nga «Shkumbini» i vjetër, që trajtonte probleme që ishin plagë të shoqërisë së asaj kohe, që shkruante për shtëpi përdhese plot lagështi, për kanale ujërash të ndyra midis qytetit të Elbasanit, për varférinë, padjen e mierimin që mbretëronte në këtë qytet, e sidomos fshatrave të tii, «Shkumbini» i ri jep në çdo numër njoftime për suksese të reja, gjithnjë e më të mëdha, të punonjësve të këtij rrethi. Nga faqet e kësaj gazete lexoni ësni mëson për fshatin e ri kooperativist të elektrifikuar, që po lulëzon çdo ditë e më shumë, për shtëpi të reja e komode, që ndërtohen në fshatrat e kë-

tij rrëthi, për shkolla, vatra e shtëpi kulture, spitalë e ambulanca, për ndërtime të reja madhëشتore në qytetin e ri e të bukur të Elbasanit, përvlerësimin që i bën Partia së kaluarës, së sotmes e së ardhmes së rrëthit të Elbasanit, ku ngrihet madhështor gjiganti i metalurgjisë sonë të zezë.

Emin Matraxhiu nuk jetoi për të parë këtë transformim të pashembullt të vendlindjes së tij dhe të gjithë Shqipërisë, që u bë e po bëhet nën udhëheqjen e Partisë e të shokut Enver dhe në saje të punës vetëmohuese të masave punonjëse. Por populli ynë, i edukuar nga Partia, e ka të qartë se edhe vepra iluministe e rilindasve dhe e demokratëve tanë revolucionarë, në radhët e të cilëve bënte pjesë edhe Emini, ndihmoi në pregatitjen e kushteve të favorshme për krijimin e lëvizjes punëtore e komuniste shqiptare, nga gjiri i së cilës lindi një udhëheqje e aftë e besnike deri në fund i interesave të saj, siç ishte Partia Komuniste, sot Partia e Punës.

Populli ynë është plotësisht i ndërgjegjshëm se fitoret e gjithanshme kolosale që ka arritur dhe po arrin, nën udhëheqjen e Partisë me shokun Enver Hoxha në krye, autoriteti dhe prestigji i madh ndërkombetar i Shqipërisë së re socialistë, roli i saj vendimtar si fener i kuq ndricues i socialistëve i komunizmit në Evropë e në botë, lufta parimore kundër imperializmit e revisionizmit, fitore këto të cilat teikaluan edhe èndrrat më të gjuhimshme të rilindasve dhe të patriotëve tanë të shqiptar demokratë revolucionarë, janë shpërbërimi më i madh rëndë vorën frjmëzuese të këtyre militantëve përparimtarë, vepër që mbetet një pasuri e çmuar për brezat e sotëm dhe pasardhës.

FRAGMENTE NGA SHKRIMET SATIRIKE TË EMIN MATRAXHIUT

KANDIDATURA

«S'do më ndezi, si po duket, që të dal deputet nga anë e Elbasanit, e më rruat programa e bukur që shpalla, ma keq se Filip Poda!... Por nuk asht për t'u dëshprue se asht zakoni i keq i kësaj bote, që njerëzvet të mëdhenj, nuk u qmohet në vend të tyne vlera që kanë e nuk nderohen ashtu si lypset sa janë gjallë...

Por unë s'mërzitem, se jam nji patriot i madh, e madhënине teme kam me e shfaqë kurdoherë, duke lypë punë të mëdha, e kështu sot, i shtymë prej patriotizmës që t'i ve themelë të shëndosha shtetit shqiptar, po shpall kandidaturën teme për Guvernator të Përgjithshëm të Shqipnisë së Jugut me këto kushte:

1) Porsa të zgjidhem, mbasi jam nga vendlindja e Efrem Gjinit (agjent i peshkopit Jakov nga Elbasani, banues në Korçë sh.a), do të përpinqem që administrata e vecantë e të dy prefekturavet të zgjanohet në nji mënyrë që nga Veriu të zajë bu-

zën e Shkumbinit e nga Jugu të shtrihet deri në detin Jon, pér t'i vu Shqipnisë themele të forta, ashtu sikur andërronte dhe vetë i ndjeri kur jetonte!..

2) Mësimet i kam mbarue në universitetin e Oxfordit dhe di shumë gjuhëna, por ma tepër atë të Homerit e Sokratit. Por fatkeqësisht se diploma e shkretë më ka humbun ma keq se z.z. Kotes e Rodhes.

3) Në qoftë se unë do të bahem fitues i kësaj selie pér shpëtimin e kombit, do të përpinqem që nëpër nepunsina të shtetit elementi i krishtenë të zani 99% dhe nji qindarkë që t'u mbetet muhamedanëvet, le ta blejnë shkrepse!..

4) Do zoti kurrë s'më ka shkelun kamba nga Azia, e kështu jam i kulluem nga mikrobet e Orientit, por veç se më vëlqejnë fiqjtë e rruashëtë e thattë të vendlindjes (Izmir) të shenjtënise së tija (Jakovit), se janë pa bërtama e përtypen shpejt. S'mund ta mëcef dot, se disa herë kam hangër kësish!..

5) Nuk më pëlqen të thirren organizatorë nga Veriu i Evropës, kur kemi të Jugës që janë ma të shtëpisë... .

6) Pér të më shkue puna mbarë kam pér të shkue mbramje e mëngjes ke shenjtinia e tija, që t'i marr uratën e mësimet e... duhura!... pér 'bashkimin kombëtar.

7) Çështja e arësimit më vjen mirë që të vijë në atë sistem oksidental, q'asht tue u praktikue në Korçë, d.m.th. shkollat e të dy tëlementeve të janë veç e vec.

8) Porsa të bahem Guvernator i Përgjithëshëm pér shpëtimin e kombit e pér lulëzimin e

atdheut, do të emëroj z. Koço Koten, për president të Këshillës Departamentale, z. Kol Rodhen, për drejtor gjeneral të qetsisë, z. Euklidhin për drejtor të përgjithshëm të Drejtësisë, z.z Orolloganë e Lukerin të Industrisë... etj.

9) Do të përpinqem që këtë farë administratë, që do të shëndrisi Jugën, ta marri dhe Mesi edhe Veriu i Shqipnisë, sikurse ka ba Prusia Gjermane në kohën e Bismarkut... e Jugosllavia në ditët e sotme.

10) Më pëlqen që qendra të ngrihet në Boboshticë, se atje ndodhet... (raki sh.a.) e manavet pik të parë, që të ndez gjithnjë ndjenjat patriotike...

Kjo asht programa ime q'i ve themelë të shëndosha Shqipnisë, e kur të ma bajë zoti kismet atë të manavet të Boboshticës, atëhere do t'a them kangës:

*Atje poshtë në Kapshtic
Rrinte lepuri në bisht
Dhe kuvendonte greqisht!..»*

Shigjeta

(«*Shkumbini*», nr. 8, dt. 4 mars 1921)

Në këtë panflet, autori demaskon peshkopin Jakov dhe disa elementë grekomani, duke zbuluar para lexonjësve, me një mjeshtëri të rrallë artistike, manevrat dhe komplotet e tyre djallëzore për krijimin e një administratë autonome për dy prefekturat e Shqipërisë Jugore: Korçën dhe Gjirokastër, të cilat ëndërronin t'i gllabëronin shovinistët e «megali idesë».

SHTETRRETHIMI

«... Ç'llahtari kam hekun, sa qi dhe sot kur e kujtoj më dridhet misht.

Ishjem tyke shkue nga drithnat, kur nji te-neqexhi prapa më lshon za: «Zotni, Zotni!». «E mër, ç'dreqin ke?» u ktheva e i thashë. «Më fal — më tha — se do të pyes nji fjalë në kambë; mos do shpallet shteti i rrëthimit ktu?» «Ne unë ashtu e kam ndi, — i thashë. — «Ej shyqyr, më tha, mos shes ne unë ndonji fener se më mbetën batall të shkretët».

Sa dola matanë, hasa dy miq që kishin nga nji palë opinga në dorë. «Ç'i doni kto opinga? — u thashë. — «Mër po jemi tyke ndigjue se do të shpallet shteti i rrëthimif, — më thanë, — e i blemë qi t'i kemi gati se mos e bjeri puna qi t'ikim».

Kur dola në Leshnat, pashë nji trumë burra qi po ikshin nga Namazgjaja. Natyrisht u bana merak e e pyta njanin. «Ku shkoni kshtu?» «Pc shkojmë në Namazgjah, — më tha, — se do të kërkojmë shtetin e rrëthimit».

... me nji trishtim të madh u rashë kambë-vet që t'iki e të shkoj në shtëpi. Kur mbërrina në Qoshet, bani ballë tellalli edhe filloi me thirrë me nji za të përvajshëm:

«Urdhni i qeverisë qysh sot shpallet shteti

i rrëthimit! Tregu do të mbylljet përnjiherë me akshamin! Dy vetë bashkë mos fjalosen! Natën njeri pa fener të mos dali», etj.

O, uh! thashë me veten time, ç'më gjeti kshtu! Bana ma tytje, që të za portën e shtëpisë, veç kur nji za nga prapa më thirri. Ktheva krytë, po ç'të shofish, një polic i vrajtun ma priti: «Ec përpara zotni, të shkojmë në polici». «Pse zotni, — i thashë, — ç'kam bamë?» Çfarë fole ashtu me vëtëhet?» më tha. «Po urdhni asht mos me u fjalue me të tjerët», iu përgjigja. «Mirë, po pse më shikon shtremët, — më tha polici me zemërim, unë të di ç'hain je ti, ec përpara, mos e tepro, se të kam në tefterë».

Për çudi, polici nuk di pse nuk më ktheu ma në polici, po më çoi drejt në burgut. Të burgosunit posa më panë më njoftën e për me më nderue më liruen vendin ku pata ndejun në kohë të Durgutit e të rebelëvet. Pas pak zunë me ardhë edhe shokë të tjerë. Unë ishja bamë qullë në djersë!..

Trishtimi mbretnonte!.. Elbasani nxinte!.. Kur, desh zoti, u qush nga lemeria edhe e kuptova që kishjem qenë andërr».

Shigjeta

'«Shkumbini», nr. 10, dt. 18 mars 1921)

Me këtë shkrim satirik Emin Matraxhiu demaskon autoritetet qeveritare, të cilat gjatë fushatës së zgjedhjeve shpallën shtetrrethimin në Elbasan, që t'u jepnin mundësi agjentëve të tyre të venin shtëpi më shtëpi për të siguruar, ku me forcë, ku me mashtrim a ryshfet, vota për kandidatët bejlerë e zengjinë, dhe, në të njëjtën kohë, vë në dukje persekuimin që u bëhej patriotëve përparimtarë.

BISEDIM NË TELEFON

«— Alo, central Tirana, a erdhi zotni këshilltar i ministrisë?..

- Po, zotni, këtu jam, po kush je zotnia jote?
- Unë jam, jam Shigjeta, ai që kemi luejtë bashkë tavëll e bilardo.
- Gëzohem, po si je zotnjote?
- Do zoti, si ma mirë, por zotninë tuej e z. ministër qysh ju kazn.
- Ah, mos na pyet! Si unë si z. ministër, si z. kryeministër, jemi në ditë të pikës!
- Qoftë e shkueme, a keni qenë sëmunët!?
- Jo, vëlla, por jemi në hall të madh, si nxanësit në ditët e provimevet, bile ma zi!
- Pse? Po zotnia e jote dini shqip mirë, ç'asht ky provim?
- Jo... provimi ynë do të jetë përpara parlamentit, pér punët e veprat e deritashme!..
- Përse dëshprohe kaqë? Ky hall mbylltet me nji fjalë të bukur e me nji program të shkëlqye-shëm të kryeministrat, si kur u ba në senatin e parë... Fundi, ore, lumëmadh, mos i fut kaqë hallë vetes, se në rantë kabineti, a nuk e di se këshilltarët e drejtorat e përgjithshëm i mbajnë vendet e tyne, se i kanë marrë me tapi?..

— Ashtu asht, si urdhëron, por na vjen keq se u mësuem me këta!..

— S'ka dert, po ç'kemi nonji të re, të lutem?

— Farësendi, vegse Drejtori i Përgjithshëm i Bujqësisë na ka humbë buxhetin e ri, tashi po vra-sim veten të bajmë nji tjetër!

— Mos u lodhni aq, ju lutem, se s'ka nevojë Shqipnia për bujqësi! Ç'na lypsen neve këto? Po, z. këshilltar, due të lutem për nji gja:

Në organizimin e ri, tim vëllai, qì asht nëpunës i Zyrës... në vend që t'i epshin hakun, i kanë ba-hatan, se i kanë pre 60 franga nga rroga qì kish, e ajo veç qì i prish buxhetin atij por s'asht mirë ene për Shqipninë! Të them të drejtën, Shqipnia s'ba-het kshtu!.. jo se due t'i mbaj pajë (krahun sh.a.), se e kam vëlla, por atë e njofin të gjithë... Ka qenë paj-timtar në «Lirinë» e Selanikut. Kalendarët e Kristo Luarasit i mban edhe sot hajmali. Londra vërtetoi indipendencën e Shqipnisë, por ai qëndroi ene tre vjet në Turqi, se nuk besonte... Si erdhi këtu, po shërbente me kënaqësi, se merrte 300 franga ar, qì as në andërr s'i kishte pa! Shqipen e di aq mirë sa qì kur hedh nënshkrimin, ene atë lypset qì ta këndoje po vetë! Nga punët e shumta qì ka nuk i del kohë të pijë ma se 50 cigare në zyrë... Prandaj i duhet ene ndonji protokollist!.. Ka qëllime të mira për Shqip-ninë, qì e do si sytë e ballit!.. Si të mbarojë bashki-mi i shoqënivet, ka me vu ndër mend të bahet anëtar i «Vatrës» së Shqipnisë!.. Me pak fjalë, ky asht jetëshkrimi i tij, prandaj po deshët ta bani Shqip-ninë si e do ai, mos ia hani hakun.

— Mos ki dert se tashti shkoj ta mbaroj këtë punë, por ç'dëshiron tjetër?

— Farësendi, falem ndërës, e mirë u pafshim».

Shigjeta

(«*Shkumbini*», nr. 13 dt. 8 prill 1921)

Ky shkrim, i botuar në pragun e hapjes së parlamentit, vë në lojë qeverinë e Iliaz Vrionit dhe aparatin e saj të korruptuar, moskokëçarjen e kësaj qeverie për bujqësinë, nëpunësit injorantë anadollakë, që zinin vende me përgjegjësi, si dhe shoqërinë «Vatra», që nuk i përgjigjej thirrjes për bashkimin e të gjitha shoqërive në Federatën Kom-bëtare «Atdheu», themeluar në Kongresin e Vlorës nga Avni Rustemi.

NJI VIZITË NË KRYEQYTET

«Udha Elbasan-Tiranë asht nji nga ato ma të kandshmet të Shqipnisë, që natyra, me bukurinat e veta, e ka hieshuem për së teprit. Mirëpo para se të niset udhëtari i ngratë për këtë udhë, nuk ban mirë në qoftë se s'hallalloset me gjindt e vet; sepse me qilluem demek që t'i rrëshqasi rrota e trenit ekspres të kompanisë së Shim Stafës, i mjeri ka m'u gjindë menjicherë pa frysë përpjosh Shkambit të korbit e s'ka me u kthye gjallë në shtëpi të tija! Ah, po kiameti bahet përmësikurse të qillojë e të pësojë nji rreziku ndonjë deputet që përfaqëson njëmillion shqiptarë! A thue se s'kanë sy vetë këta që nuk përkujdesen makari përmjetën e tyne? Po, pardon, harrova se çdo punë bahet javash-javash!..

Mbas nji dite udhëtimi plot me frikë, mbërrina ma në fund në kryeqytet...

C'kam ndi e ç'kam pa në qeveri shqiptare nuk do të baj za fare, se kam frikë mos më hasi sharra në gozhdë...

Me rast të çeljes së parlamentit, nji gja i hiqte vërejtjen njeriut, se në disa qarqe diplomatike (!) çdo minutë ngrifeshin e shkrifeshin me dyzina kabinetesh...

Por gjaja ma e çuditshme që më ka baftun në kryeqytet, asht fjalimi që kam ba nji natë në gjumë

me Esat Pashën! Fytyra e vrajtun e tija diftente cil-tas dufin e dëshpërimin e madh që kishte, ke shifte në vend të flamurit me yllë të bardhë flamurin kombëtar kuq e zi.

Automobilat, qi shkojshin e vijshin me ministrat tanë, i baheshin sikur ecshin mbi kurriz të tija, sepse i kujtohesh vehtja qi dikur edhe ai vetë kishte genë ministër i punëve të mbrendshme e i luftës, e kishte bredhun me to!.. Tyke pa lëvizjen e anës së Drinit e fjalëkëmbimet e tjetër kujt me Jugosllavini, Esadit i vinte të shkulte flokt e krejt!.. Hoqi nji ah, të thellë e plot shamtinë e m'u kthye e më tha: «Sa shpejt kobohi ju shqiptarët! Keni gëzim se ia shkulët vërtet plakës Shqipni nji dhëmballë, qi s'e linte të përqapesh, por hapni sytë e kini kujdes se mos i dalë nonji stërdhamb tjetër e e mundon matepër»

Kur ndigjova këto fjalë, shtanga aq tepër, sa s'mufta me iu përgjegjë Esadit, por qysh m'atë natë s'di pse më ka zanë frika?!!»

Shigjeta

(«Shkumbini», nr. 14, dt. 15 prill 1921)

Me këtë shkrim Emin Matraxhiu godet qeveritarët e kohës për prapambetjen e vendit, tallet me burrat e shtetit dhe deputetët feudalë, që e quanin vehten «përfaqësues» të popullit, fshikallon qeverinë reaksionare të Iliaz Vrionit për censurën e shtypit, deputetët që ishin në ethe për kulltuk në prag të hapjes së parlamentit dhe, përmes bisedës në ëndërr me Esadin e vrarë, godet tradhëtin e tij si dhe të agjentit tjetër të rrezikshëm të Jugosllavisë, Marka Gjonit, duke paralajmëruar edhe për «stërdhambin» e rrezikshëm që kishte filluar të delte në skenë, në gjurmët e Esadit, Ahmet Zogun.

U ÇEL PARLAMENTI

«Ngjan se dje asht hapun i pari parlament shqiptar, sado qi s'ka ndonji lajm zyrtar prej së vlefshmes (?) drejtori të shtypit?!

S'ka dyshim se njime gjisekush vret mendjen e tij tyke pritë e tyke pyetë se... çar fati e pret Kabinetin Virion... Ç'i u desh atij ajo ligjë e zgjedhjet që nuk i gjindet shembulla as në Francë?! Ç'i u desh atij që t'i japi të drejtë votimi ene foshnjavet të djepit!... Ç'i duhesh atij t'i rrrijë nalt, porsi Nas-tradini, nji dege që do t'u priste?!

Por «gaz' i madh kur të bijnë qepët», thotë nji proverbë shqipe, se në Shqipni vijnë deputetë ene prej kolonish!..

Mirë se do të na lajë Iljaz Beu, por kush do të jetë ai gjeni (dahi) që t'ia pranojë propozimet e randa e ndërhyrjet e tija Këshillit të Naltë e të formojë kabinetin e ri? Por në qoftë se ky ta shkeli zakonin (!) e nderuem prej dy kryeministrash të tjerë, e kundra vullnetit të Këshillit të Naltë, të fusi në kabinet të vet anëtarë të këshillave ministeriale të Durrësit-Tiranës?

Po Këshilli Kombëtar s'qendrim vallë ka për të marrë faqe këtyne lodrave? S'dihet!..

Mirëpo Këshilli Kombëtar... ka për t'i mbajtë sytë mbyllun faqe ndërhyrjeve e të përzimevet që thotë populli se ka ba qeveria e disa pjesëtarë të shtetit në zgjedhjet? Vallë qysh do ta kapërxejë Iljaz Beu këtë lum pa urë?

Ashq e vështirë që ta zash në kurth qeverinë për këtë gja...».

Shigjeta

(«*Shkumbini*», nr. 15, dt. 22 prill 1921)

A N D E R R

«Posa kisha dalun prej parlamentit e, si hangra drekën, shkova në Hotel e u shtriva mbi shtratin tem që të shplodhesha. Tyke ra nér mendime gjumi më kishte largue prej kësaj bote, e, si i humbun q'isha, m'u ba sikur po thërriste nji za tellalli. «Ej!.. ndigjoni këtu... mbasi nuk kanë mërri ende 80 sandalliet e parlamentit që pat porositë qeveria, e mbasi të zotënët po i kërkojnë ato që ndodhen sot, kryesia e parlamentit ka vu në paksim 80 sandallie deputetësh, në mënyrë që kambët e tyne të jenë me vida, për t'u mbërthyte me dyshemenë, se, ruejna zot, mos iu nxehet gjaku si ditën e parë disa deputetëve të rij e mos bajnë ndonji hata shoq me shoq... Asht vu në paksim ene nji varëse për t'u vu bastunat e verdhë e kësulat, në mënyrë që kjo të ketë nji zile e po që që të hyjnë deputetët si ditën e parë me bastunet në parlament, zilja të bjerë vetë (!) e t'i lajmërojë ata se parlamenti nuk asht han apo hotel!..

Kryesia e parlamentit ka vu në paksim ene këto nëpunsina pa kërkue për to zotësi dhe karakter, por vetëm për nën qoftë se dalin prej sish, të venë e të shërbejnë nji motmot rrjesht si krahinarë, kudo që t'i çojë qeveria:

Nji kryeministër me rrogë muejore fr. ari 1200.

Pesë ministra me rrogë muejore gjithsecili fr. arri 1000.

Gjithë kjo kryesi ka vu në ankand 18 bezhje... të deputetvet, me kusht që blerësit s'kanë të drejtë t'i përdorin këto titulla mbrenda e jashtë parlamentit, mbas propozimit të deputetit të Elbasanit (Shefqet Vërlacit sh.a.).

Por mos u koboni, se kjo nuk do me thanë se mbas këndejej bejlerët do të bajnë vllazni e krushqi me opingat!.. (me vegjelinë sh.a.). Pra... kush të dojë... sa të dojë... le të paguejë, veç silluni drejtimit komisionarit të tyne në Tiranë, i cili me dëshirën e kryetarit të parlamentit asht:

Shigjeta».

(«*Shkumbini*», nr. 16, dt. 29 prill 1921.).

KOPSHTARI DHE NASTRADINI

«Mbas tetë vjetëve të vetqeverimit të Shqipnisë, falë i qoftë zotit, ia mbërrimë ditës së lume (!) qì të hapet i pari parlament i ligjshëm, i përba prej burrash të zotët (!) idealista (!), pa farë dëshirë për kulltuk! E kjo po na i shton shpresat ene ma tepër për pritmen e shkëlqyeshme të Atdheut tonë! Përvërtetimin e kësaj pune ka sa e sa prova, por unë po rrjeshtoj vetëm disa: qysh ditën qì u hapë parlementi e deri sot u banë dy javë qì deputetët s'kanë ba gja tjetër veçse kanë përpjekë shuplakat?! Pse nuk kanë mbarue makari shqyrtimin e mandatevet të tyne? Apo për arësy se gjithsekujt nuk i pëlqen me u gjindë në parlament ndonji kundërshtar? Mbassandaj mendimet në parlament shfaqen si ma së mirë (!) se grupet prefekturiale veprojnë veças, ene ajo parti popullore, qì asht përba e ka mbledhë në gji të sajë tyrli mendimesh, s'ka muftun kurrsesi me i afrue e me i bashkue anëtarët e vet në interes të vendit. Republikanët (!) e dikurshëm të kthyem prej principesh të tyne tyke u ba regalista (?), aristokratët demokratë! nationalistët (!) progresistë (!), të dje-gun për nji copë kulltuk!, a nuk i apin këtij populli fatzi dorën ndihmëse për shpresë, shpëtim e gjallni!? Përgjegjësia qì do me krijue mbaskëndej Partia Po-

pullore pér këshillat ministeriale, të thirrunit në gjyq përpara nji areopagu kombëtar të kabinetevet të Turhan Pashës, Sulejman Delvinës e të Iliaz beut, a nuk dëshmojnë pér sa thamë ma sipër?

Ndofta disa munden të thonë se këto tre kryeministra s'kanë farë vështirësie me iu përgjegjun gjithsekujt pér çfarëdo pyetje, sepse e dijnë mirë si iu përgjegj Nastradini nji kopshtari që e zu mbrenda në kopsht tyke marrë lakna... Kur e pyeti kopshtari Nastradinin, ç'kishte dashun mbrenda në kopshtin e tij, ky iu përgjegj se nji erë e madhe që kishte frye me vrull e kishte ngritë këtë, s'di se prej nga, ene e kishte përplasë në atë kopsht. Kur e pyeti se kush ia kishte shkulun ato lakna, Nastradini i tha se tyke u mbajtë nëpër to prej frikës ishin shkulun vetiu, e kur e pyeti se kush i kishte futun laknat mbrenda në thes, Nastradini iu përgjegj: «ene unë pér atë gja po e vras mendjen e nuk po mundem ta kuptoj».

Shigjeta

(«*Shkumbini*», nr. 17, dt. 6 maj 1921)

K O L E R A

«...Njime vera na pllakosi dhe të nxehtit po shtohet për ditë ma tepër, e ndofta ka arësyen ndokush në thantë se mbaskëndej flakurinat... shuplakat do të kërcasin nga të mund... mbase edhe mbrenda në par.... (parlament, sh.a.).

Ka edhe ma keq, se të nxehtit e verës asht shumë ma i rrezikshëm sidomos për sëmundjet ngjitëse, se i shton, i përhap e i trash...

Mjerisht ka shumë njerëz, për çudi edhe mjekë, qi sot gjëzohen tyke kujtuem se nuk ka ba ballë ndonjë mikrob kolere! Duhet m'u ditë se mikrobet e kolerës nuk janë nji dore e një sistemi, ato janë gjithfarësh. Vini re, e mos u trembni, ju lutem, se nji mik i em, tyke pa me mikroskop, ka gjetë edhe sot mikrobe kolere qi kanë dalë për fushe e kanë marrë dheun. Se bie fjala, thotë ai:

Kolerë për Evropën asht Lenini.

Kolerë për esadistët asht mbrojtja kombëtare.

Kolerë për Jakovin asht Fan Noli.

Kolerë për qeverinë asht parlamenti.

Kolerë për shtypin asht qeveria.
Kolerë për mue asht gjyqi».

Shigjeta

(«*Shkumbini*», nr. 21, dt. 3 qershori 1921)

Këtu autori vë në dukje me alegori frikën e madhe të Evropës kapitaliste nga përhapja e ideve ngadhënjimtare të Leninit, pas triumfit të Revolucionit socialist të Tetorit, ide këto, vdekjeprurëse për kapitalizmin kur përvehtësohen nga masat.

K A N U N I

«Se si ra fjala nji ditë me nji advokat në zyrë të tija pér kanunin, e më tha:

— Kanuni asht dorë e hekurt pér qetësinë e përgjithshme, asht ma i madhi mbrojtës i të drejtave të njerëzisë, asht shtyllë e shëndoshë e nderit, asht maqinë e edukacionit, asht dëshmues i gjallë i lirisë e i njisisë së vërtetë, asht e vetmja fuqi që mbështetet e rrotullohet nji qeveri, asht burim i lumnisë së popujve, asht mjeku ma i mirë pér shërimin e plagëve të këqija.

Kanuni, kur nuk asht mbas zakoneve të vendit (si ai i Turqisë), mbetet si farë e pabimë, kur nuk ngop shpirtin njerzuer, asht si nji dru që nuk lshon pemë.

Kanuni asht nji pér të gjithë.

— Jo, jo, mos e thuej atë fjalë, z. advokat — ia priti menjiherë nji zotni që ndodhesh kushedi pér ç'punë — në zyrë të advokatit, — se në Shqipni kanuni ndërron shumë herë sipas njerëzve e vendevet! Pér shembull — shtoi zotnia — kanuni në Tiranë ka dënue dy vetë, por kanuni në Prezë (*krahinë e Tiranës*) këta (Zan Xhaferi e Xhemal Xhaferi), i mban gjendarmë! Kanuni pér të gjithë nuk asht nji, se ministrat e deputetët janë ma të naltë se kanuni.

Kanuni në Shqipni sun e dënojë kurrë nji deputet qì rref kryeplakun e muhallës (Abdulla bej) mun në mest të kryeqytetit! Kanuni sun ua çeli kurrë valiqat ministrave (z. Xhafer Ypit) e deputetvet, sado qì zyra e doganës së Durrësit do të bajë detyrën e saj sipas kanunit, sepse kryeministri, mbasi asht ma i naltë se kanuni, telegrafon të mos çilen etj!..

Unë, tyke i pre fjalën zotnisë pyeta advokatin a ka shteti shqiptar nji kanun të vetin? Z. advokat, si vuni kryet ndërmjet duersh e u mendue pak, m'u përgjegj. Për këtë mundesh të pyesësh Hoxha Kadrinë! (kryetar i Partisë «Përparimtare» dhe nën-kryetar i parlamentit sh.a.).»

Shigjeta

(«*Shkumbini*», nr. 25, dt. 1 korrik 1921)

MENTALITETI

«...M'atëhere kur Shqipnia ishte provincë e Turqisë, bie e vdes kadiu i Peqinit. Mudiri (krahinari) i Peqinit i shkruen Abdulla Pashës, mytesarifit (sundimtarit) të Elbasanit për t'i çue nji kadi (gjykatës) tjetër në vend të atij që ish. Abdulla Pasha thërret nji mikun e vet, i cili s'dinte farësendi, edhe e urdhëron të shkojë. Ai i lutet të dërgojë nji tjetër, se s'munt ta bante kurrsesi atë punë. Abdulla Pasha ngul kambë edhe e mëson që për çdo çashtje të kërkojë dëshmues (shahit). Ngrihet i mjeri dhe shkon në Peqin, dhe sa sosi, mudiri i bani nji vizitë, dhe mbas dy orësh çoi e thirri për darkë me anë të shërbëtorit. Kur i thotë shërbëtori: Të ban të fala mudiri të urdhënosh sonte për darkë, ai e pyeti: «ke shahit?» Shërbëtori i ngratë shtangu dhe nuk u përgjigj. Kadiu urdhënoi dhe e burgosën. Përhapet fjalë se kadiu i ri asht aqë i drejtë (!) sa burgos edhe njerëzit e mudirit. Kur merr vesh mudiri ç'kish ngjamë, mendon se druse shërbëtori ka rrëshqit e shkon ke kadiu t'i kërkojë ndjesë. Por kur ndigjon se ai ka kërkue shahit për të thirrmen për darkë, skuqet nga turpi!..

Qysh asokohe populli shqiptar nuk ka pasë farë besimi në gjykatësit. Por edhe sot qysh të ketë be-

sim populli kur ndigjon se gjykatsit e Beratit kanë lëshue nji gjaksuer? Qysh të ketë besim populli kur ndigjon se gjykatsi i Tiranës, tyke pasë edhe ma të pandehun (?) për nji krim dënon disa sish e nuk përet përfundimin e gjyqit përgjithësisht? Thomëni, ju lutem, ku asht pa apo ndigjue kjo çudi?

Qysh të ketë besim populli i ngratë kur ndigjon se gjykatësi paqtues i Elbasanit (me diplomë) për nji padi që i padituni e pohon, ai ngrihet e i kërkon paditësit dokumenta e shahit?

A thue nuk jemi në shekullin e tetëmbëdhjetë?
Ka edhe ma keq!»

Shigjeta»

(«*Shkumbini*», nr. 26, dt. 8 korrik 1921)

PERSERI NË TIRANË

«Asht e treta herë qi vij e vizitoj Tiranën si kryeqytet... U shkarkush në hotel... dhe prej unit zbrita përnjiherësh në restorant... Shikova për listën e gjellëve mbi truezë, por s'ishte aty. Si mshiva sytë e i hudha përposh saj, e pashë përdhe dhe menjiherë e mora. Thirra garsonin e, tyke këndue listën, i thashë: ma bjer nji koxhatas. Tasqebap, po të duesh, zotni, se koxhatas nuk kemi, ma priti garsoni. Si shikova përséri listën, më bjer i thashë zog. Urdhënon pulë me patate, zotni? se zog nuk kemi ba sot, ma ktheu garsoni. Atëhere pse i keni shkrue kot ore djalë? i thashë. Ai u zemërue pak, ma muer listën, e zuni ta këndoje: Koço Tasi, ministër... Ahmet Zogu i... ect. Posi zotni, m'u kthye e më pyeti me habi, a nuk i ke sytë të kthjellët qì nuk e dallon se kjo asht listë kabinetit? Po q'kérkon kjo listë këtu? e pyeta. Duket, më tha, se u ka ranë disa deputetvet qì qenë shparë tyke ngranë bukë aty...

Si mbarova ngranjën dola e ndenja në kafet. Kur ia befi nji mik, i cili pa më përshëndet mirë, merre tha këtë pusullë, se për ta çue ty e kam bamë gati. Pusulla dëftente zotësinë e pjesëtarëve të kabinetit të ri nji kshtu:

Iliaz Vrioni — Bir oxhaku. Jetë kryesore. Hovar-

dhallëk s'ka. Turqisht 10, frengjisht 8 1/2, shqip 6, rumanisht O.

Pandeli Vangjeli — I urtë e i ambël. Dëshiron çeljen e shkollave rumanisht. Turqisht O, frengjisht 8, shqip 6, rumanisht 10;

Selahudin Shkoza — Shqipen po e mëson me themel. Plagën q'i ka hapë Shqipnisë me shkollën e aspirantavet, kush e shëron? Turqisht 10, frengjisht 6, shqip O, rumanisht O.

Mehdi Frashëri — Orator i rrallë. E hudh samin shpejt. Turqisht 10, frengjisht 8, shqip 7, rumanisht O.

Tef Curani — as i ngrofët, as i ftohët. Marrëveshjet s'i këput. Këpucët e ushtrisë qi bleu n'Itali, u grisën ma shpejt se u mbathën. Turqisht 5, frengjisht?, shqip 7, rumanisht O.

.

Shigjeta

(«*Shkumbini*», nr. 27, dt. 15 korrik 1921)

Nr. 1000000

Telegram fort e shpejtë, ora 23 mesnatë

Q A R K O R E

Gjithë katundarive

«Jeni të lutun të porositni popullin dif qi të bajë sa ma shpejt preqatimet e duhuna me flamurë, dafina të vyshkta, lule shtogjesh e me lulkuqna, për t'u dalun përpara e për të pritun fort të çëmueshmit dhe tepër të lavdërushmit përfaqësues ...të cilët, mbasi kryen sa e sa vepra të shkëlqyeshme, po nisen së këtejmi të kënaqun, me shpirt e zemër lepuri, për t'u kthyem gjithsekush nëpër rrethet qi kanë pasë marrë përfaqsimet me aso mënyrësh qi ju vetë e dini.

Mbi trueza me kamba përej thanukllash, qì populli ka me i ngrefë jashta qytetit, ata kanë me kallzue gjendjen e atdheut qì vetë e kanë... dhe kanë për t'i dëftye popullit vargun e punimit të tyne qì prej gjashtëdhjetë e sa ligjesh e projektesh qì qeveria i ka pasë parashtrue e ata me shkathësi kanë muftë me qitë prej dore vetëm nja dhetë?! Me arësyen kanë me i shpiegue poplavet të popullit, qì shumë herë ata kanë hjekë tallaze e halle për vatan (!) tyke për-

pjekun duert e tyke përplasun kambët!... E për fat të keq, për gjithë këto djersë e mundime ata s'kanë muftë me marrë prej arkës së shtetit veçse nga 250 gjela të verdhë (napolona ari sh.a.) për shoq. Ambicja, interesi, intriga, inati, — për nji plesht me djegë nji jorgan — kanë qenë gjithëherë...

Pra, për t'iu ba nderimi qi meritojnë, ju porosis me randësi qi të rroknë nga... edhe dëftehuni, se ju për mbaskëndej keni nevojë për nji... të reë, tyke zgjedhun asi burrash qi së pakut t'i vlejnë atdheut të tyne si... Kësisoj vjen vetiu lulëzimi, përparimi, apo ma kjartas, shpëtimi i Shqipnisë së lume. Se për ndryshe për nji kohë fare të afërme...

Për...

Shigjetë

(«*Shkumbini*», nr. 35, dt. 28 tetor 1921)

Ky shkrim bën fjalë mbi propozimin e qeverisë për shpërndarjen e parlamentit dhe mbi dekretin e Këshillit të Naltë që ky parlament të puhojë veprimet e tij prej 4 nëntorit 1921 deri më 4 janar 1922, d.m.th. për dy muaj. Venendet që janë lënë bosh, duke i shënuar me pika, në original janë me shifra, një artistik me të cilën autori ia le t'i kuptojë vetë lexuesi, mendimet e tij të qarta.

MARRIM E BOTOJME

«Si përgjigje të telegramit të z. tuej nr. 99, shpallim se:

Nuk asht e vërtetë se nji ish-kryetar i delegacisë së marrëveshjes... ka futë në xhep të vet 10.000 fr. ari nga shpenzimet e delegacisë, gjoja për shtypin...

Nuk asht e vërtetë — se këshilltari i Ministrisë së Financave, qи ka dalë për punë shteti n'Evropë, asht tyke bredhë për kot, në hesapt të arkës së përgjithshme.

Nuk asht e vërtetë se nuk ka m'u kthye ma në Tiranë nji oficer Dalmatin, të cilin Komanda e Përgjithshme e Gjendarmërisë e ka çue me ble municione, tyke i dhanë në dorë pa farë sigurate 50.000 fr. ari.

Nuk asht e vërtetë se i ka humbë fatura rrugës nji zotnie qи bleu nja 12.000 fr. ari orendi shkollash në Vjenë, për Ministrinë e Arsimit.

Nuk asht e vërtetë se nga 40 shenjtën (grupi «Bashkimi i Shenjtë» në parlament me 40 pjesmarrës sh.a.) 7 kanë fluturue.

Nuk asht e vërtetë — se në hijesinat e pyjevet të Krujës derdhen bakshishe.

Nuk asht e vërtetë — se kur erdh ministri i financave gjeti borxh n'arkët.

Nuk asht e vërtetë — se këshilli kombëtar dahet më trish: a) asish që kur flasin u mbahet goja, b) asish që flasin e nuk bajnë apo nuk mbajnë, c) asish që nuk flasin kurrë.

Tiranë...

Heshta

Me përjashtim të fjalës «nuk» vërtetohen të gjitha këto që janë shkrue këtu sipër.

Për zyrën e vërtetimit

Shigjeta»

(«*Shkumbini*» nr. 36, dt. 4 nëntor 1921)

NE REDAKSI

«Ishja vetëm në zyrë të redaksisë e po mendohesha me sajue diçka për tragëzat... veç më erth befas në redaksi bashkëpunëtori i im Z.S. dhe ma prishi planin fare. Z.S. ishte ba det e duf dhe, tyke namitun botën mbarë me fjalë e me cufla byshtimash, shkaktoi ndërmjet nesh këtë bisedë:

— Edhe s'ke marrë vesht se ç'asht ba? Ma mirë le të shembet fare, ma mirë le të përmbysët, se na kanë fiikun e na kanë marrë mbë qafë!

— Dëftomë, se nuk di gjia i thashë.

— E shkelën, e muerën nëpër kambë atë vendim t'atij kongresi të shenjtë...

— E mora vesh se do të thuesh të Kongresit të Lushnjës! Po më thuej ç'asht ba, se nuk më durohet.

— E kanë qitë përjashta pa farë arësyse.

— Cin kështu?

— Këshillin.

— Kush e ka qitun?

— Këshilli tjetër. Dhe si? E qiten jashtë punet e jashtë budjetit! Thuej se kanë ba hatanë e zezë.

— Ke gabim, më duket se nuk e kanë qitë jashtë budjetit, por vetëm i dhanë diskun për nja dy muej.

— Ndofta ti kujton për Këshillin Kombëtar, por

unë e kam hallin ke Këshilli letrar, apo Këshilli arësimuer, të cilin e formoi Kongresi i Lushnjës, edhe parlamenti e fshiu nga budgjeti.

— Po pse nuk thue se gjynahu i Këshillit letrar e paska zanun Këshillin kombëtar, qi i erth hakut Këshilli i naltë!..

— Çudi vërtet, si u shpërnda Këshilli kombëtar e nuk u gjend njeri të kundërshtojë?

— Ndiva se e kanë kundërshtue mjaft por...

— Pse nuk thue, qi:

Plasi hoxha, tuj ligjërue
Por Xhemati s'e ka ngue
Se i asht mbushun mendja qyp
Pak ma herët asht kon lyp
Për nj'at urdhën «fërli n'derët»
Vap me ba si bujt n'lerët!

— Atëhere qenka mirë me vu në portët të parlamentit edhe nji tabellë kësisoj: «Epet me qira»!..»

Shigjeta

(«Shkumbini» nr. 37, dt. 11 nëntor 1921)

LETËR NANËS

«E dashuna plaka ime Vlonë! — U ba mjaft kohë që nuk më ke kujtue më, e përse? Mos je zemiërue, se mbasse unë kam bamë ndonji gabim pa dashun? Mos i shih për gja të madhe gabimet që bajnë vajzat, se ato sado mend që të kenë prapë janë bijat e atyne që quhen «flokëgjata e mendjepaka»... A ke marrë letër prej «ristokratit» (aristokratit sh.a.) apo të ka harrue fare? Kur ishim të vegjël, ti atë e doje ma tepër nga ne dhe kur e përkëdhelje thoshje: e kam djalth të mbarë! Po ai tani u ba i madh, i randë, i naltë, më duket as që të sjell ndër mend ma! Si e shpie me «emokracinë»? (demokracinë sh.a.). A qan ma? Mos u mërrizit, po rrite dhe atë sa ta mëkambësh e sa ta marrë veten e saj njiherë, se vetëm kështu e ke shkarkue detyrën tandem!

Shpirtja, Plaka ime, due të të lutem për nji gja, po nga turpi s'e them dot. Por, meqë shtypi kombëtar (sic), ka bamë fjalë ma parë mbi feminismën (gruan sh.a.) e mbi lirinë e saj, po guxoj ta them. Sikurse e di, xhanëz Plaka ime, tani unë mbush plot të gjashtëmbëdhetën behar të çupënisë sime, e për këtë arësy, si gjithë shoqet, më erdhi

radha që të shijoj edhe unë lezetet e bukurisë që kam!..

Prandaj asht detyra tande që të shkarkohesh faqe s'at bije. duke i gjetun nji burrë:

a) Që të jetë kryeministër, se kur të shëtis me karrocë nëpër kryeqytet, pranë arabaxhiut të ve, në vend të shërbëtorit, policin e shtetit shqiptar (sic) dhe kur të ndodhem larg tija, mbë ndonji qytet tjetër, të kuvendoj me anë të telefonavet të shtetit e të la pa gjumë shumë telefonistë duke përgjigjen.

b) Që të jetë ministër, se po të kem një djam e çupa m'i shëtitin policat e shtetit!

c) Që të jetë deputet. se kur të shpërngulem gjékundi, të marr shpenzime udhëtimi prej arkës së shtetit. Por jo nga ata që ngjyejnë leshrat me bojë.

g) Që të jetë oficer, se kur të shëtis më prin gjendarmi i shtetit!

d) Që të jetë prefekt, por jo fanatik.

dh) Që të jetë vlojnat, por jo fatosh, gjinokastrit, por jo mufidist, shkodran, por jo taraf, korçar, por jo qvl-qibar. elbasanas por jo duaxhi, tiranas, por jo nga ata që heqin bishtin e kandarit mbënjanë...

e) Që të jetë bej, por jo fodull! (Feudal), jo nga ata që rrabin bujxit për dy napolona, se do të mar-tohen!, jo nga ata në trembin botën për të mos i shtue të dhetat e katundevet, jo nga ata që fusin berberët brenda në katue, pse vonohen, jo nga ata që shtrëngojnë botën për ta shitë mallin sa i kanda blerësit, jo nga ata që nuk paguejnë në tregt e u del kanga:

*Jelekun me sumlla ari
Ta ka qepë Liko Xhumari.
Liko Xhumari m'a ka qepë,
Por shkoj në dyqan e s'ma jep!*

Pajë e stoli s'kam shumë, drit' e syvet Plakë
ime, por atë që kam e kam dobarem të modës... (e
mbas Kudredit)... Bija tande e dashun gjer në mi-
nutën e fundit të shpirtit.

Shigjeta»

(«Shkumbini», nr. 38, dt. 18 nentor 1921)

Në këtë shkrim satirik, ku «Shigjeta» personifikon një vajzë të re që dëshiron të martohet dhe për këtë i drejtohet me një letër nënës së vet, të cilën, autori, në mënyrë simbolike e quan Vlora, Emini futet nëpër skutat më të errëta të jetës politike, ekonomike e shoqërore të atëhershme. Ai godet me forcë tradhëtinë, cinizmin, poshtërsinë, padrejtësinë e shfrytëzinë e klasave sundonjëse feudoborgjeze, kritikon shtypjen dhe përcëmimin e gruas shqiptare, nxit luftën e forcave përparimtare për demokraci. Në të njëjtën kohë, autori fshikëllon veset e këqia që kishte futur tek shtresat mikroborgjeze të krahinave të ndryshme pushtimi shekullor otoman dhe veglat e tij çifligarët e vendit, si mendjemadhësinë, fodullëkun, fanatizmin, tarafin, servilizmin, spekulimin etj.

HISTORIA S'HARRON

«...A ka shqiptar qi të mos thotë se dita e 28 e këtij mueji asht ajo ma e shkëlqyeshmja, se n'atë ditë asht ngritë flamuri kombëtar në Vlonë, e Shqipnia u ba vetqeverimtare?

Flamuri asht shenj' e naltë e kombësisë... Flamuri asht shenjë e gjallnisë... Flamuri asht ndera e atdheut. Kurrë s'më harrohen ata shqiptarë qi e përmbyssën, e çnderueren këtë të famshëm flamur, tyke ia shkëmbye shkabën trime, me hanë apo me yll të bardhë!..

Sonte asht nata e festës së flamurit, natë historike. Gjithkush ka gzmend, gjithkush kërkon dëfrim. Urdhënoni të gjithë në qinematografin «Historia s'harron», e cila mbë ora 28 shfaq këto pamje:

I. — a) Lidhja e Prizrendit. b) Të zanunit e një faktori të kësaj lidhjeje (Abdyl Frashërit) tradhëtisht i kallzuem prej parisë, kur desh të kalojë Shkumbinin, pranë Elbasanit.

II. — a) Kuvendi (kongresi) i madh i Vlonës. b) Proklamimi i mëvehtësisë së Shqipnisë mbë 28 nanduer 1912.

III. — a) Tragjedia e Hasan Riza Pashës, vramun tradhëtisht prej Esat Toptanit. b) Të hyemit e Malazezvet, ndën prisi të gjeneral Martinovicit në

Shkodër, e cila u lëshue tradhëtisht prej Esat Toptanit më 24 prill 1912.

IV. — a) Proklamimi i qeverisë (!) «Shqipnia e mesme» në gusht 1913 prej Esat Toptanit, i cili u kthye në Durrës tyke dhanë dorëheqjen prej ministrit të punëve të mbrendshme të qeverisë së Vlonës. b) Luftët bejlerësh në Godolesh (Elbasan) me qitap në dorë.

V. — a) Të dalunit e Naltmadhënisë së tyne mbret Viedit e mbretëreshës Sofia në Durrës, më 7 mars 1914. b) Rrethimi i shpisë së Esat Toptanit prej gjendarmërisë shqiptare në Durrës mbë 19 maj 1914, e të zanunit e tija. c) Rrethimi i Durrësit prej kryengritësve mbë 21 maj 1914. T'ikunit e naltmadhënisë së tyre prej Durrësit mbë 3 shtator, dhe të hymit e kryengritësve fshatarë.

VI. — a) T'ardhunit e Esat Toptanit prej Serbie në Durrës me fuqi dibranësh mbë 1 tetuer 1914. b) Të rrethuemit e Durrësit mbë 14 dhjetuer 1914.

VII. — Të hymit e italianvet në Vlonë mbë 25 dhetuer 1914.

VIII. — Të hymit e serbëve për së dyti në Elbasan e në Tiranë, mbë 20 maj 1915, të thirrun prej Esat Toptanit.

IX. — T'ikunit e Kral Petros, përcjellun prej një zyrtari shqiptar, e t'Esat Toptanit prej Durrësit. b) Të hymit e austriakëve në Shqipni në kallnuer 1916.

X. — a) Kuvendi madhështur i Lushnjës, 21 kallnuer 1920. b) Lufta kreshnike e Vlonës. c) Fundi i tradhëtisë së Esat Toptanit në Paris, mbi 13 qershor 1920.

XI. — a) Pranimi i delegacisë shqiptare në Lidhjen e Kombevet, më 17 dhetuer 1920. b) Njofti-

mi i qeverisë shqiptare efektivisht prej mbretnive
aleate mbë 9 nanduer 1921 në Paris.

Biletat i pret Faiku n'Amerikë». (Faik Konica
sh.a.)

Shigjeta

(«*Shkumbini*» nr. 39, dt. 28 nëntor 1921)

«BARI MA I MIRË ME SHKUL KRYET»

«Nuk di t'ia ketë anda tjetër kuj kuvendimin me pleq aq tepër sa ma ka anda mue e t'i nderojë ata aq fort sa unë. Kështu vete e kuvendoj shpeshherë me nji mik plak, që i ka kaptue mosha për së tepri, por mendja s'e ka lanë aspak. Kur shkoja dje udhës në-për tregt nuk munda pa kthye në dyqan të tija. Si u përshëndetëm zakonisht, zuna e cyta plakun tyke lavdërue punët e të rinvjet dhe tyke shamun ato të pleqvet. U xe plaku shekulluer dhe nisi e ligjëroi kshtu:

Mos më plas shpirtin e mos më ban që të flas shumë. Çar punësh të mira keni ba ju të rijtë për vehten tuej e për vendin tuej, veçse keni damue vendin tyke e veshun me recka t'Evropit e tyke qitun gjomni të hollash nëpër tregt të botës! Ja si u veshëm na me mall vendi e nuk derdhëm asnji dhiç n'Evropë. Pse mçifi si mij e bani. Shtatëqindt dredhime kur atdheu u thërret për ushtarë? Na pleqtë jemi ata që kemi shkue ushtarë edhe në Jemen, por mjerisht për të huej! Çar ndërtese shkolle o së-muntore, apo ndonji çezme keni ba ju të rijtë, veç atyne që keni gjetun prej pleqsh?

Çar të mirë i keni ba vendit ju të rijtë, veçse

jeni da dysh e trish, tyke u ba vegla e dikujt për të lëpymun ndonji kofshë gjeli?!

— Si duket (i thashë plakut) punët e sotme ty të ngajnjë si ma zi, por ke gabim...

— Mos ma pre fjälén (m'u kthye plaku tyke qeshun). Por kishim edhe na të meta, se në vaktit tonë s'kishte mejtepe shqip, por ndonji medrese, qì as hoxhët nuk i merrshin vesht ato qì mësojshin...

Ja të dëftej nji ndodhi qì kallzon se ç'mall ishim na!!! Na erdhi nji herë nji Pasha Kajmekan prej Stambolli emnit... e esnafi i jonë i shkoi dhe i bani ziaret (vizitë). Të nesërmen Pasha shkoi në dyqant t'esnafit, qì bahesh prej katër vetash e ktheu ziarerin (vizitën). Pasha fliste turçe, por esnafi nuk merrte vesh asgjë. Kur muer vesht njani prej esnafit qì Pasha po u qate se ishte lodhë rrugës e kishte dhambje krei, i tha: (ilaxhiha-ihraxhiha) bari ma i mirë m'e shkul kryet!!! E kishte ndi në medrese këtë darbmesel (proverb) arabisht esnafliu, por s'e kishte kuptue qì asht për dhambin qì dhemb e jo për kryet!!!

• • • • •
T'erdh për hosh — shtoi plaku — se dëften trashësinën tonë, por...

Unë sun qëndrova ma prej të shkrepmes së gatit, por i thashë lamtumirë plakut e u largova.»

Shigjeta

(«*Shkumbini*», nr. 45, dt. 6 janar 1922)



PËRMBAJTJA

	Faqe
Parathënia	3
Nxënës i dalluar dhe patriot i flaktë	9
Luftëtar i pushkës dhe i pendës	19
Militant i arësimit e kulturës dhe mbrojtës i vendosur i pavarësisë së atdheut	38
Gazetar i talentuar dhe i guximshëm	54
«Tragëzat e mullinit» të «Shigjetës»	96
«Shtypi kombëtar ndahet nga një shok i dashur e i duhur».	129
Fragmente nga shkrimet satirike të Emin Matraxhiut	
Kandidatura	146
Shtetrrethimi	149
Bisedim në telefon	151
Një vizitë në kryeqytet	154
U çel parlamenti	156
Andërr	158
Kopshtari dhe Nastradini	160
Kolera	162
Kanuni	164
Mentaliteti	166

Faqe

Përsëri në Tiranë	168
Qarkore	170
Marrim e botojmë	172
Në redaksi	174
Letër nanës	176
Historia s'harron	179
Bari ma i mirë me shkul kryet	182

Redaktor: *Fatmira Aliaj*
Kopertina nga: *Spiro Kristo*

Tirazhi 3.000 kopje Format 70 x 100/32 Stash: 2204 - 72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1973